



# 2013

## RAPORT VJETOR



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000


[www.hr-jugor.com](http://www.hr-jugor.com)

# Përmbajtja

<b>Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR“</b>		<b>4</b>
<b>I. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE</b>		
1.1	Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit	6
1.2	Pasqyra e performances operative dhe financiare ne krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual	12
1.3	Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes	13
1.4	Pasqyra e të priturve për vitin e ardhshëm	14
1.5	Investimet e rëndesishme te bera gjate vitit	14
<b>II. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV</b>		
2.1	Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit	15
<b>2.1.1</b>	<b>Aktivitetet nga Shërbimi Teknik</b>	<b>15</b>
2.1.2	Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	18
2.1.3	Planifikimi I investimeve emergjente	18
2.1.4	Furnizimi me ujë të pijes në Njësitë Punuese	19
2.1.5	Prodhimi I ujit - m3	23
2.1.6	Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	23
2.1.7	Servisimi I ujëmatësave	24
2.1.8	Zyra për planifikim dhe zhvillim	24
2.1.9	Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	28
<b>2.2.1</b>	<b>Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë</b>	<b>30</b>
2.2.2	Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkyçjes	31
2.2.3	Raport I ankesave	31
2.2.4	Raport I mediave	34
<b>2.3.1</b>	<b>Aktivitetet e Departamentit Administrativ</b>	<b>36</b>
2.3.2	Personeli	40
2.3.3	Numri I punëtorëve sipas nacionaliteteve	40
2.3.4	Kualifikimi i punëtorëve	40
2.3.5	Procedimi I lëndëve në Gjykata për Kundërvajtje	41
2.3.6	Aktivitete të zyrës së teknologjisë Informative	52
2.3.7	Raport i zyrtarit per siguri dhe shendet ne punë	54
<b>2.4.1</b>	<b>Aktivitetet nga Shërbimi financiar</b>	<b>55</b>
2.4.1.1	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Njësia Punuese në Prizren	57
2.4.1.2	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Njësia Punuese në Suharekë	58
2.4.1.3	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Njësia Punuese në Dragash	59

2.4.1.4	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Njësia Punuese në Malishevë	60
2.4.1.5	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor- Hidroregjioni Jugor	61
2.4.1.6	Progresi me Planin e Biznesit	62
3.1	Plani I investimeve Kapitale	65
3.1.1	Investimet - Ujësjiellës	66
3.1.2	Investimet- Kanalizim	67
<b>IV</b>	<b>RAPORTI I AUDITORIT</b>	<b>68</b>
4.1	Raport I auditorit të brendshëm	68
<b>V</b>	<b>PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM</b>	<b>82</b>
5.1	Qellimet dhe objektivat strategjike per vitin 2014	82
5.2	Objektivat kryesore të KRU „Hidroregjioni Jugor”	82
5.3	Treguesit kryesor te performances 2014-2016	82
<b>VI</b>	<b>RAPORT I PROKURIMIT</b>	<b>83</b>
6.1	Kontratat me vlera te mesme	83
6.2	Kontratat me vlera minimale	86
<b>VII</b>	<b>RREZIQET E TË ARDHMES</b>	<b>88</b>
<b>VIII</b>	<b>ORGANOGRAMI</b>	<b>89</b>
<b>SHTESA I:</b>	<b>Tabela e investimeve</b>	
<b>SHTESA II:</b>	<b>Pasqyrat financiare</b>	

## ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



## BORDI I DREJTORËVE

### **Dr. Naser Bajraktari**

Kryesues i Bordit

Mob.: 044 113 373

045 761 761

e-mail: [naser.bajraktari@ks-gov.net](mailto:naser.bajraktari@ks-gov.net)

### **Ing. I Dip. Galip Hoda**

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 127 779

e-mail: [galiphoda@hotmail.com](mailto:galiphoda@hotmail.com)

### **Ecc.i Dip. Bujar Hasani**

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 217 239

e-mail: [hasanibujar@hotmail.com](mailto:hasanibujar@hotmail.com)

### **Arkitekthe e Dip. Drita Grazhda**

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 191 214

e-mail: [atelieprizreni@hotmail.com](mailto:atelieprizreni@hotmail.com)

### **Biolog i Dip. Sait Uka**

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 140 026

e-mail: [sahitukaj@hotmail.com](mailto:sahitukaj@hotmail.com)

### **Fizikant i Dip. Besim Baraliu**

Anëtar i Bordit

(Kryeshef Ekzekutiv)

Tel.&Fax.: 029 244 150

Mob.: 044 172 842

e-mail: [sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com](mailto:sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com)

## I. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

### 1.1 AKTIVITETET KRYESORE TË NDËRMARRA GJATË VITIT

KUR Hidroregjioni Jugor udhëhiqet nga Bordi i drejtorëve të emëruar nga Qeveria e Kosovës. Bordi aktualisht përbëhet nga 5 drejtorë sepse 1 prej tyre ka dhënë dorëheqje dhe ende nuk është emëruar anëtar i 6 i bordit. Sipas kërkesës së KUR Hidroregjioni Jugor, NJPMNJ ka dhënë pëlqimin që bordi të vazhdojë punën me 5 anëtarë deri në riemërimin e ardhshëm. Komisioni i auditimit përbëhet nga 2 anëtarë në mungesë të anëtarit i cili ka dhënë dorëheqje.

**Gjatë vitit 2013 bordi ka mbajtur 7 takime të rregullta mujore, Komisioni I Auditimit; gjashtë takime të rregullta, Komiteti per Financa; shtate takime, Komiteti per Hulumtime dhe Teknologji; tetë takime dhe Komiteti per Staf ; nje takim. Sipas procesverbaleve takimet e Bordit jane mbajtur me këto data: :06.02.2013; 13.03.2013; 08.05.2013; 05.06.2013; 12.07.2013; 14.08.2013; 31.10.2012 .**

Në këto takime angazhimet e bordit kanë të bëjnë me:

- Miratimi i raportit vjetor 2012
- Aprovimi I Plan-Biznesit për vitin 2014-2016
- Raportet e Zyrtarit të auditimit të brendshëm
- Është mbajtur Mbledhja së Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A (për vitin 2012)
- Aprovimi-miratimi i propozimit të Komisionit të Auditimit, të kompensimit-bonusit te drejtorëve në një shumë deri në pesëdhjetë 50% te honorarit themelor nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit (Ky aprovim I Bordit është bërë duke u mbështetur ne propozimin e Komisionit të Auditimit dhe mbështetur në Ligjin Nr.04/L-111 nenit 12 pika iii Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike)
- Bordi i Drejtorëve ka bërë vlerësimin e kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë për vitin 2012: Kryeshefin Ekzekutiv, Zv.Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar, Sekretarin e Kompanisë, dhe Auditorin e Brendshëm. Me Komentin në performancën së përgjithshme të kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë janë pajtuar njëzëri të gjithë anëtarët e Bordit .
- Shqyrtimin dhe aprovimin raporteve tremujore ( duke u bazuar në raportet mujore); dhe

në kornizën ligjore te Ligjit për NP .

Janë dorëzuar te aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (MZHE); (nga raporti TM1 deri te raporti për TM4 ),dhe Raporte mujore për ZRRUM-in;

#### Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2013

- Bordi i Drejtorëve ishte në kontakte të vazhdueshme me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakte direkt por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
- Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv.

- Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.
- Bordi i Drejtorëve pasi ka shqyrtuar kërkesën e NPT"ART-COM" për kyçje në gypat e ujësjellësit me qëllim të krijimit të energjisë elektrike, me VENDIM ka aprovuar-miratur kërkesën NPT"ART-COM" për kyçje në gypat e ujësjellësit me qëllim të krijimit të energjisë elektrike vetëm për fazën hulumtuese. Pasi të përfundoj fazën hulumtuese dokumentin final të kompletuar (projekt propozimin) ta paraqesë në Kompani për hapat e mëtejshëm.
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor"Sh.A me seli në Prizren në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për Raportet mbi Përbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me VENDIM pas shqyrtimit të bërë ka Aprovuar-miratur Raportin mbi Sondazhin për Hulumtim të Opinionit për Kënaqshmërinë e Konsumatorëve me Shërbimet e KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh.A, njëzëri pa vërejtje.
- Bordi Drejtorëve pasi rishqyrtoj dhe diskutoj arsyeshmërinë lidhur me kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv për kompensim të zyrtarëve të lartë të Kompanisë, si Zyrtarit të lartë financiar, Sekretarit të Kompanisë dhe Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, me VENDIM nga data 01.07.2013 i përcakton kompensimi i të ardhurave personale nga koeficienti 9 në koeficient 10 Zyrtarit të lartë financiar, Sekretarit të Kompanisë dhe Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm të K.R.U "Hydroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren. Gjatë përcaktimit të nivelit të kompensimit janë marr parasysh detyrat e pozitës përkatëse si dhe madhësia, natyra dhe kompleksiteti i veprimtarisë në K.R.U"Hydroregjioni Jugor"Prizren.
- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2013 i ka mbajtur 7 Takime të rregullta me përbërje të plotë.
- Në kuadër të Bordit të drejtorëve kanë vazhduar të funksionojnë këto komitete;

1. Komisioni i Auditimit (06 Takime)
2. Komiteti për hulumtime dhe teknologji (08 Takime) dhe
3. Komiteti i financave (07 Takime).
4. Komiteti për staf dhe shpërblime (01 takim)

Bordi i Drejtorëve falënderon Kryeshefin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe gjithë punëtorët për angazhimin e tyre në rritjen e performancave të kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shprehë një mirënjohje të veçantë për të gjithë donatorët (KfW, USAID), MZHE dhe Kuvendet Komunale për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për në interes të Kompanisë.

**Komisioni i Auditimit ka mbajtur gjashtë takime të rregullta, sipas procesverbaleve takimet e KA janë mbajtur në këto data: 28.01.2013; 23.04.2013; 31.05.2013; 11.07.2013; 05.08.2013; 16.09.2013 .**

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit në KRU "Hydroregjioni Jugor" Sh.a në Prizren, përfshin punët dhe aktivitetet të cilat janë kryer për periudhën kohore janar – dhjetor 2013.

Bazë për përgatitjen e këtij raporti vjetor, janë procesverbalet e përpiluara me shkrim, gjatë takimeve të mbajtura të Komisionit të Auditimit.

Edhe përkundër faktit se Komisioni i Auditimit që nga viti 2013 aktivitetin e vet e ka kryer me vetëm dy anëtarë, megjithatë ka qenë mjaft aktiv, konstruktiv dhe frytdhënës, duke shqyrtuar, diskutuar dhe duke marrë vendime shumë të rëndësishme, në aspektin e mbarëvajtjes dhe ngritjes së performancës së përgjithshme të kompanisë.

Komisioni i Auditimit gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsejtë gjashtë takime të rregullta, ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

Në vazhdim, në mënyrë kronologjike, në formë të përgjithësuar janë paraqitur takimet, aktivitetet, diskutimet, konkluzionet dhe vendimet e Komisionit të Auditimit.

Në takimin e parë të këtij viti, të mbajtur me 28.01.2013, është diskutuar dhe analizuar:

- Raporti financiar, për tremujorin e katërt të vitit 2012;
- Raporti vjetor i punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2012;
- Aprovimi i planit strategjikë 2013-2015 dhe planit vjetor të Auditorit të brendshëm për vitin 2013.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit aprovon raportin financiar të prezantuar nga Zyrtari Kryesor Financiarë të Kompanisë me sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna që ti propozohet Bordit për tërheqjen e vërejtjes për inkasimin e dobët në njësinë Suharekë dhe t'i jepet mundësia Bordit për shqyrtimin e masave të mëtutjeshme.
- Komisioni i auditimit aprovoi raportin vjetor të auditorit të brendshëm për vitin 2012.
- Komisioni i Auditimit aprovoi planin strategjikë të auditorit të brendshëm 2013-2015, si dhe planin vjetor 2013, në bazë të propozimit të auditorit të brendshëm sipas nevojës të bëhet ndonjë auditim shtesë, sipas kërkesës së komisionit apo nevojës.

Takimi i dytë i K.A është mbajtur me datë 23.04.2013, ku është bërë:

- Shqyrtimi i raportit financiar për tremujorin e parë të vitit 2013;
- Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshëm për janar-mars 2013;
- Shqyrtimi i kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv për ngritje të pagës së Zyrtarëve të lartë të Kompanisë

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit aprovon raportin e tremujorit të parë 2013 të prezantuar nga Zyrtari Kryesor Financiar me vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me arsyet e rënies së faturimit dhe ngritjes së shpenzimeve.
- Komisioni i Auditimit e aprovon raportin tremujor janar-mars 2013 të punës dhe aktiviteteve të Auditorit të Brendshëm si dhe tri auditimet lidhur me menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme – borxheve të këqija dhe menaxhimin e procesit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së).
- Pas shqyrtimit të bërë Komisioni i Auditimit në bazë kompetencave, përgjegjësi dhe në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 25,25.1 dhe 25.2 pika (h) aprovon kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv me Vendim për ngritje të pagës sipas kërkesës vetëm për Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm ndërsa për Zyrtarin e Lartë Financiar dhe Sekretarin e Kompanisë Komisioni i Auditimit I propozon Bordit që të aprovoj kërkesën e KE për nivelizimin e pagave të tyre ngase kompenzimi dhe përfitimet e tyre përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve.

Takimi i tretë është mbajtur me datë 31.05.2013, ku gjatë këtij takimi është bërë:

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të auditorit për Pasqyrat financiare të Audituarra për 2012 dhe letrës për menaxhmentin dërguar nga Auditori i Jashtëm;
- Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshëm.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

Komisioni i Auditimit e aprovon raportin final të Auditorit të jashtëm lidhur me Pasqyrat financiare të Audituarra për vitin 2012 dhe njëherit rekomandon menaxhmentin e Kompanisë që në perudhën e vitit fiskal deri me 31.12.2013 konstatimet e daluara nga Auditori i Jashtëm t'i implementoj dhe përshtatë sipas SNRF,SKK dhe SNK.

- Komisioni i Auditimit shqyrtoj dhe Aprovoj dy Raportet finale te Auditorit të Brendshëm lidhur me menaxhimin e TVSH-së dhe me menaxhimin e procesit të pagave, gjithashtu rekomandoj që ne ardhmen asnjë ndryshim i koeficientit për punëtorët e Kompanisë nuk lejohet pa bërë kërkesë me shkrim në Komision të Auditimit për aprovim dhe pastaj të procedohet në Bord të Drejtorëve.

Takimi i katërt është mbajtur me datë 11.07.2013, ku gjatë këtij takimi është bërë:

- Shqyrtimi raportit financiar dhe të performancës për gjashtëmujorin e parë – 2013;
- Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshëm për gjashtëmujorin e parë 2013.
- Shqyrtimi i çështjes së koeficienteve të ekipës së inkasantëve.



Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit aprovoj-miratoj raportin e performances për tremujorin e dytë 2013 dhe raportin për janar-qeshor 2013 , pas prezantimit të bërë nga Zyrtari i lartë për raportim, njëherit rekomandon menaxhmentin e Kompanisë gjatë muajit korrik ta rishqyrtoj plan-biznesit 2013 dhe të bëjë revidimin e Planit të Biznesit aty ku është e nevojshme. U kërkua që këto rekomandime i përcjellën e Bordit të Drejtorëve për aprovim.
- Komisioni i Auditimit aprovon raportin gjashtë mujor (janar-qeshor 2013) të punës dhe aktiviteteve të kryera nga auditori i brendshëm. Draft raportin e auditimit të kryer në Njësinë Punuese në Suharekë dhe raportin e auditimit të kryer në shërbimin e servisimit dhe vendosjes së ujëmatësve. Duke parë raportin e Auditimit në Njesinë e Suharekës dhe të gjeturat e dalura gjatë Auditimit Komisioni i Auditimit i rekomandon Bordit që ne takimin e radhes, Njesisë së Suharekës t'i shqiptohet masa ndëshkuese për performancë të dobët, për të gjithë punëtorët e njesisë së Suharekës ndalesë 10% të pagës, njëherit kërkoj të shqyrtohet edhe përgjegjësia e menaxhimit të Njesisë.
- Komisioni i Auditimit rekomandon Auditorin e Brendshëm që në ardhmen të raportoj për realizimin apo shkallën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të brendshëm nga menaxhmenti i Kompanisë për gjashtë mujorin e parë 2013.
- Gjatë diskutimit të çështjes së koeficienteve të ekipës së inkasantëve, Komisioni i Auditimit kërkoj nga shërbimi përkatës të përgatitet kërkesë që përfshinë pagën minimale të një inkasanti, arsyeshmërin për rritje të koeficientit pastaj të paraqitet për shqyrtim në mbledhjen e radhës se Komisionit të Auditimit.

Takimi i pestë i K.A është mbajtur me datë 05.08.2013, ku është bërë:

- Shqyrtimi raportit të performancës për muajin korrik – 2013;
- Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshëm .

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- Komisioni i Auditimit aprovon raportin financiar të Kompanisë për muajin korrik-2013. Mbështetur në informatat dhe raportet e dhëna nga menaxhmenti i kompanisë Komisioni i Auditimit është i mendimit që të propozoj Bordit të drejtorëve që në mbledhjen e ardhshme të diskutoj dhe aprovoj mundësinë e kompensimit-bonusit te drejtorëve në një shumë deri në pesëdhjetë 50% të honorarit themelor nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit (mbështetur në Ligjin Nr.04/L-111 nenit 12 pika iii Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike). Komisioni i Auditimit konstaton që ky kompensim-bonus propozohet për rritje të performances vjetore te kompanisë për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011 dhe performancës së mirë për gjashtë mujorin e parë 2013 .Në propozim të bonuseve të përfshihen edhe Kryeshefi Ekzekutiv dhe Sekretari i Bordit.
- Komisioni i Auditimit Aprovon Raportin final të auditimit të kryer në Njësinë Operative të Suharekës dhe Draft raportin e auditimit të kryer në Njësinë Operative në Malishevë, auditime këto të bëra nga Auditori i Brendshëm, njëherit kërkon nga menaxhmenti i lartë që të verifikoj përgjegjësinë e Udhëheqësit të Njesisë së Malishevës lidhur me mos faturimin në bazë të orëve të lexuara.

Takimi i gjashtë i K.A është mbajtur me datë 16.09.2013, ku është bërë:

- Shqyrtimi raportit të performancës për muajin gusht 2013;
- Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshëm;
- Shqyrtimi i kërkesës së Menaxherit Rajonal për konsumator për aprovimin e shpenzimeve rreth realizimit të emisionit televiziv.

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- Komisioni i Auditimit e aprovoj raportin e performancës së Kompanisë për muajin gusht 2013 në tersi, ashtu siç është prezantuar nga menaxhmenti i Kompanisë, me sugjerimin që nga njësia operative e Suharekës të këtë një informatë për faktorët që kanë ndikuar në mosrealizim të objektivave.
- Komisioni i Auditimit aprovoj Raportin final të auditimit të kryer në Njësinë Operative në Malishevës, Raporti final të auditimit të kryer në Njësinë Operative në Dragash dhe Draft raportin e auditimit lidhur me menaxhimin e të hyrave nga arka dhe portoarkat, të paraqitura nga Auditori I Brendshëm.
- Komisioni i Auditimit kërkon nga Auditori i Brendshëm që për takimin e radhës të paraqitet pikë e veçantë e rendit të ditës sa janë implementuar (realizuar) rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm në Kompani.

Komisioni i Auditimit autorizon Auditorin e Brendshëm që për periudhën korrik, gusht, shtator të bëhet auditim Zyrës së Prokurimit lidhur me të gjitha shpalljet që kanë dalë nga ana e zyrës së prokurimit dhe sa janë respektuar procedurat.

- Komisioni i Auditimit në parim e aprovon kërkesën për realizimin e emisionit televiziv të paraqitur nga Menaxheri Rajonal për konsumator, por kërkon që të arsyetohet me shkrim, të epen paramasat, paralogaritë të cilat pastaj i dorëzohen zyrës së Prokurimit, pastaj zyra e prokurimit të vijë me dokumentacion të kompletuar në Komision të Auditimit për aprovim.

Komisioni i Auditimit kërkoj nga Zyra e Prokurimit që për qdo shpallje tenderi dokumentacioni i kompletuar paraprakisht të paraqitet në Komision të Auditimit pastaj të bëhet shpallja.

#### **MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

**Tabela:1**

<b>NR.</b>	<b>DATA</b>	<b>VENDI</b>	<b>VËREJTJE</b>
1	06.02.2013	Prizren	
2	13.03.2013	Prizren	
3	08.05.2013	Prizren	
4	05.06.2013	Prizren	Mbledhja e Pergjithshme vjetore me Aksionarin
5	12.07.2013	Prizren	
6	14.08.2013	Prizren	
7	31.10.2013	Prizren	

#### **MBLEDHJET E KOMITETIT TË AUDITIMIT K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

**Tabela:2**

<b>NR.</b>	<b>DATA</b>	<b>VENDI</b>	<b>VËREJTJE</b>
1	28.01.2013	Prizren	
2	23.04.2013	Prizren	
3	31.05.2013	Prizren	
4	11.07.2013	Prizren	
5	05.08.2013	Prizren	
6	16.09.2013	Prizren	

#### **MBLEDHJET E KOMITETIT TË FINANCAVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

**Tabela:3**

<b>NR.</b>	<b>DATA</b>	<b>VENDI</b>	<b>VËREJTJE</b>
1	28.01.2013	Prizren	
2	29.05.2013	Prizren	
3	26.06.2013	Prizren	
4	10.09.2013	Prizren	
5	22.10.2013	Prizren	
6	27.11.2013	Prizren	
7	26.12.2013	Prizren	

**MBLEDHJET E KOMITETIT PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI  
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

**Tabela:4**

<b>NR.</b>	<b>DATA</b>	<b>VENDI</b>	<b>VËREJTJE</b>
1	30.01.2013	Prizren	
2	26.03.2013	Prizren	
3	29.05.2013	Prizren	
4	26.06.2013	Prizren	
5	11.09.2013	Prizren	
6	22.10.2013	Prizren	
7	27.11.2013	Prizren	
8	26.12.2013	Prizren	

**MBLEDHJET E KOMITETIT PËR STAF DHE SHPERBLIME  
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

**Tabela:5**

<b>NR.</b>	<b>DATA</b>	<b>VENDI</b>	<b>VËREJTJE</b>
1	26.12.2013	Prizren	

## 1.2 PASQYRAT E PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE NË KRAHASIM ME VITIN PARAPRAK

MUAJI	JAN-DHJET-2012	JAN-DHJET-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	19,614,291	19,273,615	(340,676)	(1.74)
<b>Prodhimi - l/sec</b>	622	611	(10.8)	(1.74)
<b>Faturimi m3</b>	7,672,243	7,748,680	76,437	1.00
<b>Faturimi l/sec</b>	243	246	2.4	1.00
<b>Faturimi nga uji €</b>	3,759,638.49 €	4,195,740.56 €	436,102.07 €	11.60
<b>Faturimi- te tjera €</b>	128,028.84 €	113,519.86 €	- 14,508.98 €	(11.33)
<b>Faturimi Total €</b>	3,887,667.33 €	4,309,260.42 €	421,593.09 €	10.84
<b>Inkasimi nga uji €</b>	2,693,922.38 €	3,029,653.19 €	335,730.81 €	12.46
<b>Inkasimi - te tjera €</b>	126,744.23 €	106,610.21 €	- 20,134.02 €	(15.89)
<b>Inkasimi Total €</b>	2,820,666.61 €	3,136,263.40 €	315,596.79 €	11.19
<b>Nr. i Konsumatorëve</b>	36226	38878	2652	7.32
<b>% e inkasimit</b>	71.65	72.21	0.55	0.77
<b>Shpenzimet</b>	2,749,594.39 €	3,017,383.11 €	267,788.72 €	9.74
<b>Paga bruto</b>	1,469,456.03 €	1,568,262.00 €	98,805.97 €	6.72
<b>Mirmba. dhe riparimet</b>	263,211.46 €	255,806.00 €	- 7,405.46 €	(2.81)
<b>Rryma elektrike</b>	656,600.20 €	770,010.00 €	113,409.80 €	17.27
<b>Shpenzi. e derivateve</b>	108,859.22 €	92,184.00 €	- 16,675.22 €	(15.32)
<b>Kemikalet</b>	12,894.56 €	8,086.00 €	- 4,808.56 €	(37.29)
<b>Shpenzi. tera operat.</b>	238,572.92 €	339,017.00 €	100,444.08 €	42.10
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	11,942,048	11,524,935	(417,113)	(3.49)
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	60.88	59.80	-1.09	(1.79)
<b>Uji I pafaturuar l/sec</b>	378.68	365.45	-13.23	(3.49)
<b>Mbulimi operativ</b>	1.03	1.04	0.01	1.32

## PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT - 2013

### • HIDROREGJIONI JUGOR - JANAR-DHJETOR- 2013

MUAJI	JAN.-DHJET.2013	CAQET E PLAN.	DEVIJIMI I CAQ.	DEVI. I CAQ.NË %
<i>Prodhimi m3</i>	19,273,615	20,567,045	(1,293,430)	-6.29
<i>Faturimi m3</i>	7,748,680	8,377,200	(628,520)	-7.50
<i>Faturimi në %</i>	40.2	40.7	(0.53)	
<i>Faturimi nga uji €</i>	4,195,740.56 €	4,376,938.72 €	181,198.16 €	-4.14
<i>Faturimi- te tjera €</i>	113,519.86 €	135,500.00 €	21,980.14 €	-16.22
<i>Faturimi Total €</i>	4,309,260.42 €	4,512,438.72 €	203,178.30 €	-4.50
<i>Inkasimi nga uji €</i>	3,029,653.19 €	3,302,318.21 €	272,665.02 €	-8.26
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	106,610.21 €	130,094.00 €	23,483.79 €	-18.05
<i>Inkasimi Total €</i>	3,136,263.40 €	3,432,412.21 €	296,148.81 €	-8.63
<i>Nr. i Konsumatorëve te fat.</i>	38,878	36653	2225	6.07
<i>% e inkasimit</i>	72.21	75.45	-3.24	
<i>Shpenzimet</i>	3,017,383.11 €	2,878,002.00 €	139,381.11 €	4.84
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	11,524,935	12,189,845	-664,910	-5.45
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	59.80	59.27	0.53	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.04	1.19	-0.15	-12.85

### 1.3 NGJARJET TË CILAT NDIKOJNË NË TË ARDHMEN E NDËRMARRJES

- Investimet ne trajtimin e ujerave te zeza do të bdikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e shpenzimeve dhe me këtë edhe detyrimisht në kërkesën e rritjes së tarifave për Konsumatorë
- Vazhdimi i investimeve nga gantet dhe donacionet do të bdikojë në uljen e shpenzimeve të energjisë dhe përmirësimin e furnizimit si dhe rritjen e të hyrave.
- Rënia e burimeve, si pasojë e mungesës së reshjeve mund të sjellë probleme në furnizim të rregullt.

## 1.4 PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

Si qëllime kryesore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. janë:

- Kontinuiteti i vazhdueshëm i prodhimit të ujit të pijshëm,
- Kontrolla e kualitetit të ujit të pijshëm të jetë në pajtim me instruksionet e lëshuara ngarregullorret në fuqi.
- Rritja e shkallës së inkasimit si dhe zvogëlimi i ujit të pafaturuar
- Rritja e shkallës së efikasitetit të punëtorëve.
- Mirëmbajtja e stabilimenteve Elektro-makinerike,
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet dhe evitim të prishjeve me kohë,
- Aktivitetet në përfundimin e projekteve për instalimin e ujëmatësave,
- Përpjekjet që çdo konsumatori të matet sasia e ujit të shpenzuar dhe të bëhet faturimi në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar,
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhëna të reja,
- Përpjekjet maksimale në identifikimin e klientëve të rinj,
- Angazhimi në mbledhjen e borgjeve të vjetëra si dhe inkasimi i faturave rrjedhëse,
- Identifikimi dhe rritja e numrit të konsumatorëve përfshirë këtu edhe lidhjet ilegale,
- Vazhdimi i informimit të konsumatorëve dhe bashkëpunimi me organet komunale në mënyrë që shfrytëzimi i ujit të bëhet në suaza normale,

### Treguesit kryesor të performancës- 2014

#### K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A PRIZREN

Treguesit e Performancës	[Njesia]	2014
		2014
Uje i faturuar-si perqindje	%	41.56
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	58.44
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	74.01
Norma e arketimit - Amviserite	%	68.91
Norma e arketimit -Komerical-Indu.	%	68.60
Norma e arketimit -Institucional	%	98.52
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.08
Staf per 1000 konsumatore	numer	7.20

## 1.5 INVESTIMET E RËNDËSISHME TË BËRA GJATË VITIT

(shiko shtesën I në fund të raportit)

## II. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

### 2.1 AKTIVITETET KRYESORE TË NDËRMARRA GJATË VITIT 2.1.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI TEKNIK

#### FURNIZIMI

Edhe pse prurjet e ujit në burimet e vjetra për vitin 2013 kanë rënie të madhe, por falë shtimit të kapaciteteve të reja të ujit në lokacionin e „40 Burimet“ kemi arritur për këtë vit të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë për të gjithë regjionin e Prizrenit, duke u furnizuar nga pusët e reja (tek 40 burimet) shpimet e puseve në njësinë e Suharekës, Malishevës, dhe shpimet i tri puse tek objektet e vjetra të „Hidroregjioni jugor“ në Prizren, këto shpime të puseve të reja janë realizuar me qellim për t'i zëvendësuar humbjet nga burimet e vjetra.

Kompania është angazhuar dhe ja ka arritur që në vitin 2013 të furnizojë të gjithë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku dhe kemi reduktime të shkurtra brenda ditës (*Kryesisht Lagja Dardania*). Në Njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka pas probleme me furnizim me ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e Njërive Operuese kemi pas furnizim pa ndërprerje me ujë të pijes.

#### UJI I PRODHUAR

Për vitin **2013** në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **19,273,475.00 m<sup>3</sup>** krahasuar me vitin 2012 kemi një rënie të prodhimit të ujit të pijes prej **340,816.00 m<sup>3</sup>**, (kjo rënie paraqitet si arsye i rënies të burimeve të vjetra) mirëpo KRU „Hidroregjioni Jugor“ shtuar aktivitetet dhe gjatë vitit ka siguruar burime të reja të ujit të pijes, dhe injektimin e kësaj sasive në rrjetin distributiv.

#### UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfidë kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falënderuar donatoreve kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogëlimin e UPF-se.

Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-se që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektorët e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogëlimin e UPF-se dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Është formuar grupi i veçantë brenda Departamentit Teknik për verifikimin e rrjetit shpërndarës dhe verifikimin e valvuleve në qytetin e Prizrenit. Deri më tani është verifikuar rrjeti shpërndarës si dhe janë duke i bërë analizat nëpër zonat e furnizimit.

UPF për vitin 2013 është **11,517,835.00 m<sup>3</sup>** ka një rënie të UPF-se krahasuar me vitin 2012 dhe atë me sasi prej **424,213.00 m<sup>3</sup>**.

Shërbimi Teknik është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u perpjekur për sanimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogëlimin e UPF-se dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Është formuar grupi i veçantë brenda Departamentit Teknik për verifikimin e rrjetit shpërndarës dhe verifikimin e valvuleve në qytetin e Prizrenit.

Raportet tregojnë që UPF në nivel regjional për vitin 2013 ka rënie, në **59.80 %** në krahasim nga vitin e kaluar kemi zvogëlim prej **1.13 %** të UPF.

Aktivitetet e shërbimit Teknik gjatë vitit 2013 në nivel regjional kanë qenë te pareshtura dhe janë orientuar në mundësinë e furnizimit sa më të rregullt me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët që kjo kompani i mbulon, si dhe në aktivitetet teknike për uljen e humbjeve si atyre teknike po ashtu dhe atyre administrative respektivisht uljen e vlerave të UPF-se.

Duke u bazuar në raportet e prodhimit të ujit për këtë vit niveli i ujit në burime e vjetra ka pasur rënie të dukshme, që kemi qenë të detyruar të bëjmë hulumtime të reja për shpime, me qëllim për t'i zëvendësuar humbjet në burimet ekzistuese.

Në vitin 2013 janë bërë hapja e puseve tek 40 burimet si dhe janë kryer punimet për hapjen e galerisë duke krijuar lidhjet e puseve me një sistem të përcjellës në gypin kryesor me qëllim për të furnizuar me ujë tërë qytetin e Prizrenit, dhe këto puse sjellin një sasi të ujit afërsisht 110 l/s, kështu që kjo galeri mundëson rrjedhje të ujit me rënie të lire si dhe sipas nevojë edhe me sistemin e pompave.

Instalimi i rrjetit të ri të ujësjellësit në fshatin Mushtisht me gyp DN-63mm PE në linjat sekondare dhe me gyp  $\frac{3}{4}$  në lidhjet individuale, me gjatësi të përgjithshme rreth 1500m.

Realizimi i daljes nga gyp DN-315mm PE nga Savrova-rez-Shirokë me gyp DN-63mmPE- Në hyrje të fshatit Sopijë nga Suhareka me kërkesën e një grupi të konsumatorëve për kyçe në këtë gyp të ujësjellësit është realizuar një dalje nga gyp kryesor DN-315mm/DN-63mm. Kjo dalje do të vlejë për të gjithë ata konsumatorë të cilët gjenden për rreth kësaj dalje e cila do të jetë e kontrolluar .

Departamenti teknik gjatë vitit 2013 ka pasur defekte në rrjetin ujësjellës dhe të kanalizimit, duke munduar të bëjnë riparimet sa më shpejt nga ana e operativës në rrjetin e ujësjellës dhe të kanalizimit, kështu që kemi pas 1792 defekte në rrjetin e ujësjellës dhe 779 defekte në rrjetin e kanalizimit, njëkohësisht janë bërë edhe kontrollimi i pusëve, pastrimin e gypave etj, kështu që në intervenimet në rrjet të kanalizimit dhe të ujësjellës janë gjithsej 2571 raste.

Aktiviteti i në këtë vit është edhe realizimi i punimeve të 40 Burimet duke bërë shtrirje të gypit  $\Phi$  315 me gjatësi mbi 250 metra duke realizuar shtimin e sasisë së ujit nga komora e ujëmbledhësit deri tek injektimi në gypin  $\Phi$  600 mm.

Vlera për realizimin hynë në kuadër të projektit „Pastrimi i Lumit Bistrica në Prizren“ projekt i cili është financuar nga MMPH, MZHE dhe nga kompania e HRJ në Prizren.

Sasia- distanca e shtrirjes së gypit është 250 metra me diametër  $\Phi$  315



Vendi – shtrirja e gypit prej 40 burimeve ne drejtim të hyrjes të qytetit të Prizrenit

Në këtë vitë nga MZHE janë nënshkruar dy marrëveshje për te financuar projektin për ndërtimin e rezervarit në Baqevc vendi i quajtur „ Krismat e Sali Shabanit” me shumën prej 500 mijë euro, dhe për rrugën e „Muhagjerve“ me shume prej 119 mijë euro projekt i cili i ka përfunduar, kurse projekti i rezervuarëve është në vazhdim edhe për vitin vijues. ( ekziston raport i veçantë nga Njësia e Suharekës)

Takim me përfaqësuesit e ZRRUK-ut lidhur me nënshkrimin e një marrëveshje për plotësimin e standardeve për furnizim me ujë për lagjen e Dardanisë me qellim që lirohemi nga performanca për 600 konsumator të kësaj lagje.

Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Semetisht- Janë rregulluar të gjitha defektet në rrjetin ekzistues dhe është zëvendësuar një pjesë e rrjetit me gjatësi L=1200m me gyp DN-90mm PE. Për shkak se në kanalën ku ka qenë gypi ekzistues i ujësjellësit ka pas edhe shumë gypa privat, janë bërë edhe shumë defekte pasi që ka qenë e pa mundur të punohet pa i dëmtuar këta gypa të cilët pas përfundimit të punës janë riparuar, kjo ka qenë edhe njëra nga arsyt që punimet kanë zgjatur shumë.

Takime të menagjmentit me banoret e lagjes Dardania për furnizim më të rregullt me ujë, gjatë takimit kemi biseduar për eliminimin reduktimeve duhet të bëhet grumbullimin 50 % borxheve dhe për shuhen e grumbulluar do të kthehet në investim, me ndërtimin e një rezervari si dhe instalimi i gypit furnizues nga rezervari deri te sistemi ekzistues, ky projekt ende nuk është realizuar për shkak se konsumatorët e kësaj lagje nuk po i përgjigjen pagesës së borxheve.

Në takim me menaxhmentin e „Hidroregjionit“ jemi akorduar që për shkak te keqpërdorimit te ujit te pijes nga disa konsumatorë, lagje ose fshatë të mos ketë furnizimi të rregullt me ujë të pijes aty ku ka keqpërdorime te mëdha te ujit, ne baze te matjeve nga ujëmatësit zonal, këto zona të aplikohen në të gjithë regjionin e Prizrenit.

Kohë më parë është nënshkruar Marrëveshja me përfaqësuesit e fsh. Kabashë, HRJ si dhe nga Kryetari i Komunës se Prizrenit. Nga kjo marrëveshjeje sistemi i ujit te pijes kalon nën menaxhimin e Hidroregjionit jugor, ku ekipet tona e kane verifikuar gjendjen e ujësjellësit dhe te kanalizimeve ne fshatë si dhe kanë bere instalimin dhe bllobimin e ujëmatësve tek të gjithë konsumatorët.

Ne vitin 2013 janë bërë shpime te puseve ne fsh.Sallagrazhd për furnizimi me ujë qytetaret e komunës së Suharekës dhe jemi në përfundim të punimeve,( ndërtimi i dy rezervarëve) me qellim që furnizim me ujë të jetë i mjaftueshëm për qytetarët e Suharekës dhe fshatrat për rreth.

Vlera e projektit deri tani- 650 mijë euro, projekti vazhdon edhe në vitin vijues.

Sasia e ujit që parashihet të sigurohet – 150 l/s

Vendi I ndërtimit te rezervarve është në Baqevc, vendi “Krismat e Sali Shabanit”

Investitori – Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Komuna e Suharekës.

Nga Departamenti Teknik janë plotësuar dokumentacionet e nevojshme për Pëlqimet-Lejet përkatëse te cilat janë dërguar ne MMPH dhe ne Komune e Prizrenit për projektin Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave te Zeza. Pasi qe lidhur me lejet përkatëse për ndërtimin e ITUZ-se , janë dy institucionet përgjegjëse:

- ✚ Ministria përgjegjëse për çështjet mjedisore që lejon projektimin, sistemin dhe shkallën e procesit të trajtimit, dhe

- ✚ Komuna e Prizrenit e cila për rehabilitimin dhe ndërtimin e dy kolektorëve si dhe ndërtimin e ITUZ-se do të jep lejen përgatëse.

Sa i përket Projektit Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave të Zeza, Kompania P2M dhe ajo vendore Alb-Architect janë në bashkëpunim me Stafin Teknik të HRJ-se duke grumbulluar informacione teknike dhe administrative të cilat do të ndikojnë në mbarëvajtjen e projektit.

Është bërë hulumtimi e ujit të pijes për komunën e Malishevës me shpimin e puseve në fsh. Senik (5) puse me prodhim afërsisht mbi 60 l/s si po vazhdohet me ndërtimin e galerive prej puseve deri tek rezervari me qëllim për të furnizuar edhe fshatrat për rreth të Malishevës. Me qëllim të furnizimit të 12 fshatrave me rreth 20.000 mijë banorë.

Janë mbajtur takime të vazhdueshme me përfaqësues të fshatit Brezne dhe zyrtar të Kuvendit Komunal për marrjen në menaxhim të fshatit Brezne si dhe është verifikuar gjendja ekzistuese e ujësjellësit të fshatit Brezne, ujësjellës ky i cili në muajin dhjetor është vënë në funksion me ndihmën e donatorëve dhe Kuvendit Komunal në Dragash.

Gjatë kësaj periudhe së vitit 2013 kemi pasur furnizim të qytetareve me ujë të pijes edhe përmes cisternës në ato vende ku ka pasur defekte ose mungesë të ujit.

Departamenti teknik ka bërë të gjitha përgatitjet për të zgjidhur problemin e ujit të pijes për qytetin e Prizrenit dhe ka bërë projekte ideore dhe shumë të përafërt, me qëllim që këto projekte ideore të prezantohen në një të ardhme asamblesë komunale në Prizren.

Gjatë fundit të vitit 2013 janë bërë shpime të tri puseve tek objektet e vjetra të kompanisë sonë me qëllim që të ketë furnizim me të rregullt për qytetaret e Prizrenit e sidomos për pjesën e Tususit.

Në këtë vit rregullisht janë bërë leximet e ujëmatësve zonal për çdo muaj me qëllim për të verifikuar shpenzimet e ujit nëpër zonat e veçanta.

## **2.1.2 AKTIVITET E SHERBIMIT TEKNIK TË NDERMARRË PËR ELEMENIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE**

- ✚ Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale,
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike,
- ✚ Sensibilizimin e të gjithë konsumatorëve për mos keqpërdorim të ujit të pijes përmes informatave mediale dhe atyre të shkruara,
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të grithe konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyre që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

## **2.1.3 PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE EMERGJENTE TË KOMPANISË PËR TË PËRMIRËSUAR SITUATEN E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJES:**

Implementimi i pjesës së parë dhe të dytë të Fazës së Dytë të projektit kryesor „40 Burimet“ i cili parasheh:

Ndërtimin e Komores ujëmbledhëse dhe injektimin e sasisë së re të ujit të pijes në rrjetin distributiv të qytetit të Prizrenit. Është përpiluar projekti ideor i ndërtimit të galerisë përcjellëse dhe ndërtimi i komores kryesore i cili për të realizuar arrin vlerën e përafërt prej rreth 180,000.00 Euro, dhe hulumtimi dhe kaptimi i burimeve ekzistuese në afërsi të kaptazhes së IV-të i cili kap vlerën prej 220,000.00 Euro. Nga konsulenca e KfW-se kryesisht nga përfaqësuesi i tyre Kurt Lushin jemi njoftuar për fondet shtese nga KfW për financimin e këtij projekti. Shume shpejte është parapare një takim me Konsulencën për

detajet e mëtatjeshme te këtij projekti. Staf i inxhinierëve te Kompanisë është duke e hartuar projektin shtese për hulumtimin dhe kaptimin e ujit në afërsi të Kaptazhes së IV-të.

Hulumtimi i ujit në zonat e larta kryesisht në fshatin Leskovec, me qëllim të mbulimit me furnizim të lagjes TUSUZ.

Vendosjen e linjës së veçantë nga Marashi deri tek ETC-ja që parasheh ndarjen e zonave të furnizimit. Ndarjen e furnizimit të fshatrave dhe lagjes Bajram Curri nga rrjeti furnizues i qytetit, nga departamenti teknik është hartuar projekti i cili ka vlerën e përafërt prej 196,000.00 Euro.

Kompania HIDROREGJIONI JUGOR në Planin e Biznesit dhe në Strategjinë Zhvillimore ka planifikuar edhe planin afatgjatë të investimeve për ujësjellës dhe kanalizim.

Në bashkëpunim me K. e Prizrenit kemi hartuar planin investiv për ujë dhe kanalizim në të cilin kemi paraqitur planin dhe dinamiken e përfundimit të këtyre punimeve me të cilat planifikojmë të zgjidhim përfundimisht furnizimin 24 orësh me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët e regjionit të Prizrenit ku kjo kompani i mbulon. *(Ekziston Plani investiv i Kompanisë i cili duhet të revidohet në fillim të vitit 2013.)*

Zgjerimi i veprimtarisë së Kompanisë për marrjen e sistemeve Rurale nën menaxhimin e HRJ-së.

Kompania ka përpiluar hartat me mbëlueshmeri të cilat i bashkangjiten këtij raporti.

*Për më tepër ekziston pershkrimi në form tabelare i investimeve për vitin 2013.*

Në bazë të raporteve për vitin 2013 nga të gjitha Njesitë Operative të KRU "Hidroregjioni Jugor" kemi pasur furnizim të rregullt 24 orësh me ujë të pijes si në Prizren, Malishevë, Suharekë dhe Dragash (në prejashtim të zanes të Dardanisë).

#### 2.1.4 FURNIZIMI ME UJË NË NJËSITË PUNUJËSE

##### Njësia operative Suharekë

Furnizimi me ujë gjatë këtij viti ka qenë kryesisht i mirë dhe pa reduktime, me përjashtim të fshatit Dobërdelan, ku sasia e ujit që sigurohet momentalisht nuk është e mjaftueshme për tërë fshatin. Kjo situatë është e tillë për shkak se kur është marrë në menaxhim ky fshat, Komuna ka premtuar se do t'ia pajisë me të gjithë infrastrukturën e nevojshme edhe një burim tjetër të ujit, siç është rrjeti elektrik, tubacionet dhe pompa e ujit, por kjo nuk ka ndodhur deri më tani. Në si njësi punuese, kemi kontaktuar më herët me përfaqësuesin e fshatit, ia kemi përgatitur paramasën dhe parallogaritë për funksionalizimin e atij burimi të ujit dhe i njëjti i është dorëzuar komunës, por nuk kanë ndërmarrë asgjë deri më tani.

\*Para disa ditësh e kam ngritur këtë çështje edhe me zyrtarët e rinjë komunal dhe shpresoj se do të kemi një angazhim konkret të tyre, në funksionalizimin e atij burimi.

\*Probleme më të vogla me furnizim me ujë ka pasur edhe në fshatin Studenqan në fillim për shkak të prishjes së një pompe e më vonë edhe si pasojë e thatësisë ku kemi pasur rënie të vazhdueshme të sasisë së ujit.

Në lagjen Fidanishtë, Sallagrazhde dhe në Savrovë, kemi pasur djege të pompave, sipas të gjitha gjasave edhe për shkak të tensionit të ulët të rrymës elektrike, gjë të cilën gojarisht e kanë pranuar edhe zyrtarët e KEDS-it.

\*Analizat e ujit – 2013 Gjatë këtij viti janë realizuar 143 mostra të analizave bakteriologjike dhe 6 mostra të analizave fiziko-kimike dhe prej tyre 137 i janë përgjigjur standardeve, kurse 6 nuk i janë përgjigjur.

\*Instalimi i rrjetit të ri të ujësjellësit në fshatin Mushtisht me gyp DN-63mm PE në linjat sekondare dhe me gyp ¾ në lidhjet individuale, me gjatësi të përgjithshme rreth 1500m.

Investimet 2013, Realizimi i daljes nga gypi DN-450mm PE nga Pusi i atit-Rezervuari në Shirokë me gyp DN-63mm PE për biznese.

\*Përgatitja e vendit për realizimin e lidhjes së gypit DN-315mm PE nga rezervuari kryesor "Krismat e Sali Shabanit" me gypin ekzistues DN-450mm PE te Pusit Atit në Gelanc.

### **Raport për ndërtimin i Rezervuarëve të ujit "Krismat e Sali Shabanit" në Baçevc – Suharekë**

Disa detaje teknike dhe arsyeshmëria e investimeve në këtë project - Projekti Rezervuari i ujit me vëllim  $V=3000 \text{ m}^3$  „Krismat e Sali Shabanit“ në Baçevc, është financuar nga MZHE, me vlerë prej 500 mijë euro. Në kuadër të këtij financimi përfshihet edhe shtrirja e linjës së tubacioneve me diametër DN 315 mm PE prej Rezervuarit deri në magjistralen Prizren-Suharekë më saktësisht në rrugën e fshatit Gelancë, në gjatësi prej 5000 m, ku përfshihet hapja e kanalit me thellësi 150 cm, shtrirja e tubacioneve, hapja e pesë pusetave përgjatë linjës, furnizimi dhe montimi i një valvole për ndalje dhe një për zbrazje në secilën nga këto puseta si dhe vendosja e pusetave prej betoni për mbrojtjen e këtyre valvolave. Poashtu në pikë takimin e kësaj linje me linjën ekzistuese të tubacioneve në vijën Pusi atit – Suharekë me diametër të tubit DN 450 mm PE, është hapur puseta, është bërë depërtimi me shpim i tokës nën rrugë, është bërë furnizimi dhe lidhja e gypave me paisje të diametrit përkatës, si dhe është ndërtuar puseta prej hekuri dhe betoni për mbrojtjen e paisjeve të kësaj lidhje.

Krahas këtij projekti, në afërsi të Rezervuarit është bërë hapja e tetë puseve me thellësi të ndryshme, të cilat pasi janë matur dhe testuar, është konstatuar se sigurojnë një sasi të ujit prej 70 l/s. Kjo do të thotë se Rezervuari me vëllim prej  $3000 \text{ m}^3$ , mbushet me ujë përafërsisht për 14 orë dhe furnizon me ujë për 24 orë rreth 15.000 banorë, duke i llogaritur nga 200 l ujë për një banor.

Përpos kësaj sasi të ujit, në një distancë prej rreth 1200 m më lartë nga Rezervuari, është gërmuar një sasi e madhe dheu si dhe janë shpuar edhe pesë puse tjera. Këtu është paraparë të gërmohet (thellohet) edhe për 7-8 metra dhe varësisht nga pjerrtësia e terrenit në disa metra gjatësi, ashtu që të ndërtohet një lloj galerie ku do të grumbullohet një sasi e konsiderueshme uji (sipas parashikimeve 30-40 l/s) me rënie të lirë, si dhe uji që do të futet në galeri me pompa nga puset në afërsi rreth 40 l/s. Kjo sasi uji do të vjenë në Rezervuar me rënie të lirë dhe praktikisht sasia e tërësishme e ujit në këtë projekt llogaritet të jetë rreth 150 l/s.

Duhet theksuar se shpimi i këtyre puseve është financuar nga Komuna e Suharekës në vlerën prej 150 mijë euro, sipas një marrëveshje të nënshkruar në mes të zyrtarëve komunal dhe atyre të K.R.U „Hidroregjioni jugor“ në Prizren, ndërsa gërmimet e gjerëtanishme janë kryerë me vet financim të Kompanisë.

\*Arsyeshmëria ekonomike e projektit-Me realizimin e tërësishëm të këtij projekti, planifikohet të furnizohen me ujë të pijes edhe disa fshatra të Komunës së Suharekës që deri më tani nuk kanë pasur furnizim, si Greikoci, Gelanca, Leshani, Tërnya, Dubrava, Baçevci, si dhe Gjinoci e Sallagrazhda (përmirësim i furnizimit).

\*Për shkak të afërsisë së madhe të pompave me Rezervuarin, zvogëlohet në masë të madhe munda i pompave sepse punojnë vetëm në nxjerrje të ujit dhe jo edhe në shtyrje në distancë të gjatë siç është rasti te Pusi i atit, ku pompohet uji në gjatësi 10 km dhe kjo na mundëson të përfitojmë në masë të madhe në jetëgjatësinë dhe rendimentin e pompave.

\*Një sasi e konsiderueshme e ujit në Rezervuar vjenë me rënie të lirë.

\*Rezervuari gjendet në lartësinë mbidetare që i mbulon me rënie të lirë, të gjitha vendbanimet e lartë cekura si dhe disa pjesë të qytetit të Suharekës që deri më tani nuk kanë mundur të furnizohen me sistemin ekzistues.

\*Dukshëm reduktohen shpenzimet e rrymës elektrike që deri më tani po ndikojnë negativisht në performancën financiare të Njësisë tonë.

\*Zgjerohet zona e vendbanimeve nën menagjimin e Kompanisë, që sigurisht do të ndikoj edhe në rritjen e inkasimit dhe përmirësimin të performancës.

## ARSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN/MOS ARRITJEN E OBJEKTIVAVE

- \*Mos angazhimi i mjaftueshëm i disa Inkasantëve në përmbushjen e obligimeve sipas normës së caktuar.
- \*Kundërshtimi i një pjese të madhe të konsumatorëve për t'iu përgjigjur obligimeve ndaj Kompanisë.
- \*Shfrytëzimi ilegal i ujit të pijshëm.
- \*Kërcënimi fizik i Inkasantëve dhe ekipës për kontrollë dhe shqyçje.
- \*Ndërprerja e përkohshme e ujit në vendbanime të veçanta si pasojë e defekteve të ndryshme, djegëjes së tri pompave si në Fidanishte, në Savrovë dhe në Sallagrazhdë, si dhe zvogëlimit të sasisë së ujit në fshatin Studenqan si pasojë e thatësisë që ka mbretëruar në gjysmën e dytë të vitit.
- \*Mosaplikimi i shqyçjeve kolektive të konsumatorëve që nuk paguajnë faturat e ujit dhe vështirësit objektive që paraqiten në raste të caktuara për shqyçje individuale, për shkak të dëmtimit të rrugëve dhe trotuareve.
- \*Shpenzimet e mëdha të rrymës elektrike.

## MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

- \*Puna sa më me përgjegjësi dhe korrektësi të plotë në teren e Inkasantëve dhe ekipit të Kontrollës, në leximin e rregullt të ujëmatësve, shpërndarjen e rregullt të faturave, hulumtimin dhe zbulimin e lidhjeve ilegale në rrjet, si dhe pasivizimin apo eliminimin nga lista e konsumatorëve të cilëve nuk iu ofrohen shërbimet tona, ose për shkaqe objektive, nuk i shfrytëzojnë këto shërbime.
- \*Ngritja e vazhdueshme e nivelit të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë në punë e shërbimit operativ në teren, duke siguruar furnizim sa më të mirë me ujë të pijshëm dhe me parametra optimal higjieno-sanitar, riparimin efektiv dhe në kohë reale të defekteve të ndryshme që mund të shfaqen në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, ashtu që ndikon në rritjen e imazhit pozitiv të Kompanisë tek konsumatorët dhe qytetarët në përgjithësi.
- \*Ngritja e vazhdueshme e nivelit të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë në punë e shërbimit për konsumatorë, duke siguruar trajtim sa më korrekt dhe profesional të të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, shqyrtimin e tyre dhe kthimin e përgjegjës në kohë reale, si dhe eliminimin e anomalive të ndryshme në listat e konsumatorëve, siç është faturimi i dyfishtë, mbingarkimi eventual në muaj të caktuar, faturimi paushall i konsumatorëve që nuk dihet se pse janë regjistruar, derisa për kohë të gjatë ose nuk kanë ujë, ose nuk e shfrytëzojnë ujin e rrjetit, ashtuqë po krijohen borgje të këqija dhe asnjëherë nuk kemi një gjendje përafërsisht reale në këto lista.
- \*Rritja e presionit ndaj Institucioneve komunale dhe bizneseve të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë tonë.
- \*Bashkëpunimi me mediat lokale në sensibilizimin e konsumatorëve në veçanti dhe opinionit publik në përgjithësi, mbi domosdoshmërinë e shfrytëzimit sa më racional të ujit, si një artikull jetik për kualitetin e jetës së qytetarëve dhe ndërgjegjësimin të vazhdueshëm të tyre për obligimet që kanë ndaj Kompanisë në shfrytëzimin legal të ujit dhe pagesën e tij.
- \* Bashkëpunimi me Organet udhëheqëse komunale dhe Inspektoratin në arritjen e këtyre objektivave të parashtruara në pikën 5. qoftë edhe duke e kushtëzuar pagesën e ujit me ndonjë shërbim komunal, derisa kjo të parashihet si zgjidhje e duhur dhe e nevojshme.
- \*Bashkëpunimi me Organet udhëheqëse komunale si Drejtoria e shërbimeve publike, në përfundimin sa më të shpejtë të projektit të ndërtimit të rezervuarit të ujit me të gjitha punët përcjellëse, që po zhvillohet në Sallagrazhdë, në vendin e quajtur „Te krismat e Sali Shabanit“, i cili projekt do të siguroj sasi të konsiderueshme të ujit të pijes për shumë vendbanime të Komunës sonë dhe njëkohësisht, në masë të madhe do t'i reduktoj shpenzimet, sidomos ato të rrymës që patjetër do të ndikojnë dukshëm në rritjen e performancës pozitive në njësinë tonë.

## Njesia operative Malishevë

Prodhimi:Gjatë vitit 2013 Prodhimi mesatar ka qenë 42.10 l/s i cili prodhim ka siguruar furnizim te qëndrueshëm gjatë 24 orëve për të gjithë konsumatorët e vendbanimeve që ne i menaxhojmë. Pra 14 Fshatra dhe Qyteza e Malishevës me 26.670 banorë janë furnizuar me ujë pa reduktime gjatë 24 orëve.

Këto 15 lokalitete janë furnizuar me ujë nga 6 burime . prej tyre : 4 janë burime nëntokësore me 6 puse me thellësi 45 m , 2 burime sipërfaqësore .

Stacioni pompues në Banjë (ujë nëntokësor) Tre puse , 5 pompa me gjithësejtë =132.5 kw.

Stacioni pompues në Gurbardh (ujë nëntokësor) Dy puse x 2 pompa thithëse dhe transportuese= 36 kw.

Stacioni pompues në Bubël ( ujë nëntokësor) Një pus ,Gjithësejtë 3 pompa =42.50 kw.

Stacioni pompues në Maxharre (ujë sipërfaqësor) Dy pompa centrifugale nga 11.5 kw =23 kw.

Stacioni pompues në Kervasari (ujë sipërfaqësor) Tre pompa centrifugale = 25.5 kw

Ujësjiellësi në fshatin Lladrofc (ujë me gravitet)

Numri i përgjithshëm i pompave =15

Fuqia e pompave = 259.50 kw

KOMENTET:

Rritja e kons. të ri është =163 ose 4.63 % , Institucione = 1 ose 2.3 % , Lokale = 47 ose 9.9 % , Amvisëri = 115 ose 3.8 % . Kjo rritje e nr. të kons. të ri është rritje nga puna e ekipës së kontrollës dhe të inkasantëve në të gjitha fshatrat që ne i menaxhojmë.

Kyqje ilegale =97 ,Legalizim I k. ilegale = 53, Çkyqje =44, Pëlqime = 50 , Kyqje të tjera pa pëlqime si rastet sociale =60, Njoftime për shkyqje =1460 , Shkyqje për mospagesë = 93 , Rikyqje =79 , Riprogramim të borgjit = 8 , Inkasimi nga kontrolla = 18.510.92 €

Gjatë vitit 2013 Faturimi në m<sup>3</sup> ka qenë më i ulët se planifikimi :Planifikimi i faturimit = 20 m<sup>3</sup> për 1 konsumatorë ,Faturimi gaktik = 13 m<sup>3</sup> për 1 konsumatorë ,Si pasojë e faturimit të ulët në m<sup>3</sup> , është reflektuar drejtëpërsdrejti edhe në vlerën e faturimit në €

Arësyet :Mosleximi I saktë I ujëmatësave nga ana e disa inkasantëve ,Humbjet komerciale të ujit vjedhjet ,Kyqjet ilegale ,Puset individuale të cilët gati çdo familje i ka në oborret e tyre ,po ju vështirësojnë punën ekipës së kontrollës në zbulimin e k. ilegale.

ARËSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN /MOSARRITJEN E OBJEKTIVAVE

Mosplotësimi i normës së inkasimit nga ana e tre inkasantëve: 1.Fazli Kastrati , 2.Veli Begaj ,dhe 3.Haxhi Buçaj ,të cilëve ju është dhënë njoftimi me gojë dhe me shkrim për mundësinë e largimit nga puna .

Angazhimet shtesë me punëtorët sezonal të MPMS ( 30 sosh), në projektin” Hapja dhe montimi i ujëmatëmatësave jashtë dyerve për të gjithë konsumatorët e Njesisë operative në Malishevë.

Gjatë tre muajve (tetor,nëntor ,dhjetor /2013 ) këta 30 punëtorë janë transportuar rregullisht me makinat e Njesisë ku katër punëtorë të rregullt të Njesisë –Malishevë kanë qenë të ngarkuar në transportimin dhe udhëheqjen e tyre në kryerjen e detyrave të parapara.Këto punë dhe shërbime I kanë kushtuar Njesisë në Malishevë rreth 1000 litra naftë dhe katër paga mujore =12 paga .

\*Mosaplikimi I shkyqjeve individuale të konsumatorëve që nuk paguajnë faturat e ujit për shkak të angazhimit të vazhdueshëm të eskavatorit në realizimin e shumë projekteve investive vetanake.

Rritja e shpenzimeve të energjisë elektrike nga tarifa dimërore (tetor-dhjetor)13 për 12.657.08 € më shumë .

Rritja e shpenzimeve operative si nga defektete shumëta të ndodhura këtë vit= 189 defekte

Rritja e shpenzimeve për shkak të realizimit të shumë projekteve të realizuara me investime vetanake e që një pjesë e tyre nuk janë kategorizuar si shp. Investive.

MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PËRFORMANCËS

Mbështetja e inkasantëve me ekopëne kontrollës në shkyqjen e të gjithë konsumatorët që kanë borgje mbi 300 € ,

Rritja e presionit të vazhdueshëm ndaj të gjithë konsumatorëve që nuk I kryejnë obligimet ndaj kompanisë ,

Rritja e bashkëpunimit me organet Komunale-inspektoriatin në ndaljene keqpërdorimit të ujit dhe zbulimin e k. ilegale ,

Rritja e bashkëpunimit me Shpk-në në realizimin e shkyqjeve individuale ,

Aplikimi edhe i shkyqjeve kolektive nëse mbi 50 % të konsumatorëve nuk e paguajnë faturën e fundit,me lejen e ZRRUK-it,

Largimi nga puna i tre inkasantëve për performance të dobët pas 31.03.2014, kur ju skadon kontrata. Realizimi i normës së inkasimit nga të gjithë inkasantët duke garantuar mbulueshmëri operative dhe financiare .

### Njesia punuese Dragash

Gjendja e përgjithshme e Njesisë Operative në Dragash gjatë vitit 2013 ka qenë e mirë dhe pa probleme të theksuara. Jemi angazhuar vazhdimisht në zvoglimin e humbjeve të ujit të pa faturuar, rritjen e përqindjes së inkasimit, vënjen në funksion të ujsjellsit në një lagje të fshatit Shajne si dhe në marrjen në menaxhim të fshatit Brezne.

Aktivitetet janë kryer në vazhdimësi kurse defektet e paraqitura janë eliminuar menjëherë e kjo ka bërë që furnizimi i qytetarëve me ujë të jetë i rregullt dhe pa ndërprerje apo reduktime.

I është kushtuar kujdes i veçantë trajtimit të ujit (Sendimentimit, kaugulimit, filtrimit dhe klorizimit), gjë që e dëshmojnë dhe vlerat e analizave të ujit të cilat gjithë kohën kanë qenë negative dhe brenda standardeve të kërkuara.

Gjatë këtij viti kemi eliminuar problemet që vazhdimisht në të kaluarën janë paraqitur në rrjetin e fshatit Pllavë, kemi eliminuar disa defekte në qytet si dhe kemi përmirësuar shtypjen e ujit në lagjen mbi spitalin e qytetit ku vazhdimisht shtypja e ujit ka qenë e dobët.

Përmirësimi i vazhdueshëm i gjendjes së furnizimit me ujë ka bërë që qytetarët të jenë të kënaqur me shërbimet tona e kjo ka ndikuar edhe në rritjen e inkasimit ndërsa eliminimi i problemeve të lartëcekura ka ndikuar në zvoglimin si të humbjeve të ujit poashtu dhe në zvoglimin e shpenzimeve të njesisë.

Shumica e objektivave të parapara të Njesisë gjatë këtij viti në përgjithësi janë realizuar e poashtu edhe mbulimi operativ i njesisë ka qenë i mirë.

### 2.1.5 PRODHIMI I UJIT m<sup>3</sup> viti – 2013

Tabela:6

Muaji	Prodhimi mujor m <sup>3</sup>	Prodhimi ditor- m <sup>3</sup>	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	15,580,205.00	42,685.49	494.0	
Suharekë	1,905,717.00	5,221.14	60.4	
Dragash	461,198.00	1,263.56	14.6	
Malishevë	1,326,355.00	3,633.85	42.1	
<b>Total</b>	<b>19,273,475.00</b>	<b>52,804.04</b>	<b>611.2</b>	

### 2.1.6 MIRËMBAJTJA E RRJETIT – SANIMI I DEFEKTEVE viti – 2013

Tabela:7

Njësia Operative	Ujësllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	1284	650	1934
Suharekë	274	62	336
Dragash	47	5	52
Malishevë	187	62	249
<b>Total</b>	<b>1792</b>	<b>779</b>	<b>2571</b>

### 2.1.7 SHËRBIMIMI I MIRËMBAJTJES–SERVISIMIT TË UJËMATËSAVE: Ø(13 - 100)MM- 2013

Tabela:8

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	531	Prej dates 12.03 – 17.03.2013, dy ekipe të demont.-montimit të ujëmatësave janë angazhuar në montimin e ujëmatësave në f.Mushtisht. Kurse prej datës 18-31.03.2013, është angazhuar vetëm një ekip i demontim-montimit të ujëmatësave.
	3/4"	1077	
	1"	137	
	5/4"	4	
	6/4"	2	
	Gjithsejt:	1751	
Suharekë	1/2"	5	
	3/4"	21	
	1"	0	
	Gjithsejt:	26	
Dragash	1/2"	7	7 ndrrime,3montime
	3/4"	35	
	2"	2	
	Gjithsejt:	44	
Malishevë	1/2"	10	3 ujmatasa te ndrruar, ndersa 14 ujmatasa te montuar me vetefinancim
	3/4"	80	
	1"	3	
	Gjithsejt:	93	

Totali : 1914 ujëmatës

### 2.1.8 ZYRA PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM

Për vitin 2013 në kuadër të zyrës së plan zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar bllobimet nëpër qytetin e Prizrenit për të kryer refreshimin dhe kanë arritur këto rezultate: Ujëmatës të bllobuar 1818 ujëmatës, kontrata të nënshkruara 1818 Kontrata, Konsumatorët që ekipi jone nuk ka pasur qasje 2768 konsumator , kjo mos qasje është përcjellë nga ekipa dhe here pas here janë vizituar deri sa kanë arritur të kenë kontakt me konsumatorët.

Konsumatorët që ekipa ka konstatuar që duhet të zëvendësohet janë 105 ujëmatës, konsumatorët për shkak kushteve teknike që nuk janë bllobuar janë 7 konsumatorë, 145 konsumatorët kanë qenë pa ujëmatës, konsumatorët pa regjistruar 104, rekorde të reja 252 nga blockmapping, Instalim të 2

Tabela:8

Nr.	Prizren Total –Gjithësej	Total
1	Bllombim-Kontrata	1818
2	Dera Mbyllyr( Heren e dytë)	2768
3	Pa Regjistruar	104
4	Zavendësime	105
5	Pa Ujëmatës	145
6	Rekorde të reja për blockmapping	252
7	Instalim	2
8	Bllombim për herë të dytë	107
9	Aktivizim i fatures	24

ujëmatësve, bllobim 107 ujëmatësve për here të dytë, dhe aktivizim i 24 faturave.



## AKTIVITETET KRYESORE

Në zyrën e GIS'it gjithësej janë 54 harta të cilat prej tyre 16 janë importuar edhe janë nderlidhur me fakturim, 29 janë të cilat duhen të vizatohen prej terrenit, edhe 9 janë malore të cilat nuk ka nevojë për vektorizim.

Në zyrën e GIS'it katër harta ( 7F12-12-05,7E12-20-02,7E12-30-03,7F12-12-04) janë duke vektorizuar edhe duke përgaditur për tu transferuar në programin e GIS'it.

\*Stafi GIS'it,takim në Kuvendin Komunes së Prizrenit Departamentinë e Kartografisë. Sipas sistemit e vjetër blockmappingut sistemi koordinativ ka qenë sipas Gaus Krygerit. Është marrë të dhënat e Kosova Ref edhe është duke transferuar në sistemin e GIS'it.

Shumica prej të dhënave janë importuar në program por ka mbetur vetëm të importohen të dhënat për banesat edhe të transferuan sistemi koordinativ.

Gjatë këtij viti rrjeti i ujësjellësit prej sistemit koordinativ Gaus Kryger është kthyer në Kosova Ref. Janë importuar në programin e ArcGIS 10 , 27 harta, prej tyre 16 janë me të dhëna kompletuara. \* Janë eksportuara të dhënat prej faturistave për muajt Gusht,Shtator edhe janë nderlidhur me programin e ArcGIS'it. Hartat e importuara gjithësej në programin e ArcGIS'it janë 17 harta, rekorde të nderlidhura me faturista janë 23197

Tabela:9

Hartat e importuara me lidhje uji ne programin e ArcGIS 10	Hartat të cilat duhën të vizatohën prej terenit	Hartat Malore te cilat nuk ka nevojë te vektorizim	Hartat te cilat jane vizatuar prej terenit
1. Harta 7F12-11-07	1. Harta 7E12-20-08	1. Harta 7E12-30-11	1. Harta 7E12-20-02
2. Harta 7F12-11-08	2. Harta 7E12-20-11	2. Harta 7F12-12-16	2. Harta 7E12-20-05
3. Harta 7F12-11-09	3. Harta 7E12-20-14	3. Harta 7F12-22-01	3. Harta 7E12-20-17
4. Harta 7F12-11-10	4. Harta 7E12-30-05	4. Harta 7F12-22-04	4. Harta 7E12-30-02
5. Harta 7F12-11-11	5. Harta 7E12-30-05	5. Harta 7F12-22-07	5. Harta 7E12-20-03
6. Harta 7F12-11-12	6. Harta 7E12-30-08	6. Harta 7F12-22-10	6. Harta 7E12-20-15
7. Harta 7F12-11-13	7. Harta 7E12-30-11	7. Harta 7F12-21-09	7. Harta 7F12-20-18
8. Harta 7F12-11-14	8. Harta 7E12-20-06	8. Harta 7F12-21-12	8. Harta 7E12-30-03
9. Harta 7F12-11-15	9. Harta 7E12-20-09	9. Harta 7F12-21-11	9. Harta 7E12-30-06
10. Harta 7F12-11-16	10. Harta 7E12-20-12		10.Harta 7E12-30-09
11. Harta 7F12-11-17	11. Harta 7E12-30-12		11.Harta 7E12-12-04
12. Harta 7F12-11-18	12. Harta 7F12-11-01		
13. Harta 7F12-21-01	13. Harta 7F12-11-04		
14. Harta 7F12-21-02	14. Harta 7F12-21-07		
15. Harta 7F12-21-04	15. Harta 7F12-21-10		
16. Harta 7F12-21-05	16. Harta 7F12-11-02		
	17. Harta 7F12-11-05		
	18. Harta 7F12-21-08		
	19. Harta 7F12-11-03		
	20. Harta 7F12-11-06		
	21. Harta 7F12-21-03		
	22. Harta 7F12-21-06		
	23. Harta7F12-12-01		
	24. Harta 7F12-12-07		
	25.Harta 7F12-12-10		
	26.Harta 7F12-12-13		

\*Per keto vite Janë importuar 11 harta te reja ne programin e GIS'it dhe jane nderlidhur me faturim.

Bllombim ne fshatrat : Srbica e Ulet, Pusko, Shkoze dhe Dobrushte: Ujematëse te bllombuar 264, Nënshkrim I kontratave 264, Dera Mbyllyr 130, Zëvendësim 9, Pa ujëmatës 28, Konsumatorët te paregjistruar 1, Problem teknik arritja tek ujëmatësi 3, Rekorde të reja për blockmapping 218, Lidhja ujit jo 86

Bllombim ne fshatin Vermicë: Ujëmatësa te bllombuar 75, Nënshkrim I kontratave 75, Dera Mbyllyr 34, Zëvendësim te 3, Pa ujëmatës 3, Konsumator te pa regjistruar 1, Nuk ka pasur problem teknik, arritja tek ujëmatësi, Nuk ka pasur rekorde te reja për blockmapping

Bllombim ne fshatrat: Nashec, Grazhdanik, Atmaxhë, Zhur, Shkozë, Vlashnje, Dobrusht, Kushnin: Ujëmatës te bllombuar 28, Nënshkrim i kontratave 28, Dera Mbyllyr 3, Bllombim per here te dyte 29, Nuk kane pasur qasje te konsomatori (pusetat e bllokuara) 5.

Janë realizuar takime ne mes USAID-it, KRU "Hidroregjioni Jugor"Sh.a dhe kompanisë implementuese te projektit Infra Plus në zyret e kompanis me qrast janë raportuar te arritura ne realizimin e projektit "Rehabilitimi I rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Kobaj.

Monitorimi i vazhdueshëm i punimeve në realizimin e projektit Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit në fshatin Kobaj ku deri me tani janë realizuar 95% e punimeve të parapara në projekt. Ky projekt parashifet të përfundoj Brenda muajit Shkurt 2013.

Vizitë në Njesin e KRU "Hidroregjioni Jugor"Sh.a në Malishevë. Gjatë vizitës është shqyrtuar mundësia e furnizimi me ujë të fshatit Drenovc, pas shqyrtimi të mundësive është ardhur në përfundim që të hapen puse tek lokacioni afër autostradës dhe është hartuar projekti ideor ku përfshin hapjen e puseve si dhe rrjeti shpërndarës për këtë vendbanim.

Është formuluar lista e projekteve prioritare për njesin e Prizrenit ku do të prezantohet para K.K Prizrenit ku kjo listë përmban 13 projekte që kryesisht kanë të bëjnë me shtimin e kapacitetit të ujit për Komunën e Prizrenit.

Kemi filluar që të hartojmë projektet ideore për të gjitha këto projekte ku parashikojmë që do të jenë të gatshme deri në fund të muajit Shkurt.

Hartimi i projektit ideor për ndërtimin e depozitës në njësinë e Suharekës

Janë realizuar takime në mes CDI-së, KK Prizren dhe KRU "Hidroregjioni Jugor"Sh.a ku temë e takimit ka qenë investimet e qeverisë Zvicrrane, komunës së Prizrenit si dhe kompanisë KRU Hidroregjioni Jugor"Sh.a, këto investime janë parapa në shtimin e kapaciteteve të ujit si dhe në rrjetin e ujësjellësit për komunën e Prizrenit.

Poashtu është realizuar takim në mes CDI-së, KK Suharekë dhe KRU "Hidroregjioni Jugor"Sh.a, ku temë e takimit ka qenë investimet e qeverisë Zvicrrane, komunës së Suharekës si dhe kompanisë KRU "Hidroregjioni Jugor"Sh.a, këto investime janë parapa në shtimin e kapaciteteve të ujit si dhe në rrjetin e ujësjellësit për komunën e Suharekës.

Hartimi i projektit për hapjen e 5 puseve të lokacioni i 40 Burimëve ku dhe ka përfunduar hapja dhe janë vënë në funksion.

Gjatë këtij viti është punuar në vendosjen e ujëmatësve në fshatin Mushtisht komuna e Suharekës, ku gjatë punëve kanë marrë pjesë 4-5 grupe.

Punët kanë filluar me datë: 12.03.2013 dhe kanë përfunduar me datë 03.04.2013, ku gjithsej deri me datë 03.04.2013 janë bërë 297 kontrata (vendosje të ujëmatësve).

Janë bërë vizita në teren në fshatin Kobaj, arsyja mbikqyrja dhe monitorimi i projektit "Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit Kobaj".

Gjatë muajit Mars kanë përfunduar punët në fshatin Kobaj Komuna e Prizrenit dhe në muajit Prill do të bëhet pranimiti teknik për projektin "Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit Kobaj"

Formimi i 5 (pesë) grupeve të terrenit për identifikimin e konsumatorëve pa ujëmatës si dhe paisja e konsumatorëve me ujëmatës në qytetin e Prizrenit

Me datë 15.04.2013 takim në mes palëve: Kocks konsulent Gjerman (firm Gjermane), Hidroing dhe Hidroregjioni Jugor. Tema e takimit ka qenë Ndërtimi I Rrjetit Transportues të Lokacioni 40 Burimet – Prizren.

Në mes palëve ka pas takime përgjatë një jave: shkëmbim të ideve si dhe ofrim të dhanash për këtë lokacion.

Me datë 19.04.2013 është bërë pranimiti teknik i projektit "Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit Kobaj" - Prizren

Takim në mes të Assecos dhe KRU "Hidroregjioni Jugor"Sh.a me datë 02.05.2013 dhe me 27.05.2013. Tema e takimit të arriturat në projektin "Implementimi dhe aplikimi i plotë i programit softwerik shumë dimensional-Microsoft-Navision". Ky projekt është mbështetur nga donatori potencial USAID-KWISER.

Me datë 10.05.2013 janë formuar 5 grupe të terrenit për vendosjen e ujëmatësve në fshatin Kobaj, ku deri me datë 17.05.2013 janë paisur konsumatorët e fshatit Kobaj me ujëmatës.

Me datën 04-26.06.2012 kanë nisur bllobimet në Kabash te Has'it. Ujematesa të instaluar janë 25, ujëmatesa blombuara 50, konsumatorët me të cilave nuk kanë pasur qasje janë 7, konsumatorët pa ujëmates janë 1, konsumatorët të regjistruar por që nuk kanë pasur lidhje ujë 3.

Në këtë vit ka vazhduar montimi dhe kontrollimi i konsumatorëve pa ujëmates si dhe të konsumatorëve me faturim paushall në Prizren.

- Ujëmatesa të montuar 107 : 39 me pages , 68 pa pages

- Konsumator pa ujëmates të regjistruar 44.

\*Me GPS Leica CS09 janë bërë matjet në teren dhe është marrë kordinata të sakta të rezervuarit I pusnices, rezervuarit I KFOR'it dhe rezervuarit I komunes.

\*Në muajin Tetor është përfunduar projekti Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit në lagjen Arbana, Rrjeti primar, sekondar dhe kyqjet shtepiake.

\*Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Janar-Dhjetor 2013, ka bërë gjithsej 486 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 298 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 19,095 m.

Në muajin Nentor është raportu nga grupi i Bazhdarimit se 9 konsumator kanë sjelle ujëmatesat për servisim dhe riparim në kompani.

Në vitin 2013, grupi i terrenit demontim – montimit me njësi në Prizren kanë arritur që në komunën e Prizren-it gjithsej të demontojnë dhe montojnë 1889 ujëmatesa, ekziston raporti i veçant.

Gjatë muajve Janar-Dhjetor, 2013 është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatesave zonal ku, gjatë vitit në disa raste kemi hasur në moslexim të ujëmatesave për arsye se: ujëmatesat kanë qene në defekt si dhe pusetat kanë qene me uje.

Në muajin Janar-Mars në tre ujëmatesa zonal kemi hasur në defekt, një është riparuar dhe dy pritet të riparohen nga CMC-ja.

Në muajin Gusht ujëmatesi zonal në fshatin Atmaxhë nuk ka regjistruar (punuar, defekt), mirepo fshati është furnizuar nga një bajpas që është krijuar në të njëjten pusët ku edhe gjendet ujëmatesi zonal.

Në muajin Tetor dhe Nëntor ujëmatesi zonal të vendi i quajtur Ura e Gani Tades nuk ka punuar që nga muaji Mars, nuk është riparuar nga CMC-ja.

Në muajin Nentor është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatesave zonal, ku ujëmatesat tek vendet e quajtura: Te KFOR-i, Jusuf Gërvalla, ETC, Atmaxh, Nashec i Eperm, Landovic, Gorozhup, Ura e Gani Tades dhe Kobaj për shkak të leximit i kemi inspektuar dhe kemi pa se tre prej ujëmatesave zonal janë në defekt : Atmaxh, Nashec i Eperm dhe Landovic. Ujëmatesat tjerë janë në gjendje të rregullt raporton ekipa nga terreni.

Në muajin Dhjetor është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatesave zonal, ku ujëmatesat zonal në pikat matese: Atmaxhë, Landovicë janë pastruar dhe janë kthyer në funksion ndërsa ujëmatesi zonal në Nashec të Eperm është ndërruar me datë: 09.12.2013 për arsye se ka rezultuar defekt, pikat tjera janë kontrolluar dhe rezulton se të gjithë ujëmatesat janë në gjendje të rregullt për muajin Dhjetor. Ekziston raport i veçant i raportimit nga ekipa e bazhdarimit (servisim i ujëmatesave)

## 2.1.9 ANALIZAT FIZIKO-KIMIKE DHE BAKTERIOLOGJIKE

Janë marrë gjithsej 1197 mostra në nivel regjional për analiza Bakteriologjike dhe 1054 prej tyre i përgjigjen, e 36 mostra nuk i përgjigjen (3%) .

Janë marrë 520 mostra në nivel regjional për analiza Fiziko-Kimike nga to, 513 mostra u përgjigjen standardeve për ujë dhe pijes, kurse 7 mostra nuk u përgjigjen (1.3%)

Në Total: Nga 1117 mostra, 1,567 i përgjigjen standardeve ndërsa vetëm 43 apo 2.5% nuk u janë përgjigjur standardeve..



## 2.2.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI RAJONAL PËR KONSUMATORË

Në fund të vitit 2013 në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 38.838 fatura, prej tyre: 33.637 amvisëri , 4.625 biznese dhe 616 institucione. Në fund të këtij viti në krahasim me vitin paraprak kemi 2,559 fatura të lëshuara me tepër. Krahasuar me dhjetorin e vitit 2012 kemi një rritje të numrit të konsumatorëve prej 2,559 konsumatorëve. Kjo rritje është rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve për këto arsye:

1. Marrjes në menaxhim të fshatrave Luginë dhe Hasit dhe Kabash i Hasit në njësin e Prizrenit ndërsa në njësin e Suharekës fshati Mushtisht, Gjinoc dhe Deberdelan
2. Legalizimi i konsumatorëve ilegal, 1044 konsumatorë
3. Pëlqimeve për kyqje, 160 konsumatorë

Rritjen e numrit të konsumatorëve nëse e analizojm sipas kategorive të konsumatorëve atëherë kemi këtë rritje:

- a. Amviseri , 1429 konsumatorë
- b. Biznese , 142 konsumatorë
- c. Institucione , 28 konsumatorë

Gjatë vitit 2013 janë faturuar 7,748,680 m<sup>3</sup> ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: **6,270,541** m<sup>3</sup>, biznese: **555,844** m<sup>3</sup> dhe institucione **922,295** m<sup>3</sup> ujë. Nëse e krahasojm me vitin paraprak kemi një rritje në faturim më të madh prej 76, 437 m<sup>3</sup>. Rritje në sasinë e ujit të faturuar vjen si rezultat i rritjes së konsumit të tri kategorit e konsumatorëve gjithashtu edhe rritjes së numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit.

- Arsyetim:

- Rritja e faturimit për vitin 2013 është rezultat i rritjes së konsumit në këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake .
- Marrja në menaxhim e fshatrave të lartëcekur ka ndikuar në rritjen e faturimit të ujit në m<sup>3</sup>.
- Mungesa e furnizimit me ujë për tre muaj e fshatit Luginë si pasojë e turbullimit të ujit në burimin ekzistues. (muaji shtator, tetor dhe nëntor 2013). Ky fshat ka 259 konsumator dhe faturimi mujor i këtij fshati sillet diku rreth 4400 m<sup>3</sup>- 4500 (për tre muaj kemi mungesë në faturim 13.200m<sup>3</sup>deri 13.500m<sup>3</sup>). Këtu vlen të ceket edhe mosfaturimi i Mamushës ( rreth 520 konsumatorë) dhe Landovicës (rreth 140 konsumatorë, ku 90 prej tyre janë aktiv), të cilët nuk faturohen gjatë gjithë vitit 2013 ka ndikuar në mosrealizimin e caqeve të ujit e faturuar të planifikuar në plan biznes.

- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe shkyçjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a., në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive.

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA														
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN - JANAR - DHJETOR 2013														
No.	Të dhënat	JAN	SHKU	MARS	PRILL	MAJ	QERSH	KORR	GUSHT	SHTAT	TET	NENT	DHJET	JAN-DHJET
1	Shtëpiak	31,375	31783	31850	31931	32341	32705	32819	33164	33336	33464	33574	33637	33,637
4	Kome.-Indu.	4,363	4,385	4,394	4,410	4,443	4,481	4,517	4,530	4,542	4,584	4,612	4,625	4,625
7	Institucional	581	585	581	582	603	603	603	611	611	613	615	616	616
10	<b>TOTAL</b>	<b>36,319</b>	<b>36753</b>	<b>36825</b>	<b>36923</b>	<b>37387</b>	<b>37789</b>	<b>37939</b>	<b>38305</b>	<b>38,489</b>	<b>38661</b>	<b>38801</b>	<b>38878</b>	<b>38,878</b>
11	<b>Ndrysh.</b>		434	72	98	464	402	150	366	184	172	140	77	2,559
12	<b>Ndryshi.%</b>		1.2%	0.2%	0.3%	1.3%	1.1%	0.4%	1.0%	0.5%	0.4%	0.4%	0.2%	6.6%

## 2.2.2 RAPORTIMI EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES

Tabela:13

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kycjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
1	Prizren	1144	62	57	9696	179,421.84 €
2	Suharekë	969	174	129	3772	32,082.84 €
3	Malishevë	131	72	67	2052	18,510.92 €
4	Dragash	17	2	1	101	0.00 €
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	<b>2261</b>	<b>310</b>	<b>254</b>	<b>15621</b>	<b>230,015.60 €</b>

## 2.2.3 RAPORTI I ANKESAVE

Tabela:14

MUAJI	JAN	SHKU	MAR	PRILL	MAJ	QER	KORR	GUSH	SHTA	TET	NEN	DHJET	TOTAL
ANK. TEK.	153	82	102	93	147	127	150	113	144	150	103	99	<b>1463</b>
TË SHQ.	150	82	102	93	145	125	150	113	144	150	103	99	<b>1456</b>
ANK. KOM.	57	86	77	55	51	62	83	72	65	46	45	37	<b>736</b>
TË SHQ.	57	86	74	55	48	61	80	71	63	46	45	37	<b>723</b>
<b>TOTAL</b>	<b>210</b>	<b>168</b>	<b>179</b>	<b>148</b>	<b>198</b>	<b>189</b>	<b>233</b>	<b>185</b>	<b>209</b>	<b>196</b>	<b>148</b>	<b>136</b>	<b>2199</b>

- Koment:**

- Nga të dhënat tabelare shihet se ekipet e kontrollës në nivel rajonal kanë inkasu rreth 230.000 euro nga borxhet e konsumatorëve, borxhe të konsumatorëve mbi 400 euro. Kjo

është një shume e kënaqshme kur kemi parasysh që kjo vlerë përmban borxhe të papaguara të konsumatorëve mbi 2 vite.

- Edhe pse kemi pas një rezultat të kënaqshëm në inkasimin e mjeteve nga konsumatorët që kanë borxh mbi 400 euro, prap se prap nuk jemi të kënaqur me caqet e arritura në inkasim të borxheve të punëve tjera në shërbimin e kontrollës dhe shkyqjes. Aktivitetet e ekipeve të kontrollës gjatë vitit 2013 kanë qenë të orientuara në inkasimin e borxheve të vjetra, kontrollë dhe identifikim të lidhjeve ilegale si dhe shqyrtim të ankesave të konsumatorëve.
- Në nivel rajonal gjatë vitit 2013 kemi pranuar 2199 ankesa të konsumatorëve prej tyre:
  1. 1463 ankesa teknike- detektive, mungesë të ujit, rrjedhje të ujit, deblokim të kanalizimeve etj
  2. 1463 ankesa komerciale- ankesa rreth faturimit paushall të rritur, kontestim i faturave, faturim i dyfishtë, ndërrim të emrit dhe pronës etj

Të gjitha ankesat dhe kërkesat janë realizuar nga shërbimet dhe departamentet përkatëse në kohë dhe nivel të kënaqshëm.

#### Aktivitetet

- Janë shpërnda njoftime për shkyqje dhe njoftime parta padisë të konsumatorët që:
  - Nuk i janë përgjigjur pagesave në dy muajt e fundit sidomos konsumatorëve të amvisisë që jetojnë në ndërtesa kolektive dhe ju ka ofruar mundësinë e riprogramimit të borxheve duke ju ofruar kontratë.
  - Kanë borxhe mbi 400 euro dhe nuk i përgjigjen pagesës dhe riprogramimit të borgjit. Janë ndërru terenet e inkasantëve në mënyrë që të përfshihen numër më i madh i konsumatorëve.
  - Kontrollë të konsumatorët rreth eliminimit të keqperdorimeve të ujit
- Janë hap edhe dy porto arka, njëra në Prizren në rr. "Ukë Bytyqi" të kazerma të KFORIT dhe tjetra ndërtesën e Kuvendit Komunal të Malishevës. Me hapjen e këtyre porto arkave konsumatorëve ju ofrohet mundësia e pagesës së obligimeve të ujesjellsit sa më afër tyre.
- Pjesmarrje në takimet mujore në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku pjesmarrës në këto takime janë zyrtar nga ZRRUK dhe përfaqësues nga Kuvendet Komunale të zonës së operimit të KRU „Hidroregjioni Jugor“sh.a. Aty janë shqyrtuar ankesat që i janë drejtuar këtij këshilli si organ i dytë i ankesave.
- Vizita të herë pas herë në njësit operative me udhëheqësit e njësive lidhur me rritjen e efikasitetit rreth rritjes së faturimit, inkasimit dhe kontrollës të konsumatorët.

#### Pengesat në realizimin e objektivave:

- Rasti i sulmit me thikë në punëtorin e shërbimit të kontrollës gjatë kryerjes së punëve të përditshme në inkasim të borxheve të vjetra dhe shkyqje, ka ndikuar negativisht tek konsumatorët në pagesë të obligimeve të tyre dhe njëkohësisht ka zbeh për një kohë të shkurtër punën në shërbimin e kontrollës.



- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellsit :
  1. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike , e cila po rritet nga dita në ditë. Kjo mbështetet në faktin në paraqitjet në zyret e shërbimit me konsumatorë të rasteve të kësaj kategorie të konsumatorëve .
  2. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhëse e cila vjen nga rënia e punës në biznese, nga fuqia financiare e cila po bie çdo ditë.
  3. Te konsumatorët insticional –planifikimet e vogla në buxhet te organizatat buxhetore si dhe alokimet buxhetore në periudha tremujore po e pamundësojn pagesën rrjedhëse për cdo muaj te kjo kategori.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për ti paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mosfurnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktime) po ndikojn në inkasim të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit.

#### Planet në vazhdimësi për arritjen e objektivave:

- Takime me përfaqësuesit e lagjeve, fshatrave, ndërtesave kolektive për mundësinë e gjetjes së formave dhe mundësive për fillimin e nënshkrimit të kontratave për riprogramim të borxheve.
- Vazhdimi i aksioneve për shkyqje së bashku me operativen për shkyqjen e konsumatorve borgjlinj të mëdhenj mbi =400,00 euro, konsumatorët të cilët nuk i përgjigjen pagesës, ky aktivitet do të zhvillohet me eskavator i cili do të aktivizohet së paku një herë mbrenda javës.
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të borgjëve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borgjëve në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistem të pagesave të fakturave nëpërmes inkasantëve të terrenit, ekipëve të kontrollës në teren.
- Do të ju mundësohet konsumatorëve nënshkrimin e kontratës për riprogramim të borxhit edhe me pagesa më të vogla se 30% .
- Marrja e masave ligjore duke respektuar procedurat e ZRRUK për shkyqjen e konsumatorve për mos pagesë, këto raste do të procedohen të Shërbimi Juridik.
- Rritja e efikasitet të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyqjes, duke e rritur numrin e konsumatorëve që duhet të vizitohen mbrenda muajit.
- Inicimi i padisë te konsumatorve në gjykatë për mos pagesë të borxheve nëpërmes shërbimit juridik
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borgjeve aty ku kanë vështirësi inkasantet.
- Angazhim i ekipes së kontrollës nga Prizreni në njësit tjera , varësisht nga kërkesat e udhëheqësve të njësiteve.

## 2.2.4 RAPORTI I MEDIAVE

Një nga qëllimet kryesore të KRU-“Hidroregjioni Jugor”, (përveç furnizimit me ujë dhe inkasimit, mirëmbajtjes së rrjetit, etj.) është edhe që ta informojë opinionin publik, gjegjësisht konsumatorin për të gjitha ngjarjet që ndodhin në Kompani apo për problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet kompania, gjithashtu ta informojë konsumatorin me kohë shpejtë dhe saktë për pengesat, ndërprerjet në furnizim apo defekte të ndryshme.

Për t’u realizuar këto qëllime sa më mirë, funksionon zyra për informim dhe zëdhënësi.

Detyrat kryesore të këtyre dy mekanizmave janë që të mblidhen të gjitha informatat në kuadër të kompanisë, gjegjësisht shërbimet përkatëse dhe ato të përpunohen dhe të plasohen në opinionin publik, në mënyrën më të përshtatshme dhe të kuptueshme për opinionin.

Pra, të gjitha informatat që vijnë nga shërbimet e ndryshme e që janë me interes për konsumatorin, përpunohen dhe përcillen në të gjitha mjetet e informimit.

Në këtë drejtim kemi marrëveshje dhe bashkëpunim të mirë me të gjitha televizionet dhe radiot lokale, gjithashtu nuk mungojnë edhe kontaktet me televizionet qendrore, po ashtu edhe me shtypin ditor.

Zyra për marrëdhënie me publikun, është munduar që nga fillimi i vitit 2013, që përcjelljen e porosisë që del nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a., përmes medieve elektronike dhe të shkruara, ta bartë te opinionin publik, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më të ndershme, njëkohësisht duke mbrojtur interesat e kompanisë në përgjithësi dhe konsumatorit në veçanti.

Mediet lokale, i kanë kushtuar hapësirë të mjaftueshme KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. Kanë dhënë kontribut të madh në mënyrë indirekte dhe direkt në ngritjen e shkallës së arkëtimit, në vetëdijesimin e qytetarëve, se uji që shpenzohet duhet kursyer dhe duhet paguar, në informimin e qytetarëve se ujësjellësi i Prizrenit është duke punuar në atë drejtim që t’i përmirësojë shërbimet e veta ndaj çdo konsumatori, se kjo kompani me përkushtimin e saj më të madh, ka arritur që të përfitojë donacione të mëdha nga investitorët e huaj dhe Qeveria e Kosovës, vetëm e vetëm që konsumatorëve të saj t’u ofrojë shërbime sa më cilësore.

Edhe mediet e shkruara kanë dhënë kontribut të mjaftueshëm në shpërndarjen e informacioneve te opinionin publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. dhe se hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.



## RAPORT PËR MEDIA

MUAJI: JANAR – DHJETOR 2013

Tabela:15

Nr.	PËRSHKRIMI	MEDIAT	NUMRI TOTAL
1	<b><u>NJOFTIME</u></b> TV RADIO SHTYPI DITOR	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO HELIX RADIO THERANDA LAJM	32
2	<b><u>INTERVISTA</u></b> TV RADIO	RTK KLAN KOSOVA TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO KOSOVA RADIO AVAZO	17
3	<b><u>EMISIONE</u></b> TV RADIO	RTK KLAN KOSOVA TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO KOSOVA	7
4	<b><u>REPORTAZH - TV</u></b>	<a href="http://www.kosovapress.com">www.kosovapress.com</a>	1
5	<b><u>KONKURSET</u></b>	LAJM	29
6	<b><u>ARTIKUJT-SHTYPI DITOR</u></b>	KOHA DITORE KOSOVA SOT ZËRI LAJM EPOKA E RE GAZETA TRIBUNA	39
7	<b><u>ARTIKUJT- SHTYPI ELEKTRONIK</u></b>	<a href="http://www.tv-opinion.com">www.tv-opinion.com</a> <a href="http://www.kosovasot.info">www.kosovasot.info</a> <a href="http://www.prizrenpres.com">www.prizrenpres.com</a> <a href="http://www.rtklive.com">www.rtklive.com</a> <a href="http://www.kosovapress.com">www.kosovapress.com</a> <a href="http://www.telegrafi.com">www.telegrafi.com</a> <a href="http://www.gazetatribuna.com">www.gazetatribuna.com</a> <a href="http://www.koha.net">www.koha.net</a> <a href="http://www.epokaere.com">www.epokaere.com</a> <a href="http://www.kosovain.eu">www.kosovain.eu</a> <a href="http://www.gazetaexpress.com">www.gazetaexpress.com</a>	34
8	<b><u>KONFERENCË PËR MEDIA</u></b>	RTK KLAN KOSOVA TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI	3
9	<b><u>DEBAT PËR UJËRA TË ZEZA</u></b>	TV-BESA <a href="http://www.tv-opinino.com">www.tv-opinino.com</a>	1

## KONKLUZION

KRU-“Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren, gjatë vitit 2013, ka dërguar 30 njoftime, në mediat elektronike dhe të shkruara, lidhur me aktivitetet që po ndërmerr kjo kompani, filluar nga furnizimi me ujë të pijshëm, aplikimi i shkyçjeve, qoftë kolektive apo individuale, e deri te cilësia e ujit që konsumatorët e marrin në krojet e tyre.

Disa nga njoftimet janë emetuar në televizione, e disa janë publikuar si shkrime në shtypin ditor, duke dhënë çdo herë një mesazh për opinionin publik.

Mediat janë për t'u lavdëruar në shpërndarjen e informacioneve të opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-Hidroregjioni Jugor dhe hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

Mbulueshmëria mediale për KRU- “Hidroregjioni Jugor”, për vitin 2013 ka qenë e kënaqshme dhe e mjaftueshme.

Raporti Gazetar- Zëdhënës ka qenë i lakmueshëm.

Mediat elektronike dhe të shkruara kanë kontribuar edhe në ngritjen e shkallës së arkëtimit në KRU-Hidroregjioni Jugor, duke plasuar informacione të shumta në publik, lidhur me aktivitetin e shkyçjeve të konsumatorëve borxhlinjë.

Të gjithë artikujt e gazetave ditore dhe të gjitha intervistat, emisionet e drejtpërdrejta në televizione dhe radio, janë të ruajtura në arkivën e zyrës për marrëdhënie me publikun.

### 2.3.1 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Departamenti Administrativ është një nga Departamentet që ka lidhëshmëri të drjtëpërdrejt me Kryeshefin Ekzekutiv. Në kuadër të Departamentit Administrativ sipas strukture organizative të Kompanisë, bëjnë pjesë këto sektorë: sektori i administratës së përgjithshme dhe resursëve njerëzore, zyra ligjore, IT, zyrtari për sigurinë dhe shëndetin në punë, mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve.

Varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament, departamenti i administratës mirret me përgaditjen e raportëve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik.

- Gjatë këtij viti janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji, komiteti për staf dhe shpërblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Pas përgaditjes së Procesverbaleve të Bordit, Komisionit të Auditimit dhe të komiteteve janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me konkluzionet apo raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.
- Është njoftuar referenti për klorifikim dhe dezinfektim të ujit për raportin e kërkuar nga komiteti për hulumtime dhe teknologji lidhur me akreditimin e laboratorit të kompanisë.
- Janë njoftuar të gjithë udhëheqësit e njesive operative për kërkesën e komitetit për hulumtime dhe teknologji për studim të çdo fshati në menagjim, sa është prodhimi i ujit, faturimi, shpenzimet dhe furnizimi me ujë është me pompa apo me garvitet në menyrë që të dihet se ku është performanca pozitive apo negative dhe të lokalizohet problemi.
- Është njoftuar shefi i ekipes së detektimit që KHT ka kërkuar të përgaditet raport detaj sa I/s janë zbuluar si humje teknike të gjetura gjatë detektimit të rrjetit për periudhën janar-shtator 2013.
- Është njoftuar udhëheqësi i njesisë së Suharekës për kërkesën e Komisionit të Auditimit që të japin informatë për mos realizim të objektivave nga njesia.

- Është Njoftuar Menagjeri Rajonal për konsumator për arsyeshmerin shtesë të kërkuar nga Komisioni I Auditimit lidhur me realizimin e emisionit televiziv.
- Është Njoftuar Zyra e Prokurimit për kërkesën e Komisionit të Auditimit që zyra e Prokurimit për qdo shpallje tenderi dokumentet e kompletuara paraprakisht të paraqiten në Komisionin e Auditimit pastaj të bëhet shpallja.
- Janë përgaditur dhe vazhduar kontratat e punës së punonjësve që kanë qenë në kohë të caktuar prej 6 muajve dhe kontratat e punës për vitin 2014, për të gjithë punëtorët e Kompanisë Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës.
- Është vazhduar të punohet në regjistrimin e punëtorëve në librin amëz sipas dates së fillimit të punës në Kompani.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2013 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjetëve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servis të bazdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, portoarkën, kërkuesit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2013 gjërë më 15.01.2014 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpilojë raport mbi kryerjen e të njejtës dhe t'ia dorëzojë Kryeshefit Ekzekutiv gjërë më 20.01.2014.
- Janë përgaditur dhe shpallur në shtypinë ditorë 29 konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë, dy prej tyre janë anuluar për mos plotësim të kriterëve nga kandidatët aplikues për konkursin përkatës. Pas mbylljes së konkursit përkatës më vendim është caktuar komisioni i cili shqyrton aplikacionet e aplikantëve, përgadit listen e ngushtë të kandidatëve, kryen testin me shkrim dhe intervisten si dhe bënë zgjedhjen e kandidatit.
- Është bërë ndryshimi i koficientit të disa punonjësve pas kërkesës me shkrim nga udhëheqësit e tyre dhe aprovimit nga Zyrtari Kryesor financiar dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Në Department të Administratës kemi patur auditim nga Auditori i Jashtëm "Kanuni i Auditorit" për vitin 2012 .
- Është përgaditur Libri lidhës për Qeverisjen Korporative për vitin 2012 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë :qertifikatën e regjistrimit të Biznesit, Vendimin mbi emrimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për 2012, vendimet e Bordit për 2012, procesverbalet e Komisionit të Auditimit, Vendimet mbi themelimin e komitetëve tjera të Bordit , procesverbalet e komiteteve, plan-biznesi 2013-2015 dhe raporti vjetor 2012.
- Përgaditja e të dhënave të Kompanisë për ëeb-faqe dhe dërgimi i tyre në NJPMNP. Dokumentet e kërkuara janë: Raporti Final i Auditorit të Pavarur të Pasqyrave Financiare 2012; Kontratat e Prokurimit me vlera të mëdha siq e parashikon Ligji i Prokurimit për vitin 2012, Lista për dhjetë furnizuesit më të mëdhenjë për nga vlera në 2012, Rregulloret e miratuara nga BtD gjatë vitit 2012, Deklarata se nuk ka konflikte të interesit të deklaruara gjatë 2012 është kërkuar konfirmimi i Kryesuesit të BtD me anë të një shkrese se nuk ka patur konflikte të interesit gjatë 2012, Zotimet e Drejtorëve të BtD dhe Zyrtarëve tjerë të NP për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative.
- Janë dërguar në NJPMNP Kompenzimet mujore dhe shtesat e tjera të anëtarëve të Bordit dhe kompenzimet mujore të zyrtarëve të lartë në KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren për vitin 2012.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të burimeve njerzore, Menaxhimit të Projektëve, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.

- Pjesmarrja në trajnimin e ftuar nga NJPMNP-MZHE me temë:NP komunikimi me Aksionarin dhe Publikun e përgjithshëm.Të gjithë Pjesmarrësit janë paisur me Qertifikatë .
- Pjesmarrja në grupin punuesë në SHUKOS për hartimin e “Marrëveshjes së Bashkëpunimit” për mbështetjen e Gjyqësorit ndaj Kompanive Rajonale të Ujësllësit. Interesat e palëve nënshkruese të këtij Memorandum Bashkëpunimi janë:  
SHUKOS-i , në arkëtimin më të mirë të borxheve të cilat do të ndikonin në rritjen e investimeve në ofrimin më të mirë të shërbimeve të ujësllësit dhe kanalizimit dhe  
Këshilli Gjyqësor i Kosovës në rritjen e besimit dhe në ngritjen e efikasitetit të Gjykatave.
- Janë përgaditur fletëpalosjet e fushatës vetdisuese për masat ligjore të kodit penal, për keqpërdorimet e shërbimeve të ujësllësve dhe janë shpërndarë konsumatorëve përmes inkasantëve.
- Është përgaditur Marrëveshja e bashkëfinancimit ndërmjet palëve KRU”Hidroregjioni Jugor”dhe “Komuna e Suharekës” për projektin:Ndertimi I rezervarit me infrastrukturen përcjellëse në Sallagrazhde.
- Është plotësuar formulari i kërkuar nga NJPMNP-MZHE me të dhënat e kërkuara operative dhe financiare për vitin 2011-2012 si dhe kompenzimet e Bordit sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Është përgaditur materiali sipas rendit të ditës për Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin që është mbajtur me 05.06.2013.
- Për Zyren e Auditorit të Përgjithshëm janë plotësuar dokumentet e kerkuara lidhur me sistemin e menagjimit të pagesave për çdo anëtar të Bordit për periudhen kohore 2009-2012.
- Në mbështetje të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Nenit 67 ,paragrafi 1.6, me Vendim i është nderprerë marrëdhënja e punës Asistentit administrativë të zyrës së teknologjisë informatike në njesinë e Prizrenit. Vendimi i marrë, është bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren me të cilin punëtori në fjalë(B. S) është shpallur fajtor me aplikimin e neneve 3,6,34,35,36,38,39,64,73 si dhe nenit 229 par 2 dhe 1 të KP të Kosovës dhe denuar me denim burgimi në kohëzgjatje prej 2(dy)vitesh.
- Pjesmarrja në Seminar pune organizuar nga SHUKOS me temë:Organizimi i Ndermarrjeve të ujit dhe kanalizimit dhe Zhvillimi I Resurseve Njerzore. Në këtë Seminar pune kanë qenë Pjesëmarrës nga secila KRU /Sekretarët dhe Zyrtarët për burime njerzore. Implementimi programit është ndarë në dy pjesë: PJESA I: Vlerësimi i Organizimit dhe ZhRNj për Ujësllësit Publik dhe Pjesa II: Përgatitja e Modelit për Organizimin & ZhRNj të ndërmarrjeve të ujit dhe kanalizimit. Departmenti I Administrates ka pergaditur dhe paraqitur gjatë seminarit prezantim për Strukturën e Organizimit; kushtet ekzistuese , problemet e Organizimit dhe Menaxhimin e ZhRNj ne KRU”Hidroregjioni Jugor”sh.a Prizren.
- Vizitë nga Inspektoriati I Punes lidhur me rastin e vdekjs se dy punëtorëve të Kompanisë.
- Vizitë pune nga ish oficerët e lartën të KFOR-it Gjerman te bunari 1 dhe 2 dhe te zyret e vjetra të Kompanisë.
- Për shkelje të lehtë të detyrave të punes janë shqiptuar 9 (nëntë) Vërejtje me shkrim për disa punonjës(inkasant) të Kompanisë në njësinë e Prizrenit,Suharekës dhe Malishevës.
- Për shkelje të lehtë të detyrave të punes është shqiptuar 1 (një) Vërejtje me shkrim për punonjësen e njësisë së Suharekës.
- Është bërë largim i përkohshëm nga puna te një punëtori të njësisë së Dragashit për shkak se ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të vepres penale dhe se i punësuar i në fjalë është në vuajtje të paraburgimit në kohëzgjatje prej 1(një)muaji.
- Është pergaditur Vendim me të cilin percaktohet komisioni që do të bëjë verifikimin e punës së kartelave të konsumatorët,kontrollimin e punës së shërbimit të financave,kontrollimin dhe verifikimin e punës së ekipeve të kontrollës dhe kontrollon vertetësinë e shërbimit të konsumatorëve nga rrjeti i ujësllësit apo puset individuale.Ky komision do të bëjë monitorimin e punës në njësinë e Suharekës,Malishevës dhe Dragashit.
- Është përgaditur vendimi me të cilin percaktohet komisioni që do të bëjë verifikimin e të gjitha hyrjeve , daljeve dhe gjendjen e stoqeve në deponë e njësisë së Suharekës.

- Janë përgaditur Vendimeve për mbikqyrje të punimeve dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njesive punuese.
- Me Vendim janë caktuar komisionet nga të gjitha shërbimet e Kompanisë lidhur me planifikimin dhe përgaditjen e plan-biznesit 2014-2016.
- Është përgaditur dhe dërguar modeli i përpilimit të raportit dhe planit javor të punës për të gjitha shërbimet e Kompanisë.
- Përgaditja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit përkatës.
- Përgaditja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompenzimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Përgaditja e kërkesës drejtuar Distriktit të KEDS-it në Prizren që të bëjë furnizim të rregullt me energji elektrike në të gjitha pikat e furnizimit ku qytetarët furnizohen me ujë të pijes përmes sistemit të pompave.
- Nga Shërbimi Sprovues në Prizren kemi pranuar rehabilitimin e një të mituri me punë në mirëmbajtje të objektit të Kompanisë.(I mituri është Kastriot Gashi).
- Me aprovim të Kryeshefit Ekzekutiv është mbështetur Doku-festi në Prizren, të cilëve ju është lejuar për të pasur qasje në rrymen elektrike të Kompanisë.
- Në NJPMNP pas kërkesës së tyre janë dërguar të dhënat financiare dhe pozita e punës për ish punëtorin e Kompanisë Sabit Bytyqi-i caktuar në 2009 anëtar Bordi nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- Është njoftuar NJPMNP për kohën e mungesës në punë të KE(pushim vjetor)dhe për zyrtarin që do ta zvendesoje(Zv.KE-16.07-27.07.2013).
- Përgjigjeje NJPMNP që nuk kemi pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike nga asnjë profil i aplikuesve dhe se ne të ardhmen nese paraqiten kërkesa të tilla do të trajtohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
- Janë dërguar në NJPMNP procesverbalet e Bordit të drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit në kopje fizike të nënshkruara.Procesverbalet e dërguara sipas kërkesës së analistit të Njesisë janë nga mbledhjet e mbajtura prej janarit deri në gushtë 2013.
- Gjatë zgjedhjeve lokale të 2013 kemi vepruar sipas Opinionin e Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit përkitazi me pjesëmarrjen e nënpunësve publik në zgjedhjet lokale 2013.
- Në bazë të nenit 2.paragrafi 1. të Ligjit Nr. 2003/19 për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës dhe të nenit 5.paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë është bërë pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në punë për disa punëtor.
- Nga Kryeshefi Ekzekutiv është formuar Komisioni i veçantë për analizimin e formimit të Shërbimit të Inspektoratit në nivel Regjional.Puna e Komisionit është paraqitur në Komitet për Staf dhe shpërblime të që ka mbetur të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komitetit për staf.
- Është përgaditur urdhëresë për ndërmarrjen e hapave për preventivë dhe siguri të objekteve të njesive operuese dhe i është drejtuar udhëheqësve të njesive punuese pranë KRU"Hydroregjioni Jugor"Prizren.
- Nga MMPH kemi pranuar VENDIME ku aprovohet kërkesa e KRU"Hydroregjionit Jugor"e datës 30.08.2012 dhe vazhdohet afati i lejes ujore për shfrytëzimin e ujit nga burimi në Prizren,Lumi Radesga-Dragash,rezervuari Shirok në Suharekë dhe shpimi në Banjë në Malishevë.Vazhdimi i lejes ujore është në afat prej 5 viteve nga data e aprovimit të Vendimit.Leja ujore vazhdohet nën kushtet vijuese me të cilat kushte është njoftuar Kryeshefi Ekzekutiv dhe menaxhmenti në takimin e datës 18.11.2013.
- Në Departament të Administratës është bërë auditim nga Auditori I Brendshëm,temë e auditimit ishte Menaxhimi i procesit të vlerësimit të punëtorëve në Hydroregjionin Jugor për vitin 2013.rekomandimet e dhëna në draft raportin e Auditorit janë pranuar dhe kanë filluar menjëherë të implementohen.
- Dokumentet e kërkuara nga Zyra e Auditorit të përgjithshëm janë skenuar dhe dërguar me kohë.
- Pjesëmarrje në Konferencën dhe ekspozitën e përbashkët Vjetore të organizuara nga SHUKOS dhe SHUKALB me temë "Viti i Bashkëpunimit për ujë"

Tabela:16

## 2.3.2 PERSONELI – JANAR – DHJETOR 2013

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
Janar	274	1	1	0	
Shkurt	282	8	2	0	1 punt.pushim pa pagesë
Mars	284	2	3	1	
Prill	282	0	2	0	17.04.vdes punt.XH.B
Maj	286		0	0	5 punt.pushim pa pages
Qershor	289	3	0	0	06.06.vdes punt.A.O 19.06.vdes punt.I.S
Korrik	287	0	0	0	1 punt.pushim lehonisë
Gusht	289	2	2	0	30.08.janë larduar 2 punt.
Shtator	291	4	0	0	1 punt.pushim pa pages
Tetorë	291	2	2	0	3 punt.pushim pa pages
Nentorë	291	0	0	0	1 puntetore push. te lehonisë 2 punt.pushim pa pages
Dhjetor	291	1	1	0	

Tabela:17

## 2.3.4 NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	237	36	6	12	291
Numri i Punëtorëve në %	81.4	12.4	2.1	4.1	<b>100</b>

Tabela:18

## NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	32	11.00	
MESHKUJ:	259	89.00	
TOTAL	291		

Tabela:19

## 2.3.4 KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A						
KUALIFIKIMI						
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	<b>27</b>	<b>17</b>	<b>187</b>	<b>55</b>	<b>5</b>	<b>291</b>
Kualifikimi në %	<b>9.28</b>	<b>5.84</b>	<b>65.29</b>	<b>17.87</b>	<b>1.72</b>	



**Rritja e nr. të personelit:** Është bërë duke u bazuar në kërkesën e shërbimeve përkatëse që parashihet për të pasur një menaxhim dhe një mbikqyrje të punimëve në nivel profesional Kompania ka nevojë për kuadro prefosionale. Vendet e reja të punës të parapara në organogram, ndryshimet në staf, propozimet e reja për rritje të kontrollës në tren, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, rritja e numrit të konsumatorëve më shumë që është paraparë, si dhe duke u bazuar në rritjen e aktiviteteve dhe efikasitetin të punës në Kompani është shtuar numri i punëtorëve me shumë se është parapar në Plan-Biznes 2012.

Tabela:20

### 2.3.5 PROCEDIMI I LËNDËVE NË GJYKATA

Periudha raportuese	Padi	Përgjigje në padi	Propozim për ekzekutim	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	Kallëzime penale	Parashtresa në Prokurori	ANKESA në Gjykatën e Apelit	Përgjigje në Ankesa	REVIZION	Përgjigje në Revizion	TOTALI	Lëndë të ardhura nga Gjykata
JANAR	/	/	1	/	/	3	/	/	/	/	1	1	6	8
SHKURT	/	1 Padi	/	1	4	2	/	/	/	/	/	/	8	7
MARS	/	2-1 Padi e tërh eq	/	1	10	2	/	/	/	/	/	/	16	15
PRILL	/	/	3	/	5	1	/	/	/	3	/	/	12	23
MAJ	/	/	/	2	2	2	1	/	/	2	/	/	9	14
QERSHOR	/	/	1	/	5	3	/	/	/	/	/	/	9	9
KORRIK	/	/	6	3	4	3	/	/	1	2	/	/	19	20
GUSHT	/	/	2	/	/	/	/	/	2	1	1	1	7	10
SHTATOR	/	/	1	2	/	2	/	1	1	1	/	/	8	8
TETOR	1	/	/	3	1	2	/	/	1	2	1Vendim	/	11	15
NËNTOR	/	1	/	/	3	4	/	1	1	1	/	/	11	13
DHJETOR	/	/	/	/	3	2	/	/	3	/	/	/	8	6
TOTALI	1	5	14	12	37	26	1	2	8	12	3	2	123	148

### PËRGJIGJE NË PADI APO REVIZION

Me datë 10.01.2013, është dhënë PËRGJIGJE NË REVIZION lidhur me Lëndën C.nr. 92/11, të Gjykatës Komunale dhe Ac.nr. 435/2011, të datës 03.12.2012.

Me datë 15.02.2013, Suzana e ka dërguar PËRGJIGJE NË PADI në Gjykatën Themelore në Prizren kundër Padisë C.nr. 687/11të ngritur nga një konsumator.

Me datë 22.03.2013, e kemi dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren PËRGJIGJE NË PADI për Lëndën C.nr. 835/08, datë 07.03.2013.

Me datë 08.11.2013, është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren PËRGJIGJE NË PADI, C.nr. 611/13, datë 23.10.2013, kundër Paditësit “Malik Impex”, NSHT me seli në Rr. Ortakoll, nr. 33, në Prizren, lidhur me Kërkesën e Paditësit për RIMBURSIM TË DËMIT në vlerë prej 3013 €.

### PADI TË USHTRUARA KUNDËR KOMPANISË

Me datë 25.10.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren PADI, C.nr. 611/13, datë 23.10.2013, ku Paditësi “Malik Impex”, NSHT me seli në Rr. Ortakoll, nr. 33 në Prizren, me Kërkesë për RIMBURSIM TË DËMIT në vlerë prej 3013 €.

### ANKESA NË GJYKATËN E APELIT NGA KRU

Me datë 15.11.2013, Në Gjykatën Themelore në Prizren është parashtruar ANKESË për në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër AKTGJYKIMIT lidhur me lëndën C.nr. 189/06, datë 18.10.2013, me të cilin refuzohet si e pabazuar Kërkesëpadia e Paditësit K.R.U.”Hidroregjioni Jugor”Sh.A. në Prizren, ndaj Debitorit Imer Bislimaj, për pagesë të borxhit ndaj Kompanisë.

### ANKESA NË GJYKATËN E APELIT KUNDËR KRU-së

- Me datë 15.07.2013 është sjellë nga Gjykata Themelore e Prizrenit ANKESA nga I Padituri BAJRAM BALLABANI, ku i njëjti *ka parashtruar Ankesë në Gj. e APELIT në Prishtinë* kundër AKTGJYKIMIT C.nr. 342/05, të datës 25.03.2013 me të cilin AKTGJYKIM Gj. Themelore në Prizren ka marrë vendim që pjesërisht (268.31 €) - Debitori ta kryej detyrimin ndaj Kompanisë sonë.
- Me datë 01.08.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren ANKESË lidhur me lëndën C.nr. 873/11, datë 07.05.2012, nga Debitori SHAIPI RAMADANI, i cili e konteston AKTGJYKIMIN C.nr. 873/11, datë, 07.05.2012, sipas të cilit Gj. Themelore (ish Komunale) ka marrë Vendim që Debitori ta paguaj shumën prej 284.40 €.
- Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren ANKESË lidhur me lëndën C.nr. 687/11, datë 21.08.2012, nga Debitori SHASIVAR GASHI, i cili e konteston AKTGJYKIMIN e marrë ku Gjykata Themelore konsideron se PADIA E PADITËSIT është tërhequr, andaj i njëjti kërkon nga Gjykata e Apelit në Prishtinë që lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.
- Me datë 26.09.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren ANKESË lidhur me lëndën C.nr. 603/09, datë 29.07.2013, nga Paditësi ILIAZ BULECI, i cili e konteston AKTGJYKIMIN e marrë nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me Kërkesëpadinë e tij për kompensimin e të ardhurave personale.
- Me datë 10.10.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren ANKESË lidhur me lëndën C.nr. 745/05, nga Paditësi VAHID KABASHI, i cili e konteston AKTGJYKIMIN e marrë nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me Kërkesëpadinë e tij për kompensimin e kinse dëmeve të shkaktuara nga gypat e ujësjellësit të Kompanisë sonë.
- Me datë 08.11.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren ANKESË lidhur me lëndën C.nr. 1515/13, nga Ankimuesi NJAZI ADEMAJ, i cili i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nga që e konteston AKTVENDIMIN e marrë nga Gjykata Themelore në Prizren pasi që sipas Paditësit, me PROPOZIMIN PLOTËSUES është kërkuar që Gjykata ta kthej në punë dhe detyra të punës

DREJTOR, ashtu siç ka qenë para largimit nga puna si dhe kundërshtohet se kjo çështje është çështje e gjykuar (RES JUDICATA).

### REVIZION

Me date 26.08.2013, nga Gjykata Themelore ka ardhur REVIZION nga ish punonjësi AHMET RAMA i cili i është drejtuar GJYKATËS SUPREME lidhur me AKTGJYKIMIN AC.nr. 1355/2013, datë 01.07.2013, lidhur me AKTGJYKIMIN e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr. 774/11, datë 19.02.2013, respektivisht pika V e diapozitivit.

### PËRGJIGJE NË REVIZION

Me 29.08.2013 kemi dërguar në Gjykatën Themelore PËRGJIGJE NË REVIZION për lëndën e AMET RAMA, ku LECl përmes telefonit më ka lajmëruar se nuk ka nevojë sipas zyrtarëve të Gjykatës që të paguhet taksa Gjyqësore.

### PËRGJIGJE NË ANKESA

Më datë 23.04.2013, e kemi dërguar në Gj. Themelore për Gjykatën e Apelit në Prishtinë një PËRGJIGJE NË ANKESË lidhur me Ankesën e bërë nga Debitori BESIM MUQAJ, Rr. Prevezës, nr. 38, Prizren, kundër AKTGJYKIMIT C.nr. 842/06, datë 20.02.2013, me të cilën është aprovuar Kërkesëpadia e Kompanisë sonë lidhur me pagesën e borxhit ndaj nesh nga Debitori.

Më 25.04.2013, e kemi dërguar në Gj. Themelore për Gjykatën e Apelit në Prishtinë një PËRGJIGJE NË ANKESË lidhur me Ankesën e bërë nga ish punëtori AHMET RAMA, Rr. Mbreti Agron, nr. 31, Prizren, Lëndën C.nr. 774/11, të protokolluar me Nr.pr. 394, datë 25.04.2013, lidhur me KONTEST NGA MERRËDHËNIA E PUNËS.

Më 30.04.2013, e kemi dërguar në Gj. Themelore për Gjykatën e Apelit në Prishtinë një PËRGJIGJE NË ANKESË lidhur me Ankesën e bërë nga ish punëtori REMZI HOXHA, nga Prizreni, Lëndën C.nr. 1214/12, të protokolluar me Nr.pr. 415, datë 30.04.2013, lidhur me KONTEST NGA MERRËDHËNIA E PUNËS.

Me datë 15.05.2013, kemi dhënë PËRGJIGJE NË ANKESË, drejtuar Gjykatës së Apelit, kundër Ankesës së z. Feta Osmanolli.

Me datë 16.05.2013, kemi dhënë PËRGJIGJE NË ANKESË, drejtuar Gjykatës së Apelit, kundër Ankesës së z. Imer Vorfaj.

Me datë 01.07.2013, është dërguar përmes Postës (PTK-së) PËRGJIGJE NË ANKESË në Gjykatën Themelore të Prizrenit kundër ankesës së parashtruar nga Konsumatori MUSTAFA KAZAZ kundër AKTGJYKIMIT C.nr. 828/11, të datës 13.02.2013, i cili ka kërkuar fshirjen e borxhit si dhe vendosjen e masave të sigurisë.

Me datë 19.07.2013, është dhënë PËRGJIGJE NË ANKESË në Gjykatën Themelore të Prizrenit për GJYKATËN E APELIT NË Prishtinë, kundër ankesës së parashtruar nga Konsumatori BAJRAM BALLABANI kundër AKTGJYKIMIT C.nr. 342/05, të datës 25.03.2013, lidhur me pagesën e borxhit ndaj Kompanisë sonë në lartësi prej 268.31 €.

Me datë 09.08.2013, e kemi përgatitur dhe kemi dhënë PËRGJIGJE NË ANKESË NDAJ KONSUMATORIT SHAIPI RAMADANI, i cili e ka kundërshtuar AKTGJYKIMIN C.nr. 873/11, datë 07.05.2012 i cili e detyron debitorin për pagesën e borxhit ndaj Kompanisë sonë në lartësinë prej 251.68 €

Me datë 03.09.2013, është bërë PËRGJIGJE NË ANKESË ndaj Paditësit SHASIVAR GASHI, lidhur me AKTGJYKIMIN C.nr. 687/11, të datës 21.08.2012 i cili e konteston AKTGJYKIMIN e marrë ku Gjykata Themelore konsideron se PADIA E PADITËSIT është tërhequr, andaj i njëjti kërkon nga Gjykata e Apelit në Prishtinë që lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje

### KËRKESË E GJYKATËS THEMELORE

Më date 29.03.2013, ka ardhur nga Gj. Themelore AKTVENDIM lidhur me ekspertizën e kërkuar nga Gj. Themelore për lëndën C.nr. 603/09.

Nga Gjykata Themelore AKTVENDIM lidhur me URDHËRESËN E GJYKATËS THEMELORE ndaj Pro Credit Bankës për bllokimin e xhirollogarisë së Kompanisë lidhur me PËRMBARIMIN ndaj z. Njazi Ademaj.

#### VENDIMET NË FAVOR TË KOMPANISË NGA ANA E GJYKATËS THEMELORE NË PRIZREN

Më datë 12.03.2013, ka ardhur AKTGJYKIM, C. nr.842/06, datë 20.02.2013, me të cilin aprovohet kërkesëpapia e Kompanisë lidhur me pagesën e borxhit në lartësinë prej 1.202.00 Euro.

Më datë 14.03.2013, ka ardhur AKTGJYKIM, C.nr. 793/10, datë 25.02.2013, me të cilin pjesërishtë aprovohet kërkesëpapia e Kompanisë lidhur me pagesën e borxhit në lartësinë prej 388.30 Euro me kamatë ligjore dhe shpenzimet procedural.

Me datë 10.04.2013, nga Gjykata Themelore në Prizren ka ardhur AKT-GJYKIM ku Papia e paditësit AHMET RAMA me C.nr. 774/11, është aprovuar pjesëri-shtë, pra kërkohet vetëm pagesa e dyfishit të kohës së paraparë sipas Kontratës së punës.

Me datë 10.04.2013 është sjellë nga Gjykata Themelore AKTGJYKIM me të cilin Konstatohet se është ZGJIDHUR NË FAVOR TË KOMPANISË Papia e Kompanisë sonë (C.nr.441/03) kundër të paditurit - Debitorit për Borxh në lartësi 449.76 Euro REGJEP SHAPELI nga Prizreni.

Me datë 17.04.2013 është sjellë nga Gjykata Themelore AKTGJYKIM me të cilin APROVOHET kërkesëpapia e Kompanisë sonë lidhur me PADINË mbi BORXHIN (278,24 €), e Debitorit Imer Vorfaj, nga F. Kobanjë, lidhur me Lëndën C.nr. 223/06, kështu që urdhërohet i Padituri që BORXHIN ta paguaj nga dita e pranimit të Aktgjykimit e në afat prej 15 ditësh.

Me datë 17.04.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore AKTGJYKIM C.nr. 1214/12, me të cilin REFUZOHET PADIA E PADITËSIT REMZI HOXHA – KONTEST PUNE - SI E PABAZUAR, pra Gjykata Themelore e Prizrenit ka vendosur në favor të Kompanisë.

Më 19.04.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore AKTGJYKIM me të cilin APROVOHET kërkesëpapia e Kompanisë sonë lidhur me PADINË mbi BORXHIN (270,31 €), e Debitorit HIRA (SAIT SKENDERI), Rr. Ë. Volker, pn. Prizren, lidhur me Lëndën C.nr. 850/12, kështu që urdhërohet i Padituri që BORXHIN ta paguaj 7 ditë pas plotfuqishmërisë së vendimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Me datë 24-5.04.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore URDHËR PAGESË C.nr. 421/06, datë: 24.04.2013, me të cilin Gjykata Themelore në Prizren E URDHËRONË Debitorin Muharrem Kastrati, Rr. Erhan Mazreku, nr.71, në Prizren, që në emër të borxhit në lartësi prej 398.53 Euro si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore ti paguaj në arkën e Paditësit në afat prej ditësh nga dita e marrjes së kësaj Urdhërpaguese.

Me datë 02.05.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore AKTGJYKIM me të cilin APROVOHET kërkesëpapia e Kompanisë sonë lidhur me PADINË mbi BORXHIN (757.90 €), e Debitorit SADETE CURRI, nga Prizreni, lidhur me Lëndën C.nr. 408/06, kështu që urdhërohet e Paditura që BORXHIN ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Me datë 02.05.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore AKTVENDIM në lëndën C.nr. 603/09, Iljaz Buleci dhe të tjerët, me të cilin APROVOHET kërkesa e të Paditurës së dytë K.R.U."Hidroregjioni Jugorë"Sh.A.me seli në Prizren, për përjashtimin e ekspertit financiar Z. HAMDI Kastrati në kryerjen e ekspertizës financiare.

Me datë 10.05.2013, në ora 09.20 nga Gjykata Themelore në Prizren është sjellur AKTGJYKIMIN C.nr. 84/12, datë 25.03.2013, Pjesërishtë APROVOHET kërkesëpapia e Kompanisë sonë lidhur me PADINË mbi BORXHIN (490.66 € - lejohet ekzekutimi i borxhit në lartësi prej 119.13 €, si dhe shpenzimet e taksës gjyqësore në lartësi prej 10 € ), e Debitorit DASHNOR GËRMIZI.

Me datë 27.05.2013, nga Gj. Themelore ka ardhur AKTGJYKIMIN C.nr. 842/2006, datë 22.05.2013, me të cilin nga Gjykata Themelore në Prizren është hedhur poshtë ANKESA e Debitorit BESIM MUQAJ si e PA AFATSHME për BORXHIN (1.202.00 € - ku detyrohet Debitori që borxhin ta paguaj sipas Aktgjykimit të shkallës së parë, pra në lartësinë e 1.202.00 E

Me datë 05.06.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore e Prizrenit AKTGJYKIM lidhur me lëndën C.nr. 828/11, datë 13.02.2012, me të cilin paditësit MUSTAFA KAZAZI i është REFUZUAR KËRKESËPADIA lidhur me LIRIMIN NGA PAGESA E UJIT TË SHPENZUAR si dhe Kërkesës për MARRJEN E MASËS SË SIGURISË.

Me datë 24.06.2013, nga Gj. Themelore në Prizren – DEGA MALISHEVË ka ardhur AKTGJYKIMIN C.nr. 125/08, datë 19.04.2013, me të cilin nga Gjykata Themelore në Prizren - DEGA MALISHEVË, është hedhur poshtë ANKESA e Debitorit IMER KRASNIQI nga MALISHEVA si dhe detyrohet i njëjti që Kompanisë "Hidroregjioni Jugorë" t'ia paguaj borxhin në shumën prej 335.92 €, si dhe 13.00 € shpenzimet procedurale.

AKTGJYKIMI C.nr. 257/11, datë 03.06.2013, me të cilin nga Gjykata Themelore në Prizren E KA SHPALLUR FAJTORË DHE E KA DËNUAR ME KUSHT në afat prej 6 muajve z. IZET ISLAMI, F. Shkozë, pasi që i njëjti e ka dëmtuar rrjetin e ujësjellësit të Kompanisë sonë.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 767/05, datë 06.06.2013, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkesa për pagesën e Borxhit nga Debitori FLORIM GËRMIZAJ, Rr. Edit Durham, Lamela II, nr.25, në Prizren, në lartësinë e 174.89 €, (shuma e kërkuar 335.33 €), si dhe shpenzimet procedurale, 15 ditë nga plotëfuqishmëria e Aktgjykimit.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 354/05, datë 28.06.2013, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkesa për pagesën e Borxhit nga debitori SEFER BEKTESHI, Rr. Xheladin Hana, nr. 99, në Prizren, në lartësinë e 351.53 €, (shuma e kërkuar 451.53 €. I Padituri i ka paguar me datë 20.12.2004, në N.P. "Cvileni 100 €, andaj sipas Gjykatës Debitori i ka edhe 351.53 € pa paguar ), si dhe shpenzimet procedurale (- 40 € -, pra në TOTAL Kompanisë duhet paguar 491.53 €) , 15 ditë nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 873/11, datë 07.05.2012, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkesa për pagesën e Borxhit nga Paditësi dhe Debitori SHAIPI RAMADANI, Lagja Ortakoll,, Lamela III/II, nr. 24, në Prizren, në lartësinë e 251.68 €, kurëse pjesa e borxhit prej 49.83 €, nuk është aprovuar për pagesë nga ana e Gjykatës Themelore.

A KTVENDIMI lidhur me lëndën C.nr. 603/13, datë 17.07.2013, me të cilin konstatohet se padia e paditësit HAMZA HALABAK, nga Prizreni, ËSHTË TËRHEQUR.Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ANKESË.

AKTVENDIMI lidhur me lëndën C.nr. 687/11, datë 30.07.2013, ku pasi që Paditësi nuk i ka paguar taksat gjyqësore Gjykata Themelore në Prizren me AKTVENDIM ka vendosur se Padia e Paditësit SHASIVAR GASHI, Rr. Selajdin Berisha, nr. 36/b nga Prizreni, konsiderohet se është tërhequr.

PROCESVERBALI nga seanca kryesore lidhur me lëndën C.nr. 633/10, ku kemi arritur MARRËVESHJE GJYQËSORE me Debitorin RUFAT SMAILI rreth pagesës me rata të borxhit që e ka ndaj Kompanisë sonë.

AKTVENDIMI lidhur me lëndën C.nr. 745/05, datë 01.07.2013, ku pasi që Paditësi nuk ka marrë pjesë në seancë gjyqësore edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, Gjykata Themelore në Prizren me AKTVENDIM ka vendosur që Padia e Paditësit VAHID KABASHI, Rr. Selajdin Braha, nr. 36/b, nga Prizreni, për kompensim të dëmit tani në lartësi prej 33.083.00 €, konsiderohet se është tërhequr.

Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 335/2006, datë 27.05.2013, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkespadia e Kompanisë lidhur me borxhin e kërkuar në lartësi prej 640.88 €, e që me këtë Aktgjykim Gjykata Themelore e aprovon vetëm pjesën prej 214.74 €, nga Debitori JUSUF KUPAJ.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 603/09, datë 29.07.2013, me të cilin REFUZOHET SI E PABAZUAR Kërkesëpadia e Paditësit ILAZ BULECI nga Prizreni me të cilën ka kërkuar kompensim të të ardhurave personale në lartësi prej 15.450.55 €.

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 782/05, datë 06.08.2013, me të cilin pjesërisht aprovohet Kërkesa për pagesën e Borxhit nga Debitori ISA OSMANKAJ, Rr. Josip Rela, nr. 8, në Prizren, në lartësinë e kërkuar prej 209.16 €, kurëse pjesa e miratuar nga Gjykata është 36.43 €, pra shuma prej 172.73 € nuk është aprovuar për pagesë nga ana e Gjykatës Themelore nën arsyetimin se kjo pjesë e borxhit është parashkuar.

Me datë 11.10.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 567/10, datë 19.04.2013, me të cilin detyrohet Debitorja IGBALLE DANA, që ta paguaj borxhin ndj Kompanisë sonë në lartësinë e 45.80 €, si dhe shpenzimet e procedurës.

Nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIMI lidhur me lëndën C.nr. 430/11, datë 11.07.2012, me të cilin REFUZOHET SI I PABAZUAR KËRKESPADIA E PADITËSIT BLERIM SHALA nga Prizreni, ndaj ne si të Paditur të rendit të tretë që kompensimin për shpenzimin e ujit ta kërkojmë nga e paditura e rendit të parë znj. HYLKIJE JUNIKU, e jo nga Paditësi Blerim Shala.

Nga Gjykata e Apelit në Prishtinë AKTVENDIMI lidhur me lëndën AC.nr. 5155/12, datë 31.10.2012, (të Lëndës E.nr. 1385/12) me të cilin APROVOHET (PJESËRISHTË) SI I E BAZUAR ANKESA E KOMPANISË sonë ndaj punonjësit GËZIM DODA lidhur me PËRMBARIMIN për kompensimin e të ardhurave personale lartësi prej 7.314.76 €.

Nga Gjykata e Apelit në Prishtinë AKTVENDIMI lidhur me lëndën C.nr. 223/2006, datë 06.03.2013, me të cilin HIDHET POSHTË SI E PAAFATSHME ANKESA E TË PADITURIT IMER VORFAJ lidhur me borxhin në lartësi prej 278,24 €, dukië përfshirë edhe kamatën ligjore nga data e parashtrimit të Padisë e gjer në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale.

## VENDIMET NGA GJYKATA E APELIT NË FAVOR TË KOMPANISË

AKTGJYKIMI lidhur me lëndën AC.nr. 1355/13, datë 01.07.2013, lidhur me AKTGJYKIMIN C. nr. 774/11, datë 19.02.2013, me të cilin në pikën V të këtij Aktgjykimi refuzohet si e pabazuar kërkesa e Paditësit AHMET RAMA për kthim në vendin e tij të punës, Vendim të cilin e konfirmon edhe Gjykata e Apelit në Prishtinë. I njëjti ka parashtruar Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Është sjellë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 223/2006, datë 06.03.2013, me të cilin HIDHET POSHTË SI E PAAFATSHME ANKESA E TË PADITURIT IMER VORFAJ lidhur me borxhin në lartësi prej 278,24 €, duke përfshirë edhe kamatën ligjore nga data e parashtrimit të Padisë e gjer në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale.

## VENDIM NGA GJYKATA SUPREME KUNDËR KOMPANISË

Sot është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 266/13, datë 22.07.2013, me të cilin HUDHET AKTAKUZA e PSH (Prokurorit Shtetëror) –Departamenti për krime të rënda në Prizren, PP.nr. 277/12, të datës 19.06.2013, me çka edhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit GËZIM DODA.

## VENDIM NGA GJYKATA SUPREME NË FAVOR TË KOMPANISË

Me datë 25.10.2013, është sjellë nga Gjykata SUPREME në Prishtinë AKTGJYKIM lidhur me lëndën Rev.nr. 68/2013, datë 02.10.2013, me të cilin REFUZOHET SI I PABAZUAR REVIZIONI I PADITËSIT MURAT BRANDO nga Prizreni, i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr. 435/2011, datë 03.12.2012.

## NDËRPRERËJET E PROCEDURAVE SI PASOJË E VDEKJES SË DEBITORËVE

Nga Gj. Themelore në Prizren – ka ardhur AKTVENDIM C.nr. 872/05, datë 24.06.2013, me të cilin nga Gjykata Themelore në Prizren njoftohemi se është NDËRPRERË procedura në këtë çështje juridike kontestimore - BORXH- (537.46 €) pasi që Debitori HILMI ELSHANI ka vdekur.

Nga Gjykata Themelore në Prizren AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 783/05, datë 09.07.2013, me të cilin NDËRPRITET çështja juridike kontestimore për shkak të vdekjes së të Paditurit për borxh në lartësinë 409.53 €, MAHMUT FISHEKQI, Rr. Kosovës, nr. 25/A, në Prizren.

Nga Gjykata Themelore në Prizren AKTVEN-DIM lidhur me lëndën C.nr. 243/06, datë 18.09.2013, me të cilin NDËRPRITET kjo çështje Juridike Kontestimore (për borxh në lartësi prej 1022.69 €) pasi që Debitori HYSIN VLLAÇO ka VDEKUR.

## LËNDËT QË JANË NË PROCEDURË DHE QË KËRCËNOJNË KOMPANINË

Lënda C.nr. 1214/12, datë 05.03.2013, KONTEST PUNE nga z. Remzi Hoxha, F.Zhur, KK Prizren, Padi për kthim në vendin e punës dhe dëmshpërblimi për kohën sa nuk ka punuar.

Lënda C.nr. 214/10, datë 23.05.2012, KONTEST PUNE nga z. Hanefi Muharremi, Rr. Kasem Begu, nr. 17, nga Prizreni, Padi për kthim në vendin e punës dhe dëmshpërblimi për kohën sa nuk ka punuar.

Lënda C.nr. 116/03, Padi nga z. Xhezair Bajrami nga Dragashi, për KOMPENSIM DËMI në vlerë prej 21.447.32 €, shumë kjo e përlogaritur për periudhën kohore vetëm deri më datë 14.06.2012, për periudhën kohore shtesë ka për tu bërë përlogaritje e re, si dhe shpenzimet procedurale.

Lënda C.nr. 262/10, Padi e ngritur nga z. Shaban Kurtaj, F.Zhur, KK Prizren, për vërteti-min e pronësisë sipas mbajtjes dhe pranimit, lëndë kjo në të cilën ne jemi thirrur në mungesën e legjitimacionit pasiv pasi që bëhet fjalë sipas të gjitha gjasave për pronë të KK Prizren apo Qeverisë së Republikës së Kosovës, mirëpo pasi që ende nuk ka përfunduar së gjykuari kjo lëndë ne jemi në pritje të Vendimit Gjyqësorë lidhur me lëndën në fjalë.

## PROPOZIM PËR EKZEKUTIM SIPAS AKTGJYKIMEVE

Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit ndaj Sait Skenderi;  
 Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Dashnor Gërmizaj;  
 Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Neshat Poniku;  
 Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Haki Shehu;  
 Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Irfan Bojaxhiu, dhe,  
 Me datë 01.07.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim sipas aktgjykimit Zejnel Braha.  
 Sot me datë 11.10.2013, është bërë propozim për lejimin e ekzekutimit sipas Aktgjykimit për lëndën C.nr. 408/06, datë 23.04.2013, ndaj Debitores Sadete Curri.

## PROPOZIM PËR LEJIMIN EKZEKUTIMIT PËR BORXH

Me datë 14.01.2013, ditë e HËNË është përgatitur për dërgim në Gjykatën Themelore në Prizren – Dega në Suharekë PROPOZIM PËR LEJIMIN E EKZEKUTIMIT për dëmin e shkaktuar.  
 Me datë 29.04.2013, kemi bërë PROPOZIM PËR EKZEKUTIM, ndaj Maksuti Ibrahim.  
 Me datë 29.04.2013, kemi bërë PROPOZIM PËR EKZEKUTIM, ndaj Petrit Nuhaj.  
 Me datë 29.04.2013, kemi bërë PROPOZIM PËR EKZEKUTIM, ndaj Osman Hoxhaj.  
 Me datë 30.08.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim për borxh ndaj Shefqet Hiseni;  
 Me datë 30.08.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim për borxh ndaj Bajram Gashi, si dhe,  
 Me datë 03.09.2013, kemi bërë propozim për ekzekutim për borxh ndaj Xhavit Ukaj.  
 Me datë 11.10.2013, është bërë propozim për lejimin e ekzekutimit për borxh në lartësi prej 505.89 € ndaj Debitorit Naze Ninaj, Rr. Drinit, pn. nga Prizreni  
 Me datë 28.06.2013, kemi bërë PROPOZIM PËR EKZEKUTIM, ndaj Jashar Hashani.

Procedurat Gjyqësore të pambaruara

I kemi disa raste për të cilat mund të ndodhë që Gjykata të merr vendim i cili nuk do të shkonte në interes të Korporatës sonë, këtu në radhë të parë mendojmë për:

Lënda C.nr. 603/09, Kontest pune- presim Ftesë nga Gjykata Komunale për Padinë ndaj nesh të 3 (tre) ish anëtarëve të Bordit të drejtorëve të KRU-së (Ilijaz Buleci, Sabit Bytyqi dhe Sylejman Gashi);

Lënda C.nr. 214/10, Kontest pune - ne jemi në cilësinë e të Paditurit, edhe kjo është një lëndë me epilog të pa parashikueshëm se si do të përfundojë;

Lënda C.nr. 774/11, Kontest Pune – ne jemi në cilësinë e të Paditurit, edhe kjo është një lëndë me epilog që nuk mund të parashikohet se si do të përfundojë.

Lënda C.nr. 262/10, si të Paditur - Kontest Pronësorë, ne jemi thirrur në mungesë të legjitimitetit pasiv;

Lëndën C.nr. 828/11, si të Paditur - për PENGIM NË POSEDIM, ende nuk kemi ndonjë Vendim nga Gjykata Themelore;

Lëndën C.nr. 116/03, si të Paditur - Kontest pronësorë, ne jemi thirrur në mungesë të legjitimitetit pasiv;

Lënda C.nr. 745/05-IV, si të Paditur – shkaktim dëmi ndaj Paditësit, edhe në këtë lëndë jemi thirrur në mungesë të legjitimitetit pasiv.

Për Lëndën C.nr. 774/11, KONTEST PUNE, është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 842/2006, PADI PËR BORXH në lartësi prej 1.202.51 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 793/10, PADI PËR BORXH në lartësi prej 865.99 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 173/04, PADI PËR BORXH në lartësi prej 174.86 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 1214/12, KONTEST PUNE, është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 223/06, PADI PËR BORXH në lartësi prej 278.24 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 567/10, PADI PËR BORXH në lartësi prej 45.80 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 441/03, PADI PËR BORXH në lartësi prej 449.73 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 342/05, PADI PËR BORXH në lartësi prej 268.31 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 84/12, PADI PËR BORXH në lartësi prej 490.66 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Për Lëndën C.nr. 850/12, PADI PËR BORXH në lartësi prej 270.31 Euro , është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.

Me datë 19.02.2013, ditë E MARTE, në ora 1<sup>120</sup>, në Gjykatën Komunale në PRIZREN, DHOMA NR. 216, është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore për lëndën C.nr. 774/11.

Me datë 20.02.2013, ditë E MËRKURE, në ora 10<sup>00</sup>, në Gjykatën Themelore në PRIZREN, DHOMA NR. 108, është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore për lëndën C.nr. 842/2006.

Me datë 25.02.2013, ditë E HËNË, në ora 10<sup>00</sup>, në Gjykatën Themelore në PRIZREN, DHOMA NR. 215, është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore për lëndën C.nr. 793/10, si Padi tës për BORXH në lartësi prej 865.99 Euro.

Me datë 28.02.2013, ditë E ENJËTE, në ora 09<sup>00</sup>, në Gjykatën Themelore në PRIZREN, DHOMA NR. 208, është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore për lëndën C.nr. 173/04, si Padi tës për BORXH 174.86 Euro.

Më 05.03.2013, ora 11.<sup>00</sup>, ditë E MARTE kemi qenë në Gjykatën Themelore për lëndën C.nr. 1214/12, DHOMA NR. 216, si TË PDITUR për KONTEST PUNE nga Padi tësi REMZI HOXHA.

Me datë 06.03.2013, ditë E MËRKURË, në ora 10<sup>00</sup>, në Gjykatën Themelore në PRIZREN, DHOMA NR. 215, kemi qenë në Gjykatën Themelore për lëndën C.nr. 223/06, si Padi tës për BORXH prej 278.24 Euro.

Me datën 14.03.2013, ora 10.<sup>00</sup>, ditë E ENJËTE në PRIZREN, DHOMA NR. 222, kemi qenë në Gjykatën Themelore për lëndën C.nr. 567/10, si Padi tës për BORXH në shumën prej 45.80 Euro.

Me datën 15.03.2013, ditë E PREMTE, ora 10.<sup>30</sup>, DHOMA NR. 108, kemi qenë në Gjykatën Themelore për lëndën C.nr. 441/03, si Padi tës për BORXH 449.76 Euro.

Me datë 25.03.2013, ditë E ENJËTE, në ora 11.<sup>00</sup>, DHOMA NR. 215, kemi qenë në Gjykatën Themelore për lëndën C.nr. 342/05, si Padi tës për BORXH 268.31 Euro.

Me datë 25.03.2013, ora 14.<sup>30</sup> ditë E MËRKURE, në DHOMA NR. 208, kemi qenë në Gjykatën Themelore për lëndën C.nr. 84/12, si Padi tës për BORXH 490.66 Euro.

Me datë 27.03.2013, ditë E MËRKURË, Në ORA 10.<sup>00</sup>, Dhoma nr. 222, kemi qenë në Gjykatën Themelore për lëndën C.nr. 850/12, si Padi tës për BORXH. 270.31 Euro.

#### KALLËZIM PENAL

Me datë 31.05.2013, e kemi dërguar në Prokurorinë Themelore në Prizren një KALLËZIM PENAL për shkak të dëmit të shkaktuar Kompanisë nga punonjësi Arsim Krasniqi Inkasant në njësinë punese të Suharekës



### HEQJE DORË NGA KËRKESËPADIA

1. Më 08.03.2013, ora 11.<sup>00</sup>, ditë E MARTË, për lëndën C.nr. 766/05, Gjykata Themelore FTESË PËR SHQYRTIM KRYESORË. Pasi që Paditësi e ka paguar borxhin e tij në shumën totale prej 240.06 Euro ndaj të paditurit.
2. Më datë 07.03.2013, është tërhequr Padia e ish punonjësit të Kompanisë Z. Hamza Halabak, me çka të njëjtit i është pranuar kontinuiteti i stazhit të punës dhe i njëjti është kthyer në punë.
3. Më datë 12.03.2013, është tërhequr Padia e punonjësit të Kompanisë Z. Hysni Ahmeti, pasi që i njëjti është në marrëdhënie pune në Kompani.

### PAJTIM GJYQËSORË

Me datë 07.05.2013 kemi bërë PAJTIM GJYQËSORË për Lëndën C.nr. 853/2008.

### LËNDËT QË JANË NË PROCEDURË DHE QË KËRCËNOJNË KOMPANINË

Lënda C.nr. 1214/12, datë 05.03.2013, KONTEST PUNE nga z. Remzi Hoxha, F.Zhur, KK Prizren, Padi për kthim në vendin e punës dhe dëmshpërblimi për kohën sa nuk ka punuar.

Lënda C.nr. 214/10, datë 23.05.2012, KONTEST PUNE nga z. Hanefi Muharremi, Rr. Kasem Begu, nr. 17, nga Prizreni, Padi për kthim në vendin e punës dhe dëmshpërblimi për kohën sa nuk ka punuar.

Lënda C.nr. 116/03, Padi nga z. Xhezair Bajrami nga Dragashi, për KOMPENSIM DËMI në vlerë prej 21.447.32 €, shumë kjo e përlogaritur për periudhën kohore vetëm deri më datë 14.06.2012, për periudhën kohore shtesë ka për tu bërë përlogaritje e re, si dhe shpenzimet procedurale.

### PARASHTRESË

Me date 12.04.2013, kemi bërë PARASHTRESË PËR PËRJASHTIMIN E EKSPERTIT FINANCIAR z. HAMDË KASTRATI PËR KRYERJEN E EKSPERTIZËS FINANCIARE sipas kërkesës së AKTVENDIMIT C.nr. 603/09, të datës 22.03.2013.

Më datë 12.04.2013, i jemi drejtuar Gjykatës Themelore me PARASHTRESË duke kërkuar nga e njëjta që ta përjashtojë ekspertin e caktuar me Aktvendimin C.nr. 603/09, datë 22.03.2013. Parashtresa jonë është pranuar nga ana e Gjykatës dhe është caktuar ekspert tjetër.

Më datë 15.05.2013, kemi shkruar PËRGJIGJE NË KËRKESËN, Nr. 999/13, datë 22.04.2013, E AVOKATIT TË POPULLIT drejtuar BORDIT TË DREJTORVE.

Me datë 27.05.2013, e kam dërguar në Gj.Themelore një Parashtresë lidhur me lëndën PM.nr. 149/11, lidhur me Lëndën e ardhur GABIMISHT tek ne ngase e njëjta duhet ti drejtorhet K.R.U. "RADONIQI"-Gjakovë.

### PARASHTRESA LIDHUR ME ADRESAT E KONSUMATORËVE

Me datë 22.05.2013, kemi dhënë PARASHTRESË LIDHUR ME ADRESËN e Konsu-matorit Isa Osmankaj.

Me datë 23.05.2013, kemi dhënë PARASHTRESË LIDHUR ME ADRESËN e Konsu-matorit Haxhi Qerreti.

Me datë 20.06.2013, kemi dhënë PARASHTRESË LIDHUR ME ADRESËN e Konsu-matorit Aziz Bytyqi.

## VENDIMET GJYQËSORE KUNDËR KOMPANISË

Me datë 29.05.2013, nga Gjykata SUPREME E KOSOVËS, ka ardhur AKT-GJYKIMIN Rev.nr. 248/2012, datë 17.05.2013, me të cilin nga kjo Gjykatë REVIZIONI I PARASHTRUAR nga Kompania kundë Gëzim Doda është HEDHUR POSHTË SI I PABAZUAR. GJYKATA SUPREME NË FAVOR TË KOMPANISË Me datë 13.06.2013, nga Gjykata Themelore e Prizrenit ka ardhur AKTVENDIM C.nr. 782/05, datë 07.06.2013 sipas të cilit Padia e Kompanisë sonë konsiderohet e tërhequr nën arsyetimin se Padiësi (Kompania) nuk e ka siguruar adresën e saktë të të paditurit, do të jepet përgjigje pasi që ne e kemi kryer punën por Gjykata e ngatërruar lëndën.

Me datë 22.10.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIM lidhur me lëndën C.nr. 770/05, datë 07.10.2013, me të cilin REFUZHET si tërësisht e pabazuar Padia e Kompanisë (për borxh në lartësi prej 410.63 €) ndaj Debitorit AZIZ BYTYQI.

Me datë 24.10.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 768/05, datë 21.10.2013, me të cilin konsiderohet se PADIA E PADITËSIT TËRHIQET, (për borxh në lartësi prej 336.50 €) pasi që Kompania sipas kërkesës së Gjykatës Themelore nuk ka mundur që ta gjej adresën e saktë të vendbanimit apo vendqëndrimin të Debitorit AJRIDIN AVDO. Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIM lidhur me lëndën C.nr. 189/06, datë 18.10.2013, me të cilin refuzohet si e pabazuar Kërkesëpapia e Padiësit K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A. në Prizren, ndaj Debitorit IMER BISLIMAJ, nën arsyetimin se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk është provuar se këtu i padituri Imer Bislimaj, ka detyrime-borxh ndaj Padiësit, pasi që me vetëm një faturë nuk mundë të provohet borxhi i pretenduar i Padiësit.

Me datë 21.11.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIM lidhur me lëndën C.nr. 320/06, datë 14.11.2012, me të cilin REFUZHET SI I PABAZUAR KËRKESPADIA E KOMPANISË sonë ndaj Debitorit HALIL SALLAUKA për borxhin në lartësi prej 335.28 €.

Me datë 16.12.2013 është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIM lidhur me lëndën C.nr. 424/06, datë 03.12.2013, me të cilin REFUZHET SI E PABAZUAR KËRKESPADIA E KOMPANISË sonë ndaj Debitorit ESHREF KRASNIQI për borxhin në lartësi prej 1.268,51 €.

Me datë 18.12.2013, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren AKTGJYKIM lidhur me lëndën C.nr. 336/06, datë 21.11.2013, me të cilin REFUZHET SI E PABAZUAR KËRKESPADIA E KOMPANISË sonë ndaj Debitorit AVNI JAKUPI për borxhin në lartësi prej 943,02 €.

### SHPALLET INKOMPETENTE GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Me datë 24-5.04.2013 është sjellë nga Gjykata Themelore AKTVENDIM C.nr. 246/10, datë: 19.04.2013, me të cilin Gjykata Themelore në Prizren shpallet INKOMPETENTE në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje kontestimore, dhe se Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore ka kompetence që në shkallë të parë të gjykojë për kontestet ndërmjet personave juridik.

## LËNDËT E PROCEDUARA NË GJYKATË

Tabela:21

Muaji	Gjithse j Padi për kyçje ilegale	Gjithse j Padi për ri- kyçje ilegale	Totali i Padive
Janar	63	/	63
Shkurt	10	/	10
Mars	/	/	/
Prill	0	0	0
Maj	0	0	0
Qershor	0	0	0
Korrik	/	/	/
Gusht	/	/	/
Shtator	/	/	/
Tetor	/	/	/
Nëntor	/	/	/
Dhjetor	/	/	/
<b>Totali</b>	<b>73</b>	<b>0</b>	<b>73</b>

Masat e shqiptuara nga Gjykata në Prizren lidhur me Paditë e bëra nga KRU për kyçjen ilegale të konsumatorëve për periudhën kohore Janar – Qershor 2013

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2013, nga Gjykata për Kundërvajtje e Prizrenit janë shqyrtuar gjithsej 82 (tetëdhjetë e dy) Kërkesa për kyçje ilegale.

- 1 (një) masë të qortimit;
2. Nga këto Kërkesa 5 (pesë) kërkesa janë hedhur poshtë;
3. Për 5 (pesë) Kërkesa është shqiptuar masa e pezullimit;
4. Për 71 (shtatëdhjetë e një) Kërkesa është shqiptuar masa e dënimit në të holla, ku shuma totale e dënimeve e kap shifrën e 6010 (gjashtëmijë e dhjetë) €uro.

Tabela:22

## PARAQITJA TEBELARE

Gjashtëmujori i I-rë	Masa e qortimit	Hidhet poshtë	Masa e pezullim it	Masa e dënimit në €uro	Të kryera gjithsej	Shuma totale e dënime ve në €
Janar	/	/	/	13	13	1300 €
Shkurt	/	/	/	15	15	1350 €
Mars	/	/	/	/	/	/
Prill	/	4	2	2	8	200 €
Maj	/	/	1	5	6	410 €
Qershor	/	/	2	8	10	550 €
Korrik	1	/	/	19	20	1410 €
Gusht	/	/	/	/	/	/
Shtator	/	/	/	/	/	/
Tetor	/	/	/	/	/	/
Nëntor	/	/	/	/	/	/
Dhjetor	/	1	/	9	10	790 €
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>71</b>	<b>82</b>	<b>6010 €</b>

## VENDIMET E LËSHUARA PËR ANKESAT E KONSUMATORËVE

Gjatë këtij gjashtëmujori janë shqyrtuar edhe Ankesat e konsumatorëve të cilat kanë marrë përgjigje në afatet optimale të parapara sipas Rregulloreve të Korporatës.

Paraqitja tabelare e Vendimeve të lëshuara nga Ankesat e konsumatorëve:

**Tabela:23**

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
Janar	43	
Shkurt	43	
Mars	72	
Prill	36	
Maj	42	
Qershor	20	
Korrik	/	
Gusht	52	
Shtator	57	
Tetor	65	
Nëntor	35	
Dhjetor	56	
Totali	521 Vendime	

### 2.3.6 RAPORT I ZYRES SË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Aktivitetet e punës së përditshme detalisht janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezentohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionim optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka patur peshë dhe ndikim të veçantë.

Në consultë me Menaxherin, kam përpiluar një pasqyrë ditore raportuese për evidentim të aktiviteteve të përditshme e cila e njëjta do të shërben për përpilimin e raporteve periodike dhe vjetore.

Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.

Ndërhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 58 herë.

Ndërhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 78 herë.

Ndërhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 43 herë.

Ndërhyrje në njesitë (Shatërvan, Depo, Koagolatorë) : 77 herë.

Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 859 herë.

Përkujdesje për qasjen e kompanisë në rrjetin e internetit.

Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësisë, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.

Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.

Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të kompanisë

Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.

Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe serviseve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike.

Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

Kemi përkrahur vendosjen e rrjetit të IPKO-s nëpër 5 pikat kyqje të kompanisë

Kemi popositur, furnizuar dhe instaluar 16 GB RAM memorje të Serverit kryesor NAVISION

Kemi shtuar 4 GB RAM ArcGIS Serverit.

Kam konfiguruar rrjetin e postës me atë të IPKO për funksionimin optimal të proceseve të kompanisë.

Kemi implementuar bashkarisht me ndermarrjen KONIKS – Gjilan, vendosjen e centraleve të re telefonike, Panasonic – 1242 (Tetor 2013).

Jemi në kërkim të ofertave për server të ri

Kemi krijuar Arka të reja me qëllim të kryerjes së pagesave direkt nga programi NAVISION.

- Kam marrë 5 certifikime Microsoft – 3 nivele mbështetur financiarisht nga USAID – KËISER dhe dy me investim vetanë.

### **Komentet dhe vërejtjet,**

- Mikroserveret e vendosur nëpër njësi janë duke u përdorur si backup serverë.
- Racku i sjellë nga USAID e që ka kushtuar 1000 Euro nuk është në shfrytëzim.
- Zgjidhja e problemeve me kontraktorin për furnizimi me pajisje të IT. Kemi shumë vonesa në marrjen e pajisjeve që po i porosisim.
- Ka mbetur Depo (Mulliri) pa e kyq në database për shkak të mungesës së pajisjes VPN Router.
- Kabineti ekzistues kompjuterik nuk është në gjendje optimale sa i përket sistemit kabllovik, koneksioneve, ventilimit, sigurisë, burimit energjetik e të ngjajshme.

- Kam kërkuar një shkresë ku ndalohet sjellja e kompjuterëve (pajisjeve elektronike) personale në zyrën e IT-se.

### Propozimet – kërkesat

- Mikroserveret e vendosur nëpër njësi të konfigurohen për funksion në bazë.
- Njohuritë rreth lëmisë së telefonisë fikse dhe centralave të tyre janë të mangëta. Mendoj se është në interes sipas mundësive financiare të kompanisë për mbajtjen apo vijimin e një trajnimi tek kompanitë përkatëse rreth konfigurimit dhe mirëmbajtjes së centralave të telefonisë p.sh siq është kompania Adria Telecommunications.
- Jam përgatitë për shumë certifikime tjera të Cisco Systems dhe Microsoft Certifications, mirëpo për shkak të obligimeve tjera nuk po mund t'i mbuloj dhe natyrisht këto kanë një kosto të parapagimit prandaj në këtë drejtim shpresoj në mbështetje të Kompanisë për pagimin e këtyre certifikimeve. Një certifikim Microsoft, kushton 80 \$ mirëpo një Cisco 260 \$.
- Meqenëse depoja nuk është ende e kyqur në rrjetin e aplikacionit NAVISION kërkoj blerjen e një VPN Routerit nga fuurnitori për instalim në Depo.
- Instalimi i mëparshëm i rrjetit kompjuterik i hasur në objekt ka vendosur kabinetet kompjuterike (RACK) në koridor i cili për shkaqe sigurie dhe të tjera nuk preferohet prandaj propozoj dhe kërkoj që të sigurohet një kthinë e veçantë brenda objektit me kushte të parapara ventilimi e sigurie që kabineti i tillë të vendoset në te. Me këtë aksion do të mënjanohej edhe vërejtja rreth gjendjes dhe sistemimit të kabineteve kompjuterike.
- Duhet gjetur hapësirë (dhome) e posaqme për vendosjen e të gjithë serverëve në te.
- Blerja e një VPN Routerit për Depo dhe disa pajisjeve baze për lap top dhe PC. Keto pajisje ende nuk janë sjelle nga kontraktori, ndersa porosia është bërë para 3 muajve.
- Blerja e një Cisco Fireëall ASA për sigurimin e rrjetit të kompanisë.

### 2.3.7 RAPORT I ZYRTARIT PËR SIGURI DHE SHËNDET NË PUNË

Për të vlerësuar gjendjen aktuale në lidhje me sigurinë në punë dhe mbrojtjen nga zjarri janë vizituar të gjitha njësitë e punës KRU " Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren shumica e objekteve të tyre nga ana Zyrtarit për sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit të punëtorëve në punë i përkrahur dhe i shoqëruar nga Zyrtari i Zyrës Ligjore të Kompanisë dhe atë:

Me datë 24.10.2013 kemi vizituar Njësinë Punuese Malishevë dhe po të njëjtën ditë njësi të njëjtën ditë Njësinë Punuese të Suharekës .

Me datë 25.10.2013 është vizituar Njësia Punuese Dragash, dhe

Me datat 20,21,22.11.2013 dhe 03.12.2013, janë vizituar objektet e Njesisë Punuese të Prizrenit.

Për disa objekte tek të cilat nuk është kryer vizitë është kërkuar nga Udhëheqësit e Njësive Punuese të na i dërgojnë të dhënat lidhur me atë se në çfarë gjendje janë ato.

Pas kryerjes së vizitave janë bërë Procesverbale për secilën Njësi Punuese veç e veç lidhur me gjendjen në të cilën ndodhen dhe si dhe mangësitë të cilat janë vërejtur ku edhe janë dhënë propozime për mënjanimin e mangësive ekzistuese.

Procesverbalet i janë dorëzuar Udhëheqësve të Njësive Punuese në mënyrë që të mënjanoen mangësitë ekzistuese.

Gjithashtu me datë 25.11.2013, kemi kontaktuar me Inspektorët e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit - Sektori i Parandalimit nga Zjarri, Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Gjatë këtij kontakti kemi biseduar për trajnimin e punëtorëve (Rojtarëve dhe Kujdestarëve) lidhur me mbrojtjen nga zjarri, dhe lëshimin e certifikatave pas trajnimit.

Nga të njëjtit kemi marrë përgjigjen që ata drejtpërdrejtë nuk e kryejnë trajnimin, por për këtë ekzistojnë firma të licencuara dhe njëra nga ato është "EFEKTI" e cila përveç që kryen trajnimin për mbrojtje kundër zjarrit, gjithashtu e bënë edhe servisimin e Aparateve kundër zjarrit, si dhe trajnimin për përdorimin dhe punën me klor, ku pas aftësimit e njëjta e bënë lëshimin e certifikatave.

Trajnimi i punëtorëve mundë të kryhet në grupe, nëpër objektet ku punëtorët (Rojtarët dhe Kujdestarët) e kryejnë punën.

Pasi që punëtorët (Rojtarët dhe Kujdestarët) në këtë drejtim nuk janë trajnuar, dhe të gjitha Aparateve kundër zjarrit u ka skaduar afati.

## Konkluzion

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të vitit 2013. Janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si dhe statutin e Kompanisë. Janë kompletuar të gjitha dokumentacionet e domosdoshme për të gjithë punëtorët (sipas programit NAVISION). Synim i Departmentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë. Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregullorëve të nevojshme për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dalura nga Menaxhmenti, Bordi i Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

## 2.4.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI FINANCIAR

### KOMENTET FINANCIARE

Gjatë vitit 2013, shërbimi financiar ka pasur aktivitete të shumta, në arritjen e përfomancave, së bashku me shërbimet tjera të kompanisë. Më poshtë do t'i cekim ndër më kryesoret:

- Duke u nisur nga raportet e rregullta ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, raporte që na kanë shoqëruar gjatë gjithë vitit. Gjithashtu, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, ku shikohet se a janë të nevojshme blerjet, për kërkesat e bëra.
- Prgatitja e raporteve mujore-tremujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj, kanë qenë të rregullta, në lidhje me performancën e kompanisë me anëtarët e bordit dhe kryeshefin ekzekutiv.
- Raportimet tre mujore dhe vjetor për MZHE për investimet kapitale të bëra nga ta, ku në vitin 2013, investimet kanë qenë të mëdha, gjithashtu edhe investimet vetanake nuk kanë munguar.
- Regjistrimi i investimeve është bërë në mënyrë të vazhdueshme, nga zyrtari i regjistrimit të aseteve.

- Githashtu në fund vit, janë caktuar komisionet për regjistrimin dhe barazimin e arkave, inventarit dhe stoqeve në depo.
- Kemi pasur edhe takime të shumta, me zyrtarët e ATK-së në Prishtinë, lidhur me borgjin e akumuluar për vitet 2002, 2003, 2004 dhe 2005, gjithashtu edhe për nënshkrimin e marrëveshjes për TVSH mbi inkasim
- Kemi pasur angazhime të shumta për një inkasim sa më të mirë dhe në ulje të shpenzimeve në raport me inkasimin, gjë që performancat për këtë vit janë më të mira se sa ato të vitit të kaluar.
- Shpenzimet operative të ndërmarrjes, kanë qenë më të larta, në krahasim me shpenzimet e vitit të kaluar, por që mbulueshmëria për këtë vit është më e lartë. Kjo do të thotë se aktivitetet e ndërmarrjes kanë qenë më të medha, duke ditur se janë shtuar zonat menaxhuese të kompanisë, rrjeti është zgjeruar etj.
- Nëse i shikojmë disa nga pozicionet kryesore të shpenzimeve, atëherë te ai i pagave kemi një rritje, në krahasim me vitin e kaluar. Pra siç e cekëm më lartë, që kompania ka shtuar aktivitetin e saj, dhe me këtë ka qenë e nevojshme edhe shtimi i stafit të saj, në mënyrë që shërbimet tona t'i kënaqin nevojat e konsumatorëve.



**2.4.1.1 PASQYRË TË PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE DHE  
RREZULTATET  
JANAR – DHJETOR 2012- 2013**

• **NJËSIA PUNUESE – PRIZREN**

MUAJI	JAN-DHJET-2012	JAN-DHJET-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	16,166,139	15,580,205	(585,934)	-3.62
<i>Faturimi m3</i>	6,157,030	6,175,221	18,191	0.30
<i>Faturimi nga uji €</i>	2,994,459.68 €	3,298,024.73 €	303,565.05 €	10.14
<i>Faturimi- te tjera €</i>	72,111.42 €	74,836.26 €	2,724.84 €	3.78
<i>Faturimi Total €</i>	3,066,571.10 €	3,372,860.99 €	306,289.89 €	9.99
<i>Inkasimi nga uji €</i>	2,206,482.78 €	2,463,511.85 €	257,029.07 €	11.65
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	72,455.14 €	64,777.98 €	- 7,677.16 €	-10.60
<i>Inkasimi Total €</i>	2,278,937.92 €	2,528,289.83 €	249,351.91 €	10.94
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	27850	29512	1662	5.97
<i>% e inkasimit</i>	73.69	74.70	1.01	1.37
<i>Shpenzimet</i>	2,161,066.59 €	2,338,669.58 €	177,602.99 €	8.22
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	10,009,109	9,404,984	(604,125)	-6.04
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	61.91	60.36	-1.55	-2.50
<i>Mbulimi operativ</i>	1.05	1.08	0.03	2.52

2.4.1.2 NJËSIA PUNUESE  
SUHAREKË

MUAJI	JAN-DHJET-2012	JAN-DHJET-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	1,831,149	1,905,717	74,568	4.07
<b>Faturimi m3</b>	740,693	818,845	78,152	10.55
<b>Faturimi nga uji €</b>	351,434.43 €	443,515.71 €	92,081.28 €	26.20
<b>Faturimi- te tjera €</b>	32,404.73 €	24,397.82 €	- 8,006.91 €	-24.71
<b>Faturimi Total €</b>	383,839.16 €	467,913.53 €	84,074.37 €	21.90
<b>Inkasimi nga uji €</b>	205,534.82 €	226,799.87 €	21,265.05 €	10.35
<b>Inkasimi - te tjera €</b>	30,956.24 €	26,741.55 €	- 4,214.69 €	-13.61
<b>Inkasimi Total €</b>	236,491.06 €	253,541.42 €	17,050.36 €	7.21
<b>Nr. i Konsumatorëve</b>	3948	4737	789	19.98
<b>% e inkasimit</b>	58.48	51.14	-7.35	-12.56
<b>Shpenzimet</b>	285,209.36 €	320,455.56 €	35,246.20 €	12.36
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	1,090,456	1,086,872	(3,584)	-0.33
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	59.55	57.03	-2.52	-4.23
<b>Mbulimi operativ</b>	0.83	0.79	-0.04	-4.58

**2.4.1.3 NJËSIA PUNUESE –  
DRAGASH**

<b>MUAJI</b>	<b>JAN-DHJET-2012</b>	<b>JAN-DHJET-2013</b>	<b>NDRYSHIMI</b>	<b>NDRYSHIMI %</b>
<b>Prodhimi m3</b>	446,815	461,198	14,383	3.22
<b>Faturimi m3</b>	202,316	230,197	27,881	13.78
<b>Faturimi nga uji €</b>	119,897.24 €	149,032.93 €	29,135.69 €	24.30
<b>Faturimi - te tjera €</b>	6,204.66 €	4,875.08 €	- 1,329.58 €	-21.43
<b>Faturimi Total €</b>	126,101.90 €	153,908.01 €	27,806.11 €	22.05
<b>Inkasimi nga uji €</b>	108,512.64 €	123,740.28 €	15,227.64 €	14.03
<b>Inkasimi - te tjera €</b>	5,992.95 €	3,117.80 €	- 2,875.15 €	-47.98
<b>Inkasimi Total €</b>	114,505.59 €	126,858.08 €	12,352.49 €	10.79
<b>Nr. i Konsumatorëve</b>	1078	1116	38	3.53
<b>% e inkasimit</b>	90.50	83.03	-7.48	-8.26
<b>Shpenzimet</b>	101,315.01 €	107,746.93 €	6,431.92 €	6.35
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	244,499	231,001	(13,498)	-5.52
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	54.72	50.09	-4.63	-8.47
<b>Mbulimi operativ</b>	1.13	1.18	0.05	4.17

#### 2.4.1.4 NJËSIA PUNUESE –MALISHEVË

MUAJI	JAN-DHJET-2012	JAN-DHJET-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	1,170,188	1,326,495	156,307	13.36
<b>Faturimi m3</b>	572,204	524,417	-47,787	-8.35
<b>Faturimi nga uji €</b>	293,847.14 €	305,167.19 €	11,320.05 €	3.85
<b>Faturimi- te tjera €</b>	17,308.03 €	9,410.70 €	- 7,897.33 €	-45.63
<b>Faturimi Total €</b>	311,155.17 €	314,577.89 €	3,422.72 €	1.10
<b>Inkasimi nga uji €</b>	173,392.14 €	215,601.19 €	42,209.05 €	24.34
<b>Inkasimi - te tjera €</b>	17,339.90 €	11,972.88 €	- 5,367.02 €	-30.95
<b>Inkasimi Total €</b>	190,732.04 €	227,574.07 €	36,842.03 €	19.32
<b>Nr. i Konsumatorëve</b>	3350	3513	163	4.87
<b>% e inkasimit</b>	59.01	70.65	11.64	19.73
<b>Shpenzimet</b>	202,003.43 €	250,511.04 €	48,507.61 €	24.01
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	597,984	802,078	204,094	34.13
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	51.10	60.47	9.36	18.33
<b>Mbulimi operativ</b>	0.94	0.91	-0.04	-3.79

### 2.4.1.5 HIDROREGJIONI JUGOR - JANAR-DHJETOR- 2012-2013

MUAJI	JAN-DHJET-2012	JAN-DHJET-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	19,614,291	19,273,615	(340,676)	(1.74)
<i>Prodhimi - l/sec</i>	622	611	(10.8)	(1.74)
<i>Faturimi m3</i>	7,672,243	7,748,680	76,437	1.00
<i>Faturimi l/sec</i>	243	246	2.4	1.00
<i>Faturimi nga uji €</i>	3,759,638.49 €	4,195,740.56 €	436,102.07 €	11.60
<i>Faturimi- te tjera €</i>	128,028.84 €	113,519.86 €	- 14,508.98 €	(11.33)
<i>Faturimi Total €</i>	3,887,667.33 €	4,309,260.42 €	421,593.09 €	10.84
<i>Inkasimi nga uji €</i>	2,693,922.38 €	3,029,653.19 €	335,730.81 €	12.46
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	126,744.23 €	106,610.21 €	- 20,134.02 €	(15.89)
<i>Inkasimi Total €</i>	2,820,666.61 €	3,136,263.40 €	315,596.79 €	11.19
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	36226	38878	2652	7.32
<i>% e inkasimit</i>	71.65	72.21	0.55	0.77
<i>Shpenzimet</i>	2,749,594.39 €	3,017,383.11 €	267,788.72 €	9.74
<i>Paga bruto</i>	1,469,456.03 €	1,568,262.00 €	98,805.97 €	6.72
<i>Mirmba. dhe riparimet</i>	263,211.46 €	255,806.00 €	- 7,405.46 €	(2.81)
<i>Rryma elektrike</i>	656,600.20 €	770,010.00 €	113,409.80 €	17.27
<i>Shpenzi. e derivateve</i>	108,859.22 €	92,184.00 €	- 16,675.22 €	(15.32)
<i>Kemikalet</i>	12,894.56 €	8,086.00 €	- 4,808.56 €	(37.29)
<i>Shpenzi. tera operat.</i>	238,572.92 €	339,017.00 €	100,444.08 €	42.10
<i>Uji l pafaturuar në m3</i>	11,942,048	11,524,935	(417,113)	(3.49)
<i>Uji l pafaturuar ne %</i>	60.88	59.80	-1.09	(1.79)
<i>Uji l pafaturuar l/sec</i>	378.68	365.45	-13.23	(3.49)
<i>Mbulimi operativ</i>	1.03	1.04	0.01	1.32

## 2.4.1.6 PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT - 2013

### • HIDROREGJIONI JUGOR - JANAR-DHJETOR- 2013

MUAJI	JAN.-DHJET.2013	CAQET E PLAN.	DEVIJIMI I CAQ.	DEVI. I CAQ.NË %
<i>Prodhimi m3</i>	19,273,615	20,567,045	(1,293,430)	-6.29
<i>Faturimi m3</i>	7,748,680	8,377,200	(628,520)	-7.50
<i>Faturimi në %</i>	40.2	40.7	(0.53)	
<i>Faturimi nga uji €</i>	4,195,740.56 €	4,376,938.72 €	181,198.16 €	-4.14
<i>Faturimi- te tjera €</i>	113,519.86 €	135,500.00 €	21,980.14 €	-16.22
<i>Faturimi Total €</i>	4,309,260.42 €	4,512,438.72 €	203,178.30 €	-4.50
<i>Inkasimi nga uji €</i>	3,029,653.19 €	3,302,318.21 €	272,665.02 €	-8.26
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	106,610.21 €	130,094.00 €	23,483.79 €	-18.05
<i>Inkasimi Total €</i>	3,136,263.40 €	3,432,412.21 €	296,148.81 €	-8.63
<i>Nr. i Konsumatorëve te fat.</i>	38,878	36653	2225	6.07
<i>% e inkasimit</i>	72.21	75.45	-3.24	
<i>Shpenzimet</i>	3,017,383.11 €	2,878,002.00 €	139,381.11 €	4.84
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	11,524,935	12,189,845	-664,910	-5.45
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	59.80	59.27	0.53	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.04	1.19	-0.15	-12.85

## KOMENTET: SHPK

Nga të dhënat tabelare shihet se ne dhjetor te vitii 2013 në nivel rajonal janë shtyp 38,878 fatura të cilat janë shpërnda tek konsumatorët.

Krahasuar me dhjetorin e vitit 2012 kemi një rritje te numrit të konsumatorëve prej 2,559 konsumatorëve. Kjo rritje është rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve për këto arsye:

4. Marrjes në menaxhim të fshatrave Lugishtë e Hasit dhe Kabash i Hasit në njësin e Prizrenit ndërsa në njësin e Suharekës fshati Mushtisht, Gjinoc dhe Deberdelan
5. Legalizimi i konsumatorëve ilegal, 1044 konsumatorë
6. Pëlqimeve per kyqje, 160 konsumatorë

Rritjen e numrit të konsumatorëve nëse e analizojm sipas kategorive të konsumatorëve atëherë kemi këtë rritje:

- c. Amviseri , 1429 konsumatorë
- d. Biznese , 142 konsumatorë
- e. Institucione , 28 konsumatorë

Në nivel rajonal në euro kemi një rritje në faturim prej 421,593.09 euro në krahasim me vitin 2012. Kjo rritje vjen si rezultat :

- a. Rritjes se ujit të faturuar te konsumatorët ekzistues dhe konsumatorët e rinj ( tarifa fikse dhe tarifa volumetrike)
- b. Rritja e tarifës volumetrike e ujit në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012 ( nga 0.31 euro/m<sup>3</sup> në 0.35 euro/m<sup>3</sup> te amvisërit, ndërsa te bizneset dhe institucionet nga 0.61 euro/m<sup>3</sup> në 0.69 euro/m<sup>3</sup>)

## KOMENTET OPERATIVE

\*Gjatë vitit 2013 ne kompanin e “Hidroregjionit Jugor” ka pasur renje të prodhimit prej 340,676 m<sup>3</sup> ose 1.74 % renje, kjo renje të prodhimit të ujit ka ndikuar për shkak të rënijes të nivelit të burimeve të vjetra, mirëpo falë shtime te kapaciteteve të reja në të gjitha njesit operuse, kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë.

\*Raportet tregojne qe UPF ne nivel regjional per vitin 2013 eshte 59.80 % ose 1.09% me pakë humbje nga viti paraprak, kështu që është arritur të kemi renje te ujit të pafaturuar.

## ARSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN-MOSARRITJEN E OBJEKTIVAVE

- Mos plotësimi i limitit të inkasimit nga ana e disa inkasantëve.
- Mospagesa e faturave nga një pjesë e Institucioneve.
- Për mos arritjen e objektivave per vitin 2013 janë numri i defekteve ne sistemin e ujesjellesit, për shkak te rrjetit të vjetërsuar.
- Numri i madhë i konsumatorëve –Raste sociale .
- Kërcënimi fizik i Inkasantëve dhe ekipës për kontrollë dhe shkyçje.

- Shpenzimet e mëdha të rrymës elektrike.
- Në peruidhen e dimrit konsumi i ujit bie dukshëm për shfrytëzim nga ana e konsumatorëve.
- Nje prej arsyeve që ka ndikuar në mos arritjen e objektivave është edhe keqpërdorimi i ujit nga ana e qytetarve.

## MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

- Angazhimet shtesë të ekipes së kontrollës për të verifikuar keqpërdoruesit si dhe të ekipes së detektimit për të gjetur rrjedhjet.
- Mbështetja e inkasantëve me ekopëne kontrollës në shkyqjen e të gjithë konsumatorët që kanë borzje mbi 300 €.
- Furnizim me të rregulltë duke analizuar mundsinë e heqjes së reduktimeve.
- Vetëdisimi i qytetarve për shfrytëzimin e drejtë të ujit të pijes, duke mos e keqpërdorur, njeherit të jenë të përgjegjshëm në pagesa ndaj shërbimit të Kompanisë.
- Bashkëpunimi me mediat lokale në sensibilizimin e konsumatorëve në veçanti dhe opinionit publik.
- Aplikimi i ç'kyçjeve individuale ndaj konsumatorëve të papërgjegjshëm, reduktime për lagjet/fshatrat që nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë.
- Rritja e presionit ndaj Institucioneve komunale dhe bizneseve të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë sonë.

### • Arsyeshmëria e shpenzimeve

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për vitin 2013, në krahasim me vitin 2012, kanë qenë më të larta, gjithashtu edhe inkasimit ka qenë më i lartë dhe mbulueshmëria operative ka qenë mbi një. Më poshtë do t'i cekim disa nga arsyet dhe ndryshimet në disa nga pozicionet kryesore të shpenzimeve.

Së pari shpenzimet si total në këtë tre muhor janë më të larta, duke ditur se aktivitetet operative dhe investuese kanë qenë në rritje, gjë që ka ndikuar edhe në rritje të inkasimit në këtë tre muhor.

Në pozicionin e pagave edhe pse ka qenë numri i punëtorëve me tre muhorin e kaluar, kemi një rënie të shpenzimeve të tyre, nga angazhimi i punëtorëve për punë jashtë orarit ka qenë më i ulët.

Te shpenzimet e energjisë elektrike kemi një rritje të tyre, duke ditur se në këtë tremuor kemi shtuar edhe puse të reja burimeve të ujit, gjë që ka ndikuar direkt edhe në rritjen e energjisë elektrike.

Te pozicioni i derivative nuk kemi ndonjë ndryshim, nëse e shikojmë si mesatare këtë tre muhor më atë paraprak, kemi një shpenzim relativisht të njëjtë.



Ndërsa te mirëmbajtja, kemi ndryshim të shpenzimeve, pra një rritje të vogël të tyre, në krahasim me tre mujorin e kaluar. Ngase kemi rritjen e burimeve të reja të ujit, ndërhyrjeve në rrjet etj, ka ndikuar edhe në rritje të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

Pra, investimet tona janë duke vazhduar në gjetjen e burimeve të ujit dhe ndërtimin e rezervoarve të rinjë të ujit, si ai i Baqevcit, në ripërtëritjen e rrjetit të ujit, etj.

### **3.1 PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE**

Plani i Investimeve është një pjesë e rëndësishme e Planit të Biznesit, i cili i mundëson ujësjellësit të përmirësojë shërbimet ndaj konsumatore. Përmirësimi i shërbimeve do të ndikojë edhe në përmirësimin e moralit të pagesave tek konsumatorët..

Plani i investimeve do të përbëhet prej një përzierje të projekteve, ku disa prej tyre do të jenë pjesë e financimit nga Kompania nga të ardhurat e tyre. Megjithatë ekziston një numër i projekteve të mëdha të cilat kërkojnë financim të jashtëm edhe vlerësim të detajuar.

Qëllimi i Planit të Investimeve është që të sigurojë se Kompania është duke bërë planifikim të përshtatshëm për mirëmbajtjen e rregullt dhe zhvillimin e infrastrukture së ujësjellësit.

Identifikimi i investimeve, me qëllim të arritjes së ndryshimeve të standardeve të kualitetit apo shërbimeve shqyrtohet sipas vlerësimit të gjendjes së asetëve që janë në dispozicion me qëllim të arritjes së gadishmerisë teknike të pajimeve. Këto investime planifikohen të jenë pjesë e graveve nga KfW, MZHE, MEF, Kuvendi Komunal si dhe nga mjetet vetanake të Kompanisë.

Ne baze të analizës dhe gjendjes momentale që kemi në terren, ne kemi përcaktuar prioritete të investimeve në nivel të Kompanisë-Ndjesive punuese.

Këto prioritete janë të domosdoshme ngase:

- përmirësohet dukshëm furnizimi me ujë
- përmirësohet cilësia e ujit
- zvogëlohen humbjet teknike dhe komerciale
- shtohet numri i konsumatoreve të rinj
- zvogëlohen shpenzimet operative të mirëmbajtjes
- rritet shtimi i shërbimeve të Kompanisë
- evitohet mundësia e ndotjes së ujit të pijes nga ujërat e zeza

### 3.1.1 Plani i investimeve- ujësjellës

Ujësjetllës									
Pershkrimi i investimeve		2013		2014		2015		2016	
	Investitori	HRJ/€	Grante/€	HRJ/€	Grante/€	HRJ/€	Grante/€	HRJ/€	Grante/€
1	Përtëritjet e infrastrukturës për Furnizimin me ujë	20,500.00	273,000.00	60,000.00	724,000.00	103,000.00	340,000.00	50,000.00	155,000.00
2	Rritja e infrastrukturës për Furnizim me ujë	84,000.00	1,457,611.00	105,000.00	3,032,843.00	141,000.00	4,618,000.00	70,000.00	3,150,000.00
3	Mirëmbajtja kapitale e jo-infrastrukturës për Furnizimin me ujë	30,000.00	83,879.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00	40,000.00	30,000.00	40,000.00
4	Rritja e jo-infrastrukturës për Furnizimin me ujë	0.00	170,000.00	35,000.00	2,620,000.00	50,000.00	480,000.00	50,000.00	480,000.00
5	Investimet në aktivitetet biznesore (të përbashkëta) për Furnizimin me ujë	50,918.00	80,000.00	15,918.00	0.00	25,918.00	60,000.00	15,918.00	20,000.00
Gjithsejt/vit		185,418.00	2,064,490.00	245,918.00	6,406,843.00	349,918.00	5,538,000.00	215,918.00	3,845,000.00
Gjithsejt/HRJ+Grante/vit		2,249,908.00		6,652,761.00		5,887,918.00		4,060,918.00	

### 3.1.2 Planii investimeve - kanalizim

Kanalizim									
Pershkrimi i investimeve		2013		2014		2015		2016	
	Investitori	HRJ/€	Grante/€	HRJ/€	Grante/€	HRJ/€	Grante/€	HRJ/€	Grante/€
1	Përtëritjet e infrastrukturës për Ujëra të Zeza	0	0.00	8,250.00	416,000	0.00	750,000	0	650,000
2	Rritja e infrastrukturës për Ujërat e zeza	0	4654000.00	0.00	900,000.00	0.00	1,500,000.00	0.00	15,000.00
3	Mirëmbajtja kapitale e jo-infrastrukturës për Ujëra të zeza	0.00	0.00	1,000.00	480000.00	1,000.00	882,000.00	1,000.00	460,000.00
4	Rritja e jo-infrastrukturës për Ujërat e Zeza	0.00	1058000.00	0.00	3,050,000.00	0.00	4,440,000.00	0.00	0.00
5	Investimet në aktivitetet biznesore (të përbashkëta) për Ujërat e zeza	20000.00	200,000.00	15,000.00	100,000	15,000.00	100,000.00	15,000.00	1,600,000.00
Gjithsejt		20,000.00	5,912,000.00	16,000.00	4,946,000.00	16,000.00	7,672,000.00	16,000.00	2,725,000.00
Gjithsejt/HRJ+Grante/vit		5,932,000.00		4,962,000.00		7,688,000.00		2,741,000.00	
<b>GJITHSEJT- UJË DHE KANALIZIM</b>		<b>205,418.00</b>	<b>7,976,490.00</b>	<b>261,918.00</b>	<b>11,352,843.00</b>	<b>365,918.00</b>	<b>13,210,000.00</b>	<b>231,918.00</b>	<b>6,570,000.00</b>

## IV. RAPORTI I AUDITORIT

### 4.1 Raporti i auditorit të brendshëm

Raporti në vijim paraqet një rekapitullim të aktiviteteve dhe punës të auditorit të brendshëm në KRU Hidroregjioni Jugor, për periudhën kohore janar – dhjetor 2013.

Si objektive tjetër e këtij raporti, është gjithashtu edhe përmbledhja e konstatimeve, të gjeturave, dhe rekomandimeve të dhëna gjatë kësaj periudhe, si dhe niveli i implementimit të tyre, gjë e cila është paraqitur e detajizuar në vazhdim të raportit.

- Aktivitetet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe raportuese, e që kanë të bëjnë me fushën e auditimit, janë zhvilluar në pajtim me planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm për vitin 2013, si dhe me kërkesë të komisionit të auditimit.
- Fushëveprim i auditimit ka qenë periudha kohore janar-dhjetor 2013, e në disa auditime është rishikuar dhe krahasuar edhe periudha e njëjtë e vitit të kaluar 2012.
- Në pajtim me legjislacionin në fuqi, është përgatitur si dhe është aprovuar nga komisioni i auditimit:
  - plani strategjik i punës së auditorit të brendshëm, për periudhën 2013-2015, dhe
  - plani vjetor i punës së auditorit të brendshëm, për vitin 2013.
- Në bazë të këtij plani vjetor, janë kryer gjithsejt 15 auditime (nga 14 të parapara), në subjekte të ndryshme, ku janë përfshirë pothuajse të gjitha departamentet dhe njësitë që funksionojnë në kuadër të kompanisë, sikurse:
  - departamenti i financave,
  - departamenti teknik,
  - departamenti i administratës dhe personelit,
  - zyra e prokurimit;
  - shërbimi regjional me konsumator, dhe
  - njësitë operative në Suharekë, në Malishevë dhe në Dragash.
- Objektive kryesore e këtyre auditimeve është:
  - Rishikimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të dizajnuara nga vetë menaxhmenti;
  - Sigurimi i menaxhmentit të kompanisë që procesi i kryer është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme;
  - Sigurimi i menaxhmentit të kompanisë që proceset e kryera sa janë ekonomike, efikase dhe efektive;
  - Nxjerrja e rekomandimeve praktike për përmirësime aty ku është e nevojshme.
- Auditimet e zhvilluara kanë qenë të karakterit:
  - të pajtueshmërisë;
  - të performancës, dhe
  - të karakterit financiar.
- Fushëveprimi i auditimit i bazuar në planin vjetor të auditimit, ka qenë i përqëndruar në:
  - Menaxhimin e pasurisë – asetëve të kompanisë;
  - Menaxhimin e llogarive të arkëtueshme – borxheve të kqija;
  - Menaxhimin e procesit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar;
  - Menaxhimin e procesit të përlogaritjes së pagave;
  - Menaxhimin e procesit të riparimit dhe vendosjes së ujëmatësve;

- Menaxhimi e proceseve të zhvilluara në Nj. Operative në Suharekë;
- Menaxhimi e proceseve të zhvilluara në Nj. Operative në Malishevë;
- Menaxhimi e proceseve të zhvilluara në Nj. Operative në Dragash;
- Menaxhimi e të hyrave nga arka dhe portoarkat;
- Menaxhimi e procesit të faturimit, inkasimit dhe kontrollës;
- Menaxhimi e procesit të prokurimit;
- Menaxhimi e planit vjetor të biznesit;
- Menaxhimi e procesit të vlerësimit të punonjësve;
- Menaxhimi e transportit - automjeteve zyrtare, dhe
- Menaxhimi e depozë – stoqeve.

- Duke u bazuar në testimet e dokumentacionit, ekzaminimet fizike dhe të gjeturat e auditimeve të kryera, gjatë vitit 2013, është konstatuar se në KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a Prizren, përkundër disa mangësive, menaxhimi i proceseve, aktiviteteve dhe zhvillimi i procedurave, është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet tjera të brendshme në fuqi.
- Gjithashtu shikuar në aspektin e funksionimit të kontrollit të brendshëm, është konstatuar një gjendje e mirë dhe inkurajuese.
- Menaxhimi i proceseve gjatë kësaj periudhe të audituar krahasuar me vitet e mëparshme është i një performance më të mire, poashtu dhe numri i rekomandimeve është i një rreziku më të ultë.
- Gjatë rishikimit të rekomandimeve të dhëna, të cilat janë mirëprirë nga subjektet audituese, është konstatuar se shumica e tyre janë implementuar, ndërsa pjesa tjetër mbetet të realizohet gjatë vitit në vijim.

Në fund dua të theksoj se meritohet për këtë situatë, është përkushtimi dhe qasja serioze dhe profesionale e Komisionit të Auditimit, Bordit të Drejtorëve e në veçanti e Kryeshefit Ekzekutiv, që pa përkrahjen dhe mbështetjen e tyre, qëllimi dhe objektivat e auditimit do ta humbin vlerën. Andaj edhe u shpreh një falenderim të veçantë nga ana ime si auditor i brendshëm i kësaj kompanie.

**REZULTATET** - Konstatimet e detajizuara, të gjeturat dhe rekomandimet.

Në vazhdim, në mënyrë kronologjike, janë të paraqitura të gjeturat, rekomandimet, komentet, si dhe pas rishikimit të rekomandimeve është paraqitur edhe shkalla e adresimit apo implementim i tyre.

Edhe pse për të gjitha auditimet e kryera deri më tani, ekzistojnë raporte të veçanta të përgaditura me shkrim, megjithatë mendoj se ky raport përmbledhës, do të ndihmojë në prezentimin e gjendjes në kompani, i cili sado pak, në të ardhmen do të shërbejë për Komisionin e Auditimit, Menaxhmentin e Lartë të Kompanisë si dhe në përgjithësi për Bordin e Drejtorëve.

## **MENAXHIMI I PASURISË – ASETIVE TË KOMPANISË**

Procesi i menaxhimi të pasurisë apo asetive joqarkulluese, është konstatuar se në përgjithësi është zhvilluar në pajtim të plotë me Ligjin për të Ardhurat e Korporatave me nr.03/L-162, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK 16 dhe SNK 36), Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me nr. 03/L-048, udhëzimet administrative dhe shpjegimet publike.

E gjetura: Rivlerësimi i asetëve në KRU Hidroregjioni Jugor, për herë të fundit është kryer nga vlerësues të jashtëm në vitin 2007. Në pajtim me ligjet e aplikueshme, ky proces është kryer përmes një kompanije të licencuar për vlerësim dhe atë paraprakisht të lejuar nga Aksionari.

Në bazë të testeve të bëra, është konstatuar se një rivlerësim i tillë ka nevojë të bëhet prapë meqë një numër i asetëve janë zhvlerësuar në tërësi e disa të tjerë pritet të zhvlerësohen gjatë vitit të ardhshëm.

**Rekomandimi 1:** Rekomandohet menaxheri financiar që për asetet vlera e të cilave në kontabilitet është zero ndërsa edhe më tej janë funksionale, përmes një komisioni, për qëllime interne të kompanisë të kërkoj të bëhet një rivlerësim i tillë.

*Rekomandimi është pranuar. Janë dhënë propozime për caktimin e komisionit dhe formën se si të procedohet, mirëpo për shkak të angazhimeve ka mbetur të realizohet në fund të vitit ose në fillim të vitit paraprak.*

## **MENAXHIMI I LLOGARIVE TË ARKËTUESHME – BORXHEVE TË KQIJA**

Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, si dhe konkretisht provizionimi i tyre si borxhe të kqija, në përgjithësi është në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Ligjin mbi të Ardhurat e Korporatave me nr. 03/L- 162, dhe Vendimit Shpjegues Publik të Administratës Tatimore të Kosovës, me nr.1/2012.

E gjetura: Gjatë auditimit është konstatuar se shuma e provizionuar e llogarive të arkëtueshme në një masë i plotëson disa nga kushtet për tu llogaritur si borxh i keq, mirëpo që në bazë të testeve konsideroj se trajtimi i tyre nuk dëshmon për ndonjë analizë detale, që do të arsyetonte pjesën e marrë si shpenzim - borxh të keq.

Poashtu të len përshtypjen se është përdorur formulë e njëjtë e provizionimit si gjatë këtij viti poashtu edhe gjatë vitit paraprak. Sa për ilustrim, një gjë e tillë mund të vërehet kur gjatë vitit 2012, nga shuma e paarkëtuar prej 1,242,000€ është provizionuar 724,000€ që është 58.29%. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2011, nga shuma prej 1.070,000€ është provizionuar 626,000€ që është 58.50%.

**Rekomandimi 2:** Rekomandohet, menaxheri financiar, që të kërkoj nga shërbimi financiar, që të vazhdojnë të bëjnë regjistrimin e llogarive të arkëtueshme dhe shpenzimeve të borxheve të kqija konform kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Gjithashtu, rekomandoj që trajtimi i borxhit të keq, të jenë në pajtim me Ligjin e të Ardhurave dhe Korporatave me nr.03/L- 162, neni 12, në mënyrë që prezantimi i tij në pasqyrat financiare të jetë i saktë dhe i besueshëm

*Rekomandimi është pranuar. Realizimi do të bëhet gjatë përgatitjes së pasqyrave të vitit 2013, me gjasë që deri atëherë nuk do të ketë ndryshime në legjislacionin tatimor dhe të trajtimit të borxheve të kqija.*

## **MENAXHIMI I PROCESIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR**

Menaxhimi i procesit lidhur me përlllogaritjen, deklarimin dhe pagesën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, për periudhën e rishikuar kohore janar – dhjetor 2012 dhe janar 2013, është zhvilluar në pajtim me ligjin e TVSH-së, me nr. 03/L- 146, ligjin nr.04/L-108 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të TVSH-së me nr. 03/L-146, Udhëzimin Administrativ nr.10/2010 për Zbatimin e Ligjit të TVSH-së me nr.03/L-146, si dhe Vendimit Shpjegues Publik me nr.1/2012, për Shumën e Tatueshme në Furnizimet me TVSH.

E gjetura: Gjatë testimit të dokumentacionit të blerjeve, është konstatuar se ekziston një numër i caktuar i blerjeve, shërbimeve apo furnizimeve, të pranuar nga furnitorë të cilët nuk janë deklarues të TVSh-së, që me këtë rast ne si kompani nuk kemi të drejtë të shfrytëzojmë si të zbritshme pjesën e TVSh-së.

**Rekomandimi 3:** Edhe pse trajtimi dhe deklarimi i blerjeve, është në pajtim të plotë me ligjin e TVSh-së, megjithatë rekomandimi për të ardhmen, është që të bëhen përpjekje që blerjet e tilla të minimizohen, në mënyrë që ne si tatimpagues të përfitojmë si të zbritshme pjesën e TVSH-së.

Rekomandimi është pranuar dhe është implementuar. Nga totali i blerjeve të realizuara gjatë muajit dhjetor 2013 që ishin në shumë prej 4,326.06€ gjatë vitit 2013 ka pasur rënie, ku në korrik blerjet ishin 2,827.90€, ndërsa gjatë muajit gusht në shumë prej 1,436.80€.

E gjetura: Në pajtim me nenin 36, paragrafi 5.3, të ligjit të TVSH-së (Ligjin nr.04/L-108 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të TVSH-së me nr. 03/L-146) si dhe udhëzimin administrativ 10/2010, që ka të bëjë me shpenzimet e përfaqësimit, si dhe cilat prej shpenzimeve pranohet si TVSH e zbritshme, është konstatuar se në përgjithësi shpenzimet e krijuara nga ana e kompanisë janë në pajtim me ligjin dhe udhëzimin administrativ.

**Rekomandimi 4:** Është vërejtur se këtyre shpenzimeve apo faturave u mungon një arsyetim me shkrim, që këto shpenzime janë drejtpërdrejtë të karakterit biznesor, siq edhe kërkohet me ligj. Andaj, rekomandohet që në të ardhmen të kërkohet të bëhet një gjë e tillë.

Rekomandimi është pranuar dhe është duke u implementuar. Ekziston përshkrimi lidhur me destinimin e shpenzimeve në fjalë.

## MENAXHIMI I PËRLOGARITJES DHE PAGESËS SË PAGAVE

Menaxhimi i procesit të pagave, lidhur me përlogaritjen, deklarimin dhe pagesën e tyre, për periudhën e rishikuar kohore janar – mars 2013, është zhvilluar në pajtim me Ligjin e Punës, me nr. 03/L- 212, Kontratën e Përgjithshme Kolektive të vitit 2005, si dhe vendimet dhe aktet tjera të brendshme lidhur me bonuset dhe stimulimet.

E gjetura: Përkundër faktit që shtesat e dhëna në emër të kategorisë së stimulimeve dhe pagesës për punë jashtë orarit dhe të ngjashme, janë zhvilluar në pajtim me vendimet e kompanisë, si dhe kanë ndikuar pozitivisht në performancën e kompanisë, megjithatë shuma prej 12,257€, konsiderohet e lartë andaj një gjë e tillë ka qenë shqetësim i vazhdueshëm edhe për Kryeshefin Ekzekutiv.

**Rekomandimi 5:** Menaxhmenti të gjej forma që të reduktoj këto shpenzime, meqë e rrisin dukshëm këtë kategori të shpenzimeve, njëherit e ngarkojnë buxhetin e kompanisë.

Rekomandimi ka filluar të implementohet edhe para se të përfundoj raportin, ku gjatë muajit qershor kanë filluar të zbatohen forma të reja të organizimit, me qëllim të evitimit të orëve shtesë.

Me këtë rast është bërë shtimi i numrit të rojeve, kuptohet nga punëtorë brenda kompanisë, në atë mënyrë që orari i tyre i punës pamundëson orë jashtë orarit, si dhe në shërbimin e kontrollës duke bërë ndarjen e punëtorëve sipas dy ndërrimeve.

## MENAXHIMI I PROCESVEVE NË SHËRBIMIN E RIPARIMIT DHE VENDOSJES SË UJËMATËSVE

Menaxhimi i proceseve dhe aktiviteteve të zhvilluara në shërbimin e riparimit, kalibrimit dhe montimit të ujëmatësve, që funksionojnë në kuadër të zyrës për planifikim dhe zhvillim, për periudhën e rishikuar janar–prill 2012 janë në pajtim me rregulloret e brendshme si dhe në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre shërbimeve të caktuara në nivel të kompanisë.

E gjetura: Shërbimi i kalibrimit, aktivitetin e vet e kryen që një kohë të gjatë. Mirëpo, është konstatuar se ky shërbim me vite të tëra, nga viti 2006 është duke e kryer këtë veprimtari pa ndonjë autorizim apo licencë nga autoritetet që lejojnë një gjë të tillë.

**Rekomandimi 6:** Rekomandoj menaxhmentin e lartë të kompanisë që të caktohet një person përgjegjës, në mënyrë që të kontaktohet, të trajtohet dhe rregullohet kjo çështje, e që sipas Ligjit për Metrologji, me nr.03/L-203, këtë autoritet e ka Instituti për Metrologji Legale që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

*Rekomandimi është pranuar dhe implementuar. Në takim me zyrtarët e këtij Instituti, është kuptuar se për shkak të disa vendimeve të Ministrisë, ky Institut në njëfarë forme nuk kishte qenë aktiv që nga viti 2006, dhe që gjatë muajve në vazhdim do të njoftohen për së afërmi për mënyrën dhe formën e rregullimit të kësaj çështjeje, në pajtim me ligjin në fuqi.*

**E gjetura:** Gjatë auditimit është kuptuar se llojet e ujëmatësve të cilët riparohen nga shërbimi ynë janë vetëm ata të markës Insa dhe Ikom. Mirëpo ka raste që disa nga konsumatorët shtëpiak kanë të vendosur edhe ujëmatës të prodhuesve turk dhe kinez, e të cilët nuk janë të riparueshëm.

Meqenëse ne si kompani, në bazë të vendimit në fuqi, jemi të obliguar që pas kërkesës së konsumatorëve të bëjmë ndërrimin e ujëmatësve dhe atë pa pagesë, e që në fakt duke e ditur se ujëmatësat e tillë nuk mund të riparohen, konsideroj se për kompaninë është një kosto shtesë.

**Rekomandimi 7:** Rekomandoj menaxhmentin e kompanisë që të rishikohet çmimorja për rastet në fjalë dhe mundësisht të caktohet një tarifë minimale për këtë kategori të ujëmatësve, që sado pak të mbulonte një pjesë të shpenzimeve që nevojitet për riparimin e tyre.

*Rekomandimi është i pranueshëm mirëpo ende nuk është implementuar. Për shërbimin e riparimit pranohet si i arsyeshëm, mirëpo nga shërbimi me konsumatorë konsiderohet që edhe pse një gjë e tillë mund të bëhet, megjithatë mund të kemi ankesa të konsumatorët për trajtim jo të barabartë.*

## **MENAXHIMI I PROCESEVE DHE AKTIVITETEVE NË NJËSINË OPERATIVE NË SUHAREKË**

Proceset e zhvilluara dhe aktivitetet e ndërmarra në Njësinë Operative në Suharekë, për periudhën e rishikuar kohore janar–maj 2013, përkundër disa mangësive të specifikuara më poshtë, është konstatuar se janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera ligjore në fuqi.

**E gjetura:** Performanca financiare dhe operative e kësaj Njësie, sikurse edhe më parë edhe gjatë këtyre muajve është e nivelit jo të mirë dhe norma e mbulimit është nën nivelin e duhur.

Vlen të theksohet se për këtë periudhë kohore shpenzimet mujore operative kanë qenë të pambuluara, me të hyrat e gjeneruara (mbulimi operativ ka qenë nga 63-93%).

Lidhur me këtë, duhet të theksoj se përkundër performancës aktuale, gjatë auditimit është vërejtur se menaxhmenti i kësaj Njësie nuk ka hartuar ndonjë strategji apo plani operativ për përmirësimin e kësaj gjendjeje.

**Rekomandimi 8:** Inkurajoj menaxhmentin e kësaj Njësie të bëjë përpjekje të vazhdueshme, që në raport me pengesat dhe vështirësitë aktuale që ka në fushën e faturimit dhe arkëtimit, të gjej formë dhe të bëjë delegimin e përgjegjësive, si dhe në të njëjtën kohë të kërkojë llogari.

*Rekomandimi është pranuar dhe është duke u implementuar. Nj.O.në Suharekë ka planifikuar masat të cilat do të mirren për përmirësimin e gjendjes aktuale.*

*Masat e planifikuara janë: formimi i dy ekipeve së bashku me operativen për shkyqjen e konsumatorëve borxhlinj mbi 500 € do të shkyqen 10-20 konsumatorë në muaj. Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti nuk do të rikyqen pa e paguar së paku 30% të borgjit. Bashkëpunimi me inspektorët komunal në parandalimin e këqëpërdorimit të ujit dhe zbulimin e kyqjeve ilegale për të cilin është hartuar një plan i veprimit. Padia e konsumatorve për mos pagesë.*



E gjetura: Gjatë auditimit në shërbimin e faturimit dhe të inkasimit, që në bazë të mostrës është bërë testimi i specifikacioneve dhe kartelave të konsumatorëve për periudhën janar – maj 2013, por edhe për disa periudha të mëhershme, nga numri i rasteve të marrë në shqyrtim, që kryesisht kanë qenë biznese që veprojnë në qytetin e Suharekës dhe në magjistralen Suharekë - Prizren, mund të thuhet se ekziston një situatë e cila lenë vend për dyshime në lidhje me korrektësinë dhe besueshmërinë në procesin e faturimit.

Rekomandimi 9: Edhe pse një gjë e tillë është kërkuar edhe në mbledhjen e kaluar të menaxhmentit, megjithatë edhe njëherë konfirmoj dhe kërkoj nga menaxhmenti i lartë të bëj caktimin e një komisioni të brendshëm, nga shërbimi i financave, faturimit, kontrollës dhe laboratorit të kompanisë që në koordinim me menaxherin e Nj.O. të Suharekës të bëjnë inspektimin e gjendjes, si masë e mundshme e përmirësimit të performancës së Njesisë.

Rekomandimi është pranuar dhe është implementuar. Në bazë të vendimit me nr.677 të datës 15.07.2013 është emëruar komisioni prej pesë anëtarësh, që ka bërë verifikimin e kartelave të konsumatorëve, kontrollimin e punës në shërbimin e financave, ekipeve të kontrollës, kontrollimin e vërtetësisë së shërbimit të konsumatorëve nga rrjeti i ujësjellësit apo puset individuale. Deri më tani, nuk kam kurrfarë informate për përfundimin e këtij verifikimi.

E gjetura: Gjatë auditimit në shërbimin e faturimit është konstatuar një mangësi, e që ka të bëjë me një ndryshim mes të numrit të raportuar të konsumatorëve (faturave të lëshuara), dhe numrit të konsumatorëve të cilët gjenerohen nga sistemi i faturimit Navission (raporti kumulativ kuantitativ).

Rekomandimi 10: Rekomandoj menaxherin me konsumatorë të Njesisë së Suharekës që në bashkëpunim me personat kompetent brenda kompanisë që të sqarojnë dhe raportojnë për situatën e konstatuar, në mënyrë që të hiqen të gjitha dilemet lidhur me besueshmërinë e të dhënave të raportuara financiare dhe operative.

Rekomandimi është pranuar dhe është implementuar. Ndryshimi ka ndodhur vetëm në muajin maj të vitit 2013 që mund të konsiderohet si gabim teknik. Kemi kërkuar te ASECO që edhe njëherë ta kontrollon bazën e të dhënave të regjistrimit të konsumatorëve.

E gjetura : Gjatë testimit të dokumentacionit të blerjeve të materialit për nevoja të Njesisë, është konstatuar se në të shumtën furnizimi bëhet prej Njesisë së Prizrenit, në bazë të kërkesave të parashtruara me shkrim. Poashtu ka edhe furnizime të cilat kryhen me para të gatshme - përmes arkës, për të cilat shuma dhe destinimi i tyre nuk është i lejuar (regjistrimi dhe sigurimi i automjetit).

Rekomandimi 11: Mangësitë e prezentuara ndikojnë në nivelin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Andaj rekomandohet menaxheri i Njesisë që në të ardhmen të reduktoj pagesat e furnizimeve me të gatshme, si dhe të njëjtat të realizohen përmes llogarisë bankare. Poashtu për të gjitha furnizimet të bëjë kërkesë me shkrim.

Rekomandimi pranohet, ka filluar implementimi i tij.

E gjetura : Gjatë testimit të dokumentacionit të transportit, është konstatuar se gjendja e dokumentacionit të nevojshëm sa i përket evidentimit dhe raportimit, nuk është e nivelit të dëshiruar. Mungesa e regjistrimeve në blloka ditor, mos raportimi për gjendjen e shpenzimeve dhe kilometrave të kaluara tregon për një pasqyrë jo të qartë të gjendjes së shpenzimeve.

Rekomandimi 12: Rekomandohet menaxheri i Njesisë, që përmes mbikqyrësit të transportit të bëjë regjistrimin e qarkullimit të automjeteve, përmbledhjen dhe raportimin mujor të kilometrave të kaluara dhe sasisë së derivateve të shpenzuara. E gjithë kjo në pajtim me rregulloren e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare, të datës 01.10.2010.

Rekomandimi pranohet. Ka filluar të bëhet implementimi i tij.

E gjetura: Gjatë testimit të dokumentacionit të dhënies së pëlqimeve, është konstatuar mangësi e që ka të bëjnë me atë se pëlqimet janë përgatitur duke u bazuar në rregulloren e vjetër të ZRRUM –it me nr. 484/D të datës 01.01.2011, e që në fakt gjatë vitit 2013 ajo është ndryshuar.

Rekomandimi 13: Rekomandohen zyrtarët përgjegjës së Njesisë së Suharekës që dhënia e pëlqimeve për kyqje në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit të kryhet në pajtim me Urdhëresën e ZRRUK-it (ZRRUK/UTSH-05/02/2013, të datës 31.01.2013), dhe me vendimin e brendshëm të dhënies së pëlqimeve nr.045 të datës 14.01.2010.

Rekomandimi pranohet, ka filluar të implementohet.

## MENAXHIMI I PROCESVE DHE AKTIVITETEVE NË NJËSINË OPERATIVE NË MALISHEVË

Duke u bazuar në testimet dhe të gjeturat e auditimit të kryer në Njësinë Operative në Malishevë, për periudhën e rishikuar kohore janar – qershor 2013, përkundër disa mangësive, është konstatuar se proceset e zhvilluara dhe aktivitetet e ndërmarra janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera ligjore në fuqi.

E gjetura: Treguesit operativ dhe financiar sikurse janë: prodhimi, faturimi dhe inkasimi, përveq në disa raste, kanë pasur një trend negativ ku përpos stagnimit ka pasur edhe rënie. Për këtë periudhë ka pasur shtim të numrit të konsumatorëve, si dhe në disa muaj rënie – ulje të shpenzimeve të periudhës.

Vlen të theksohet se rasti i mos mbulimit operativ, ku nga të hyrat e gjeneruara kanë qenë të mbuluara vetëm shpenzimet operative të muajit janar dhe prill, ndërsa për katër muajt tjerë të marrë në shqyrtim, mbulimi operativ ka qenë në nga 60% deri në 98%.

Rekomandimi 14: Rekomandohet menaxheri e Nj.O në Malishevë që të bëj një analizë detale të treguesve të performancës, si dhe të parashih në kohë të duhur masat dhe veprimet në evitimin e faktorëve që pengojnë arritjen e objektivave.

Rekomandimi pranohet dhe është implementuar. Si rezultat i anqazhimit është përmirësuar dukshëm performanca e muajve në vazhdim çka tregon edhe raporti për muajt korrik dhe gusht 2013, ku mbulimi operativ është përafërsisht 100%.

E gjetura: Është konstatuar që inkasimi i realizuar përmes inkasantëve, është i një performace jo të mirë, që sipas tabelës së paraqitur, vërehet se në shumicën e kohës, inkasantët nuk kanë arritur ta realizojnë normativin e caktuar mujor.

Rekomandimi 15: Rekomandohet menaxheri i Njesisë, të bëj monitorimin e punës dhe aktiviteteve të inkasantëve, si dhe në raste të tilla të merr masa stimuluese por edhe ndërrimin e vendeve të punës, gjë që parashihet edhe me vendimin e brendshëm, mbi përcaktimin e normës së inkasantëve, të datës 08.03.2013, nr. prot.239.

Rekomandimi pranohet dhe është implementuar: Janë marrë masa të nevojshme, duhet të përmendet dhënia e vërejtjeve me shkrim ndaj dy inkasantëve për performancë të dobët.

E gjetura: Është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve është faturuar me tarifë fikse. Poashtu gjatë testimit të specifikacioneve rreth faturimit krijohet përshtypja se një gjë e tillë është duke u bërë në formë paushalle dhe jo duke u lexuar gjendja reale e shpenzuar.

Mund të vërehet se pjesa dërmuese faturohet me ngarkesa fikse, 5m<sup>3</sup>, 10m<sup>3</sup>, 15m<sup>3</sup>, 20 m<sup>3</sup> etj,

Rekomandimi 16: Andaj, rekomandohet menaxheri i Nj.O të Malishevës, që të rishikoj rastet në fjalë, të merr masa konkrete në përmirësimin e kësaj gjendjeje, sepse këto janë dukuri të cilat janë në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e punës së inkasantëve.

Rekomandimi është pranuar dhe është implementuar. Është bërë verifikimi, si dhe janë konfirmuar rastet në fjalë, me çrast janë paralajmëruar inkasantët që të bëjnë leximin e saktë të ujëmatësave në të kundërtën do të pasojnë masat ndëshkimore në përputhje me rregulloren e kompanisë. Si rezultat i këtyre angazhimeve në muajt në vazhdim kemi përmirësime në faturim dhe në inkasim.

E gjetura: Gjatë auditimit të arkës, është konstatuar se dokumentacioni i arkës, duke përfshirë të gjitha regjistrimet apo transakcionet ditore (inkasimi, pagesat dhe deponimi i mjeteve) është mbajtur i përditësuar. Poashtu, shuma e mjeteve në arkë, përputhej me gjendjen e mjeteve të regjistruara në ditarin e arkës. Përkundër kësaj është vërejtur se në disa raste deponimi i tyre ishte bërë me disa ditë vonesë, gjë që konsideroj që mbajtja e mjeteve në arkë, mund të shtoj rrezikun e humbjes apo të vjedhjes të tyre.

**Rekomandimi 17:** Rekomandohet arkatarja e njësisë, që të bëjë deponimin e mjeteve në llogarite bankare, në pajtim me rregullat e arkës si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës.

Rekomandimi pranohet është pranuar dhe është implementuar.

E gjetura: Gjatë testimit të dokumentacionit të dhënies së pëlqimeve, është konstatuar se përgatitja e pëlqimeve është bazuar në rregulloren e vjetër të ZRRUM-it, të datës 01.01.2011, nr.prot.484/D, e që në fakt gjatë vitit 2013 ajo është zëvendësuar me rregullore tjetër. Poashtu edhe përshkrimi i shumës për pagesë, është bërë në total, pa u ndarë në dy kategori për ujë dhe kanalizim.

**Rekomandimi 18:** Rekomandohet që në të ardhmen, përlllogaritja e tarifave si dhe dhënia e pëlqimeve, të kryhet në pajtim me Urdhëresën e ZRRUK-it (ZRRUK/UTSH-05/02/2013, të datës 31.01.2013), dhe në pajtim me vendimin e brendshëm të kompanisë për dhënien e pëlqimeve dhe kyqjeve me nr.045.

Rekomandimi është pranuar dhe implementuar. Dhënia e pëlqimeve, tani është duke u bërë në përputhje me Urdhëresën e ZRRUK - ut dhe në pajtim me vendimin e brendshëm të kompanisë.

## **MENAXHIMI I PROCESVE DHE AKTIVITETEVE NË NJËSINË OPERATIVE NË DRAGASH**

Gjatë auditimit të kryer në N.O. në Dragash, për periudhën kohore të rishikuar janar–qershor 2013, është konstatuar se performanca financiare dhe operative e kësaj Njësie, përkundër disa mangësive është e një niveli të mirë. Mesatarja e normës së mbulimit ishte në shkallën 109 %, ndërsa shkalla e inkasimit është 75%, ndërsa humbjet e ujit janë në shkallën 50%.

E gjetura: Mangësi dhe shqetësim paraqet numri i konsumatorëve, i cili evident ishte edhe gjatë auditimit të vitit të kaluar, numër i cili për këtë periudhë raportuese gjashtëmujore jo që nuk është rritur, por ka pasur rënie për 8 konsumatorë.

**Rekomandimi 19:** Rekomandohet menaxheri i Nj.O. në Dragash, që në bashkëpunim me autoritetet lokale të angazhohet edhe më tutje në gjetjen e mundësive për rritjen e mbulueshmërisë së zonës së shërbimit, konkretisht në rritjen e numrit të konsumatorëve, si tregues mjaft i rëndësishëm i performancës.

Rekomandimi është pranuar, mirëpo implementimi i tij pritet të bëhet pas përfundimit të projektit të ri të ujësjellësit, që pritet të realizohet për 15 fshatra të Komunës së Dragashit dhe që menaxhimi i tyre do të bëhet nga Njësia e Dragashit.

E gjetura: Gjatë testimit të dokumentacionit të blerjeve të materialit për nevoja të Njësisë, është konstatuar se për furnizimet që bëhen me të gatshme nga arka, e të cilat janë në shumë prej 1,069.31€, nuk aplikohen kërkesa me shkrim, mirëpo ato bëhen vetëm gojarisht. Mungesa në fjalë konsiderohet funksionim jo i duhur i kontrollit të brendshëm.

**Rekomandimi 20:** Rekomandohet menaxheri i Njësisë që të kërkojë të aplikohen kërkesat me shkrim, si dhe në pajtim me formën e përcaktuar, kërkesa duhet të posedoj lejimin paraprak nga udhëheqësi apo menaxheri.

Rekomandimi është pranuar dhe ka filluar të implementohet.

E gjetura: Gjatë testimit të dokumentacionit të dhënies së pëlqimeve, është konstatuar se me rastin e paraqitjes së kërkesës me shkrim nga pala, përgatitja e pëlqimeve është bazuar në ligjin nr.03/L-086 dhe rregulloren e ZRRUM - R05. Edhe pse ligji në fjalë është ende në fuqi, megjithatë gjatë këtij viti ekzistojnë urdhëresa të reja të ZRRUK që përcaktojnë mënyrën dhe tarifën e dhënies së pëlqimeve.

Poashtu edhe shumën për pagesë, është bërë në total, pa u ndarë në dy kategori për ujë dhe kanalizim.

Rekomandimi 21: Rekomandohet që në të ardhmen, përlllogaritja e tarifave si dhe dhënia e pëlqimeve, të kryhet në pajtim me Urdhëresën e ZRRUK-it (ZRRUK/UTSH-05/02/2013, të datës 31.01.2013), dhe në pajtim me vendimin e brendshëm të kompanisë për dhënie e pëlqimeve dhe kyqjeve me nr.045.

Rekomandimi pranohet dhe është implementuar.

## **MENAXHIMI I TË HYRAVE TË REALIZUARA PËRMES ARKËS DHE PORTOARKAVE**

Gjatë auditimit të kryer në departamentin e financave, është konstatuar se procesi lidhur me menaxhimin e të hyrave të cilat realizohen përmes arkës dhe portoarkave, është menaxhuar mirë dhe është në pajtim me rregulloret e brendshme të kompanisë me nr.01-21/02, të datës 03.02.2011, si dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

E gjetura: Është konstatuar se në shërbimin e portoarkave, mungon një evidencë apo regjistrim, lidhur me shumën e pagesave të kryera gjatë ditës, si dhe mungesa e kasafortës për mbajtjen e sigurt të mjeteve që është e një niveli shumë të ultë.

Rekomandimi 22: Rekomandohet, menaxherin financiar të kërkojë nga portoarkat, që për qëllime raportimi, por edhe barazimi me arkën kryesore, të mbahet një regjistër i pagesave ditore dhe mujore, poashtu të bëhet sigurimi i kasafortave që të mos vije deri te humbja apo vjedhja e parave të inkasuara.

Rekomandimi është pranuar dhe ka filluar të implementohet. Ka filluar të mbahet regjistër javor i të hyrave të realizuara si dhe është kërkuar të bëhet furnizimi me kasaforta.

E gjetura: Është konstatuar një mangësi që ka të bëjë mungesën e autorizimit apo vendimit me shkrim, për kryerësin e detyrave të arkës.

Rekomandimi 23: Rekomandohet menaxheri financiar që përmes një vendimi apo autorizimi me shkrim të caktoj personin në fjalë në kryerjen e detyrave të arkës.

Rekomandimi është pranuar, dhe është implementuar.

E gjetura: Gjatë auditimit është bërë edhe testimi i pagesave të faturave me vlerë që kalojnë shumën 100 euro, me çrast janë konstatuar pagesa të tilla, që kryesisht janë pagesa për regjistrimin e automjeteve, pagesë për furnizime, dhënie e ndihmës për familjarët e disa punëtorëve të sapo vdekur të kompanisë etj.

Rekomandimi 24: Edhe pse disa pagesa me të gatshme llogariten si të paevitueshme, megjithatë rekomandohet menaxhmenti i lartë që të reduktoj pagesat e tilla dhe të njëjtat të paguhen përmes llogarisë.

Rekomandimi është pranuar dhe ka filluar të implementohet.

## MENAXHIMI I PROCESIT TË FATURIMIT, INKASIMIT DHE KONTROLLËS NË NJËSINË E PRIZRENIT

Gjatë rishikimit dhe testimit të dokumentacionit lidhur me faturimin apo ngarkimin e konsumatorëve, realizimin mujor të inkasantëve, realizimin e shërbimit të kontrollës, si dhe mënyrës së përlogaritjes së pagave të tyre, për periudhën janar – gusht 2013, është konstatuar performancë mirë si dhe procesi i zhvilluar në përgjithësi është në pajtim me vendimet e brendshme të kompanisë.

E gjetura: Në bazë të të dhënave të audituara lidhur me këtë proces, është bërë rishikimi i specifikacionit të inkasantëve, me çrast janë testuar shumat e faturimit sipas inkasantëve, ku dhe është vërejtur se mund të vërehet se leximi – faturimi për këtë muaj, sipas auditimit mund të konsiderohet se një numër i konsideruar i konsumatorëve është duke u faturuar me tarifë fikse (në shumë prej 1.16€). Ky numër është rezultat i konsumatorëve të cilët faturohen meqë llogariten nën menaxhimin e kompanisë, ndërsa aktualisht kanë statusin e padefinuar dhe nuk paguajnë (Mamusha, Landovica etj).

**Rekomandimi 25:** Rekomandohet menaxheri regional me konsumator që për rastin në fjalë të propozoj masa konkrete, si dhe në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë të kompanisë të kërkoj të bëhet definimi i tyre, në mënyrë që procesi i faturimi dhe inkasimit të tyre të procedohet sipas rregullave të parapara.

*Rekomandimi pranohet. Konsiderohet se deri në fund të vitit aktual kjo çështje do të zgjidhet.*

E gjetura: Gjatë auditimit është bërë edhe testimi i realizimit të inkasantëve, mirëpo në baza individuale. Me këtë rast është konstatuar se përkundër performancës së mirë të disa inkasantëve të cilët rregullisht e arrijnë normën e kërkuar dhe njëherit e tejkalojnë atë, disa prej tyre kanë treguar performancë jo të mirë, që vazhdimisht ballafaqohen me problemin e mos arritjes së normës, si dhe ndryshimet mes të shumës së realizuar dhe normativit të këta inkasantë janë shumë të larta, që arrijnë shumën mbi 2,000€.

**Rekomandimi 26:** Rekomandohet menaxheri i shërbimit për konsumatorë që përmes shefit të inkasantëve, të merrë masa në përmirësimin e kësaj gjendjeje, duke filluar nga ndërrimi i mundshëm i terreneve të inkasantëve, asistimin e ekepeve të kontrollit, në të kundërtën të kërkoj ndërrimin e vendit të tyre të punës.

*Rekomandimi pranohet. Në fund të këtij viti kur edhe bëhet vlerësimi i punëtorëve do t'i propozohet menaxhmentit ndërrimi i vendeve të punës për këta punëtor.*

E gjetura: Gjatë auditimit është bërë edhe testimi i përlogaritjes së stimulimeve dhe destimulimeve, masa stimuluese këto të parapara me vendimin e brendshëm mbi normativin e inkasantëve. Sipas të dhënave të ofruara dhe të testuara është konstatuar se në disa raste janë bërë disa gabime teknike në kalkulim, e që kryesisht janë gjatë muajit prill, maj, qershor dhe korrik.

**Rekomandimi 27:** Edhe pse gabimet janë në vlera të vogla, megjithatë rekomandohet menaxheri për konsumator që të kërkoj nga shefi i këtij shërbimi, që në të ardhmen, para se të dërgohen këto pagesa për tu ekzekutuar, të rishikohen dhe kontrollohen në mënyrë të mos vie deri te një gabim i tillë, krejt kjo në funksion më të mirë të funksionimit të kontrollit të brendshëm.

*Rekomandimi pranohet, dhe është implementuar.*

## MENAXHIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Duke u bazuar në testimet dhe të gjeturat e auditimit, është konstatuar që procedurat e prokurimit, të zhvilluara nga ana e Zyres së Prokurimit, në përgjithësi, janë në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës me nr.04/L-042, legjislacionit sekondar si dhe dispozitat tjera ligjore.

E gjetura: Gjatë auditimit në zyrën e prokurimit për periudhë tremujore të rishikuar, është vërejtur se të gjitha procedurat e zhvilluara janë në pajtim me planin e prokurimit për vitin 2013. Megjithatë është vërejtur një rast që është zhvilluar jashtë planit të prokurimit (lënda furnizim me bombola, me nr. prok. HJ/13/013/1.3.6), e që për iniciimin e tij, fillimisht është dashur të njoftohej Agjencia Qëndrore e Prokurimit (AQP), gjë e cila nuk është bërë.

**Rekomandimi 28:** Rekomandohet autoriteti kontraktues që në bashkëpunim me zyrtarin e prokurimit, për rastet e prokurimeve që nuk janë paraparë me planin e prokurimit, para iniciimit të procedurës të bëj njoftimin në AQP, në pajtim me kërkesat e LPP-në neni 9.6.

*Rekomandimi është pranuar. Në të ardhmen do të respektohet një kërkesë e tillë ligjore. (mbetet të rishikohet vitin e ardhshëm.*

E gjetura: Gjatë auditimit në zyrën e prokurimit, është vërejtur se me rastin e realizimit të punimeve apo projekteve, autoriteti kontraktues rregullisht ka caktuar një menaxher të projektit, që për detyrë ka përcjelljen dhe mbikqyrjen e realizimit të punëve në pajtim me kushtet e kontraktuara.

Mirëpo, sipas LPP-së, autoriteti kontraktues obligohet të caktoj një person i cili do të mirret me menaxhimin e kontratës në tërësi, gjë e cila deri më tani kjo ka munguar.

**Rekomandimi 29:** Rekomandohet autoriteti kontraktues, që në funksion të ngritjes së kualitetit të punëve dhe shërbimeve të kontraktuara, të caktoj një person i cili do të bëj menaxhimin e kontratave, në pajtim me LPP nr.04/L-042 neni 81, si dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik, AO2 neni 55.

*Rekomandimi është pranuar dhe është implementuar. Është hapur konkursi publik për përzgjedhjen e zyrtarit për menaxhimin e kontratave.*

E gjetura: Gjatë testimit të lëndëve të prokurimit është vërejtur se disa dokumente sikurse vendimet për caktimin e komisionit të hapjes dhe vlerësimin të ofertave, në disa raste janë të paprotokuara në arkivën e kompanisë.

**Rekomandimi 30:** Rekomandohet zyrtari i prokurimit, që në funksion të ngritjes së kontrollit të brendshëm në të ardhmen të aplikoj protokolimin e vendimeve të sipërtheksuara.

*Rekomandimi pranohet. Ka filluar të implementohet.*

## AUDITIMI I PLANIT TË BIZNESIT

Në bazë të testimeve të kryera, të të dhënave financiare dhe operative të realizuara gjatë periudhës janar – shtator të vitit 2013, si dhe krahasimit të tyre me të dhënat e planifikuara sipas planit të biznesit të së njëjtës periudhë kohore 2013, edhe përkundër mosrealizimit në tërësi të çaqeve të planifikuara, megjithatë është konstatuar performancë e mirë dhe inkurajuese.

E gjetura: Mosrealizimi i plotë i Planit të biznesit, edhe pse me disa diferenca jo të larta, që njëherit deri në fund të vitit këto mund të ulen, janë si rezultat i asaj që me rastin e hartimit të tij nga ana e menaxherëve të shërbimeve përkatëse, disa tregues me gjasë janë të mbivlerësueshëm dhe pak a shumë ambicioz.

Kur them këtë bazohem në rastin kur planifikimi i inkasimit për vitin 2013, në raport me vitin paraprak 2012 është llogaritur të jetë më i lartë për 21.69%, kur dihet se ndryshimi i inkasimit në mes të vitit 2012 dhe atij 2011 ishte vetëm 13.29% më i lartë. Si rezultat i këtij planifikimi të inkasimit vjen në atë që shkalla e mbulimit operativ nga 102.58% sa ishte në 2012, është paraparë të jetë 119% me një ndryshim prej 16%.

Poashtu konsideroj se ndikim në mosrealizimin e çaqeve të planifikuara është edhe performanca jo aq e mirë e dy njërive operative në Suharekë dhe në Malishevë.

**Rekomandim 31:** Edhe pse gjatë përgatitjes së planit vjetor të biznesit, menaxhmenti është i vetëdijshëm se realizimi në tërësi i tij, përcillet me sfida dhe vështirësi të ndryshme, mirëpo gjithmonë me synim që ato të tejkalohen, andaj mund të mirret si e arsyeshme mos revidimi i tij.

Mirëpo derisa një mundësi e tillë nuk është shfrytëzuar me kohë, rekomandoj menaxherët e shërbimeve përkatëse, që për periudhën e mbetur kohore deri në fund të këtij viti të angazhohen maksimalisht dhe të dalin me plane konkrete të veprimit, në mënyrë që realizimi i planit të biznesit t'i afrohet edhe më shumë caqeve të planifikuara, në të kundërtën mbetet përgjegjësi e tyre dhe njëherit udhërrëfyes për planet e ardhshme.

*Rekomandimi pranohet. Angazhimi i menaxhmentit nuk ka munguar dhe prapë në të ardhmen nuk do të mungoj, në mënyrë që t'i afrohem caqeve të planifikuara, megjithatë, sipas të gjitha gjasave, planifikimi në raport me realizimin e këtij viti do të rezultoj me një diferencë, e që në fakt na detyron neve si menaxhment që gjatë vitit 2014, të kemi kujdes të shfrytëzojmë mundësinë ligjore të revidimit të tij, meqë planifikimi i tij është kryer më herët.*

*Poashtu ju njoftojmë se gjatë këtyre dy muajve në vijim, muajt tetor dhe nëntor, norma e mbulueshmërisë ishte e mirë (100% për tetor dhe 117% për muajin nëntor). Shpresojmë që edhe muaji dhjetor të jetë i një performace të mirë si nga aspekti i mbulueshmërisë ashtu edhe nga aspekti i investimeve.*

## MENAXHIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË PUNONJËSVE

Duke u bazuar në testimet dhe të gjeturat e auditimi të kryer në Departamentin e Administratës dhe Personeli, lidhur me procesin e vlerësimit të punonjësve të Kompanisë, për periudhën kohore 2013 është konstatuar se procesi në fjalë është menaxhuar mjaft mirë, me një funksionim të duhur të kontrollit të brendshëm, si dhe procedurat e zhvilluara janë në pajtim me rregulloren e brendshme të kompanisë apo Manualin e Personelit, të KRU Hidroregjioni Jugor Prizren.

**E gjetura:** Gjatë testimit të dokumentacionit - formularëve për vlerësim, në bazë të metodës së mostrave është konstatuar se kriteret të cilat janë të përfshira në dokument, janë kriteret e mjaftueshme për të bërë vlerësimin e performancës së një të punësuarit. Megjithatë, mendoj se mangësi në këtë rast është 1) mungesa e një përshkrimi të shkurtër të detyrave të punës dhe aktiviteteve, që paraprakisht të plotësohet nga vetë i punësuarit dhe 2) poentimi që bëhet gjatë vlerësimit e që përbëhet nga 4 shkallë, prej notës 5 deri në 2, nuk ka ndonjë përshkrim në formular që jep sqarim se pikët e dhëna çka në fakt tregojnë.

**Rekomandim 32:** Rekomadohet Sekretarja e Kompanisë që në formularët e vlerësimit të performancës së të punësuarve, të bëj plotësimin e duhur me këto të dhëna, të cilat do të ndikojnë në favor të këtij procesi.

*Rekomandimi pranohet. Ka filluar të implemetohet.*

**E gjetura:** Sikurse edhe parashihet në Manualin e Personelit, vlerësimi i punonjësve duhet të bëhet në mënyrë sa më objektive që të krijoj te punonjësit ndjenjën e sigurisë se gjitha punët e ngjashme vlerësohen sipas kriterëve të njëjta si dhe të motivoj ata për punë të mëtutjeshme.

Poashtu sipas manualit kërkohet që gjatë poentimit të mbahen edhe takime në mes të punonjësit dhe menaxherit, në mënyrë që të diskutohen detyrat dhe objektivat e arritura, veprim i cili mund të konsiderohet si një vetvlerësim i punonjësit.

Mirëpo gjatë auditimit të këtij procesi, është vërejtur se një intervistë e tillë, nuk është aplikuar deri më tani. Këtu përjashtim paraqet rasti në Njësinë e Malishevës, ku në bazë të formularit shihet që përkundër dhënies së vlerësimit të dobët për disa punëtorë, komentet e punonjësve kanë qenë të pranueshme si dhe kanë shprehur gatishmërinë për përmirësim në të ardhmen.

**Rekomandim 33:** Rekomandohet Sekretarja e Departamentit të Administratës që të kërkoj nga menaxherët e Departamenteve, Njësive apo të shërbimeve tjera, që të aplikojnë takime të tilla (intervista) në mënyrë që në formularët e vlerësimit, komente kundërshtuese të mos ketë, e me këtë edhe procesi i vazhdimit të kontratave të jetë më i lehtë dhe me bazë ligjore.

*Rekomandimi pranohet. Janë informuar të gjithë menaxherët dhe udhëheqësit që gjatë vlerësimit të punëtorëve të aplikojnë takime ku do të diskutojnë rreth çështjes së përmbushjes së detyrave të punës.*

**E gjetura:** Gjatë testimit të dokumentacionit – formularëve të vlerësimit, është konstatuar se ky proces është kryer në pajtim me vijën hierarkike, që do të thotë se vlerësimi është kryer nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i punonjësit, e që pastaj është nënshkruar edhe nga menaxheri atij shërbimi apo departamenti.

Megjithatë janë konstatuar disa raste kur nënshkrimi është bërë vetëm nga ana e mbikqyrësit të drejtpërdrejtë por jo edhe nga menaxheri i atij shërbimi. Fjala është për disa vlerësime të kryera në departamentin e financave, shërbimin e inkasantëve etj.

**Rekomandim 34:** Rekomandohet Sekretarja e Kompanisë që të kërkoj në të ardhmen, që pas vlerësimit të punonjësve nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, të kontrollohen dhe njëherit të nënshkruhen edhe nga menaxherët e atyre shërbimeve, krejt kjo në funksion të kontrollit të brendshëm.

*Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Gjatë vlerësimit në vijim, ky rekomandim do të implementohet në tërësi.*

## MENAXHIMI I TRANSPORTIT

Duke u bazuar në testimet dhe të gjeturat e auditimit, është konstatuar që menaxhimi i transportit apo shfrytëzimi i automjeteve zyrtare në KRU Hidroregjioni Jugor, për periudhën e rishikuar kohore janar – shtator 2013, edhe përkundër të disa mangësive në aspektin e pajtueshmërisë dhe kontrollit të brendshëm, në përgjithësi është i menaxhuar mirë dhe është në pajtim me rregulloren mbi mënyrën e përdorimit të automjeteve zyrtare.

**E gjetura:** Në bazë të rregullores mbi mënyrën e përdorimit të automjeteve, kërkohet që personi i cili merr në shfrytëzim veturën zyrtare, paraprakisht duhet që të bëjë kërkesë dhe lejim me shkrim nga udhëheqësi i tij, mirëpo që deri më tani është konstatuar se kërkesat në fjalë nuk janë duke u aplikuar.

**Rekomandim 35:** Rekomandohet shefi i shërbimit të transportit që në pajtim me nenin nr.8 të Rregullores, të kërkoj nga shfrytëzuesit e automjeteve, që para marrjes në shfrytëzim të automjetit zyrtar, së paku për ato udhëtime që bëhen jashtë qytetit, paraprakisht të bëjnë kërkesë me shkrim të aprovuar nga eprori i tij.

*Rekomandimi pranohet. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë, gjatë vitit të ardhshëm do të bëhet implementimi i tij, andaj mbetet të rishikohet.*

**E gjetura:** Gjatë auditimit, është kuptuar se për t'i mbuluar të gjitha aktivitetet e nevojshme ditore, kompania në disa raste obligohet që për qëllime zyrtare të kërkoj nga të punësuarit që të angazhojnë veturat e tyre private, me çrast edhe bën kompenzimin e shpenzimeve me derivate. Me këtë rast është vërejtur se lejimi për këtë kategori të shpenzimit, në përjashtim të disa rasteve, është bërë vetëm gojarisht.

**Rekomandim 36:** Rekomandohet shefi i shërbimit të transportit që në raste të tilla, të kërkoj nga udhëheqësit e shërbimeve përkatëse një arsyetim dhe lejim me shkrim lidhur me qëllimin e përdorimit të automjetit si dhe sasisë së derivateve për tu furnizuar.

*Rekomandimi pranohet si dhe ka filluar implementimi i tij.*



E gjetura: Gjatë krahasimit të të dhënave në mes të dy periudhave raportuese (nëntëmujorit 2013, në raport me atë 2012) është konstatuar se përkundër disa mangësive që mbetet të përmirësohen, performanca e këtij shërbimi ka qenë e një niveli të mirë.

Rekomandim 37: Rekomandohet shefi i shërbimit të transportit që në favor të ngritjes së performancës së këtij shërbimi, rregullisht të përcjellë qarkullimin dhe shpenzimet e automjeteve, si dhe të raportoj për çdo rast Rekomandimi pranohet.

Rekomandimi është pranuar. Do të vazhdohet edhe më tutje në përcjelljen dhe raportimin e gjendjes së transportit apo aktivitet tek menaxheri teknik, në mënyrë që të mirren masa në pajtim me gjendjen në terren.

## MENAXHIMI I DEPOSË - STOQEVE

Është konstatuar se menaxhimi i stokeve në KRU Hidroregjioni Jugor, për periudhën e rishikuar janar – nëntor 2013, në përgjithësi është i menaxhuar mirë, me një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm si dhe është zhvilluar në pajtim me rregulloren e brendshme të kompanisë (Politikat dhe Procedurat Financiare në KRU Hidroregjioni Jugor) dhe rregullat dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

E gjetura: Është vërejtur që disa furnizime të realizuara nga shërbimi i operativës edhe pse posedonin fletëhyrjen dhe fletëdaljen e materialit të përgatitur nga depoisti, u mungonte kërkesa me shkrim që dëshmon për autorizimin e furnizimeve të tilla nga menaxhmenti përkatës, i caktuar në pajtim me rregullat e përcaktuara të kompanisë.

Rekomandimi 38: Rekomandohet menaxhmenti i kompanisë, që në të ardhmen të kërkoj të ndërpritet kjo dukuri dhe të kërkoj të respektohet në tërësi forma dhe mënyra e parashtrimit të kërkesave për furnizim. E gjithë kjo në favor të funksionimit të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi është pranuar.

E gjetura: Gjatë auditimit të deposë, është vërejtur që depoisti në pajtim me rregullat e deposë, për të gjitha furnizimet e kryera, sipas personave të ngarkuar, ka përgatitur urdhëresat për dalje të mallit.

Mirëpo është vërejtur se gjatë furnizimeve të kryera nga shërbimi i furnizimit, nuk është aplikuar ndonjë formë me shkrim, që dëshmon sasinë e pranuar të atij malli në raport me sasinë e kërkuar. Këtë e them me faktin se ka shumë raste kur nga sasia e tërësishme e mallit të kërkuar, për shkak të mungesës së tij tek operatori apo në depo, furnizimi bëhet jo i plotë.

Rekomandimi 39: Rekomandohet menaxheri i departamentit të financave, në kuadër të të cilit vepron zyra e logjistikës dhe depoja, që në funksion të ngritjes së kontrollit të brendshëm dhe ngritjes së përgjegjësisë së punës së zyrtarëve të inkuadruar në këtë proces, të kërkoj që të aplikojnë dokumentet që do të vërtetonin me shkrim të gjitha proceset edhe pse të kryera mirëpo të padokumentuara.

Rekomandimi është pranuar.

E gjetura: Gjatë auditimit të deposë, është bërë ekzaminimi fizik i stokeve të deponuara, ku me këtë rast është bërë edhe krahasimi i tyre me të dhënat nga kontabiliteti financiar dhe ai material.

Me këtë rast, sipas metodës së mostrave, është konstatuar pajtueshmëri në mes të gjendjes së prezentuar në dokumentacion dhe asaj faktike në depo.

Përfundim, paraqet rasti i një sasi të materialit të deponuar, që nuk është i përfshirë në listën e stokeve. Fjala është për një sasi të ujëmatësve, furnizim ky me vlerë rreth 4,000 eurove i ardhur si donacion, dhe që në mungesë të faturës nuk është regjistruar në sistem.

Rekomandimi 40: Rekomandohet menaxheri financiar, që të kërkoj nga depoisti por edhe komisioni që bën regjistrimin vjetor të stokeve, të raportoj dhe të regjistroj këtë sasi të stokut, në një formë të mundshme derisa të gjindet mundësia e sigurimit të faturës për të caktuar vlerën e tij.

Rekomandimi është pranuar.

## V. PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

### 5.1 Qellimet dhe objektivat strategjike për vitin 2014

Si qellime kryesore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. janë:

- Kontinuiteti i vazhdueshëm i prodhimit të ujit të pijshëm,
- Kontrolla e kualitetit të ujit të pijshëm të jetë në pajtim me instruksionet e lëshuara ngarregullorret në fuqi.
- Rritja e shkallës së inkasimit si dhe zvogëlimi i ujit të pafaturuar
- Rritja e shkallës së efikasitetit të punëtorëve.

### 5.2 Objektivat kryesore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A

- Mirëmbajtja e stabilimenteve Elektro-makinerike,
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet dhe evitimin e prishjeve me kohë,
- Aktivitetet në përfundimin e projekteve për instalimin e ujëmatësave,
- Përpjekjet që çdo konsumatori të matet sasia e ujit të shpenzuar dhe të bëhet faturimi në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar,
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhena të reja,
- Përpjekjet maksimale në identifikimin e klientëve të rinj,
- Angazhimi në mbledhjen e borgjeve të vjetëra si dhe inkasimi i faturave rrjedhëse,
- Identifikimi dhe rritja e numrit të konsumatorëve përfshirë këtu edhe lidhjet ilegale,
- Vazhdimi i informimit të konsumatorëve dhe bashkëpunimi me organet komunale në mënyrë që shfrytëzimi i ujit të bëhet në suaza normale,

### 5.3 Treguesit kryesor të performancës- 2014-2016-

#### K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A PRIZREN

Treguesit e Performancës	[Njesia]	2014 - 2016		
		2014	2015	2016
Uje i faturuar-si perqindje	%	41.56	43.44	43.09
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	58.44	56.56	56.91
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	74.01	79.18	81.37
Norma e arketimit - Amviserite	%	68.91	74.92	77.61
Norma e arketimit -Komerical-Indu.	%	68.60	75.43	77.34
Norma e arketimit - Institucional	%	98.52	99.02	100.00
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.08	1.10	1.09
Staf per 1000 konsumatore	numer	7.20	6.78	6.56

## VI. RAPORT I PROKURIMIT

### 6.1 VLERAT E MESME

TeHytrat	Titulli I Kontrates	Nr RendorProkurimit	Data e nënshkrimit	Qmimi I kontrates	Emri I OE	Selia e OE	Kriter per Dhenje
Vetanake	Furnizim me karburant	HJ/13/001/121	13.05.2013	86,650.00	NPT Ibrahim	Shtimje	Qmimi me lulet
Vetanake	Shpimi I pusit ne lokacionin 40 burimet	HJ/13/002/236	25.02.2013	8,510.00	n.sh Geou consulting	Suhareke	Qmimi me lulet
Vetanake	Furnizim me pompa te ujit	HJ/13/003/136	02.04.2013	8,565.00	Tafaj&Co	Suhareke	Qmimi me lulet
Qeveria	Rehabilitimi I rrjetit te ujesiellesit ne rrugen e muhagjerve Prizren	HJ/13/004/521	15.04.2013	117,836.00	n.sh Geou consulting ShPKCapital group	Suhareke Ferizaj	Qmimi me lulet
Vetanake	Furnizim me rroba pune	HJ/13/005/136	25.03.2013	7,225.00	N.P.T. Printeks	Prizren	Qmimi me lulet
Vetanake	Hulumtimi I burimeve te reja nentokesore te ujit permes shpimit te puseve - ritender	HJ/13/006/521	16.06.2013	74,105.00	n.sh.n Burimi	Prizren	Qmimi me lulet
Vetanake	furnizim me tonera	HJ/13/007/136	10.05.2013	9,750.00	Media Mrket shpk	Prizren	Qmimi me lulet
Vetanake	Sherbim me eskavator	HJ/13/008/221	04.06.2013	123,500.00	RAMIZ SHEHU	Prizren	Qmimi me lulet
Vetanake	Furnizim me Beton	HJ/13/009/121	22.07.2013	69,400.00	sh.p.k. ShariBeton	Prizren	Qmimi me lulet
Vetanake	sherbim: punimi I projekteve per ndertimin e pendes akumuluese dhe hulumtimi te ujrave nentokesore	HJ/13/010/236	23.05.2013	9,800.00	n.sh. Geo Consulting	Suhareke	Qmimi me lulet

Vetanake	Furnizim me material elektrik	HJ/13/011/136	04.06.2013	9,493.50	n.t.sh. Kastel-ing	Prizren	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me mobilje malisheve	HJ/13/012/136	14.06.2013	8,850.10	Graniti sh.p.k.	Suhareke	Qmimi me I ulet
Qeveria	Ndertimi I rezervoareve ne Grejkoc Suhareke	HJ/13/013/511	Anulim	//////////	//////////	//////////	//////////
Vetanake	Galeria per nenkalimin te 40 burimet	HJ/13/014/536	07.06.2013	8,884.00	n.p.t. ShariBeton	Prizren	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me pjese ujesjellesi	HJ/13/015/136	24.06.2013	4,304.80	d.p.t. Endriti	Prizren	Qmimi me I ulet
Qeveria	Rehabilitimi I rrjetit te ujesiellesit ne rrugen e muhagjerve Prizren (Faza II hapja e pusit	HJ/13/016/536	01.07.2013	6,325.00	n.sh..n Burimi	Suhareke	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me pjese fazonike	HJ/13/017/136	11.07.2013	4,703.00	n.p.t. Xerxa	Rahovec	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me bombola per klor	HJ/13/018/136	31.07.2013	6,850.00	n.t.sh. Seykos	Prishtine	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me dyer dhe dritare plastike	HJ/13/019/136	30.07.2013	2,200.00	n.sh. TAHA	Suhareke	Qmimi me I ulet
Qeveria	Hapja e puseve dhe dy galerive ujembledhes te 40 burimet	HJ/13/020/521	27.09.2013	305,794.00	sh.p.k. Capital Group	Ferizaj	Ekonomikisht me I favorshem
Vetanake	Furnizim me mobilje per laborator shadervan	HJ/13/021/136	09.08.2013	5,360.00	sh.p.k. GoldInvest	Prizren	Qmimi me I ulet
Qeveria	Furnizim me gypa HD-PE100	HJ/13/022/111	24.09.2013	1,619,445.00	npt XERXA	Rahovec	Ekonomikisht me I favorshem

Vetanake	Furnizim me armature	HJ/13/023/1 21	16.09.2013	89,405.00	n.n.p. EuroIng	Suhareke	Qmimi me I ulet
Vetanake	Pergaditja e dokumentarit per Prizrenin	HJ/13/024/2 36	17.09.2013	9,734.00	AL "Kosova Press"	Prishtine	Qmimi me I ulet
Qeveria	Nivelizimi I vendite ne Bacevc	HJ/13/025/2 36	18.09.2013	9,630.00	nnp "Kalaja"	Prizren	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me vetura te dores se dyte	HJ/13/026/1 36	16.09.2013	9,600.00	ntsh TafaAuto Trade	Fushe Kosove	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me ventila Bllokuese	HJ/13/027/1 36	20.09.2013	8,198.40	Zem Zem	Prizren	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me hidropompa zhytесе	HJ/13/028/1 36	27.09.2013	9,600.00	NPT LINDA	Gjilan	Qmimi me I ulet
Qeveria	Hapja e puseve dhe dy galerive ujembledhes e te 40 burimet (faza II )	HJ/13/029/5 21	18.11.2013	144,665.00	NNP Euroing	Suahreke	Ekonomikisht me I favorshem
Vetanake	Furnizim me pompa zhytесе	HJ/13/030/1 36	14.11.2013	9,400.00	Tafaj&Co	Suhareke	Qmimi me I ulet
Qeveria	Ndertimi I murit mbrojtес per sigurimin e gypave Transportuese ujesiелlesit	HJ/13/031/5 21	Anulim	////////	////////	////////	Ekonomikisht me I favorshem
Vetanake	Sherbim Auditimit I jashtem I pasqyrave financiare per vitin fiskal 2013	HJ/13/032/2 36	27.12.2013	3,290.00	N.sh. "Kanuni I auditorit	Istog	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me Autopjese	HJ/13/033/1 36	12.12.2013	4,435.49	Sh.P.K. HUNDAI	Prishtine	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me pjese te ujesiелlesit	HJ/13/034/1 36	13.12.2013	5,123.65	Dpt ENDRITI	Prizren	Qmimi me I ulet
Vetanake	Furnizim me pompa te ujit	HJ/13/035/1 36	18.12.2013	9,588.00	Ntp Tafa CO	Prizren	Qmimi me I ulet

## 6.2 VLERAT MINIMALE

TeHytrat	Titullii I Kontrates	Nr Rendor I Prokurimit	Data e nenshkrimit	Qmimi I kontrates	Emri I OE	Selia e OE	Kriterpërdh enje
Vetanake	Furnizim me trafo per 40 burimet	001	11.02.2013	960.00	sh.p.k. OK	Prizren	Qmimi me l ulte
Vetanake	Furnizim me rroba te punes per pun tor	002	4.03.2013	980.00	dpt SmartMen	Prizren	Qmimi me l ulte
Vetanake	Furnizim me material ndertimor per renovimin e zyreve ne objektin e vjeter	003	04.03.2013	927.50	sh.p.k. OK	Prizren	Qmimi me l ulte
Vetanake	Furnizim me material ndertimor per renovimin e zyreve ne objektin e vjeter	004	14.03.2013	760.00	sh.p.k. OK	Prizren	Qmimi më l ulet
Vetanake	Pastrimi I puseve te 40 burimet	005	16.04.2013	952.00	Vellezerit J&D	Prizren	Qmimi me l ulte
Vetanake	Furnizim me gome te automjeteve	006	16.04.2013	864.00	n.t.p. Feroda	Prizren	Qmimi më l ulet
Vetanake	Furnizim me karrige	007	17.04.2013	620.00	d.p.t Fleksist	Prizren	Qmimi më l ulet
Vetanake	furnizim me gype dhe llamarina	008	17.04.2013	950.00	n.t.p. AFA-COM	Ferizaj	Qmimi më l ulet
Vetanake	Furnizim me material elektrik	009	19.04.2013	581.20	n.t.p. NEON	Suhareke	Qmimi më l ulet
Vetanake	Furnizim me material ndertimor per njesin e Suharekes	010	22.04.2013	800.00	n.t.p. AFGA-Com	Ferizaj	Qmimi më l ulet
Vetanake	Furnizim me material te ujesiellesit per bazhdarim	011	22.04.2013	955.85	KWE	Mitrovice	Qmimi me l ulte
Vetanake	Furnizim me kompjuter te perdorur	012	02.05.2013	480.00	IT SIB IT	Prizren	Qmimi më l ulet
Vetanake	Furnizim me material ndertimor per banjo	013	03.05.2013	668.95	Dardania Commerce	Prizren	Qmimi më l ulet
Vetanake	Sherbim Dezenfektimi I objekteve HRJ	014	07.05.2013	850.00	s.r.v.uh IMAGO	Prizren	Qmimi më l ulet
Vatanake	Ndertimi I tunelit te 40 puset	015	13.05.2013	917.25	n.t.p. AFA-COM	Ferizaj	Qmimi më l ulet

Vetanake	Sherbim Dezenfektimi I objekteve HRJ	016	04.06.2013	850.00	s.r.v.uh IMAGO	Prizren	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me material elektrik poer mullirin e vjeter	017	10.06.2013	230.00	Lightin Elko	Prizren	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me pjese te IT	018	08.07.2013	404.00	Komtel Projekt Engineering	Prishtine	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me nje motor zhytes ne libzhd te Hasit	019	15.07.2013	558.00	Tafaj&Co	Suhareke	Qmimimë I ulet
Vetanake	Furnizim me autopjes per xhipin toyota	020	22.07.2013	709.02	Ferdoa N.T.P.	Prizren	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me klima	021	Anulim	////////	////////	////////	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me drru per ngrohje ne n jesin Suhareke	022	10.09.2013	555.00	N.T.P. Dini	Prizren	Qmimimë I ulet
Vetanake	Furnizim me nje pompe zhytese	023	10.10.2013	775.00	Tafaj&Co	Suhareke	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me central per telefoni fikse	024	10.10.2013	881.60	sh.p.k. Koniks	Gjilan	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me pjese kembimi per makina	025	11.20.2013	884.40	n.t.sh. Krasniqi	Suhareke	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me rrere	026	11.11.2013	899.93	n.p.t Vellezerit se bashku	Suhareke	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me goma per v etura	027	13.11.2013	680.00	A.S. Leotrimi	Prizren	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me profila te gypit	028	16.12.2013	975.00	sh.p.k. InerSteel	Suharekë	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me goma per vetura	029	18.12.2013	960.00	n.t.p. Feroda	Prizren	Qmimi më I ulet
Vetanake	Furnizim me drru per djegje	030	20.12.2013	400.00	n.t.p. Dini		Qmimi më I ulet

## VII. RREZIQET E TË ARDHMES

Gjatë dy viteve të ardhshme Kompania mund t ballafaqohet me rënie të vazhduesme të burimeve të ujit të pijes që si pasojë mund të sjellë edhe deri tek rritja e reduktimeve të furnizimit. Kjo mund të sjellë edhe në rënien e shumë së faturimit dhe arkëtimit.

Kompania ka filluar të marrë masa konkrete në gjetjen e burimeve alternativ që do të rritë sigurine e kompanisë në sigurimin e furnizimit me ujë të pijes edhe ne raste emergjente.

Këto masa janë diskutuar edhe me institucionet tjera relevante si dhe me donatore të ndryshëm, nga të cilët edhe presim përkrahje financiare.



**STRUKTURA ORGANIZATIVE**  
**KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN**

